

PËRMBLEDHJE E DOKUMENTEVE PËR POLITIKA PUBLIKE



**SUPPORT TO
ELECTORAL REFORMS**

ПОДДРШКА НА ИЗБОРНИ РЕФОРМИ
МБËSHËTETJE E REFORMAVE ZGJEDHORE



Ky publikim është punuar në suaza të projektit "Mbështetje për reformat zgjedhore" të Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES) dhe Këshilli rinor nacional i Maqedonisë (KRNМ). Qëndrimet dhe përmbajtja e shprehur në këtë publikim, nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit, projektit apo realizuesve.

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Tetovo Street Dog Coalition - Abdulla Osmani	5
Manastiri SmartAPPcity - Andrej Gulabovski	13
Ohrid Youth Hub - Angela Miteska	27
Struga kujdeset - Besjan Pollozhani	35
Kërçova qytet i gjelbër - Davor Mihajloski	41
Të rinjtë më të fortë së bashku - Dejan Dimitriev	55
Kalaja - Zemra e qytetit – Dino Bllazheski	65
Çairi i rinisë urbane - Egzon Guri	73
LGBT+ Qyteti inkluziv i Shkupit - Evgenija Janakieska	81
Qëntë endacakë: Nga zgjidhje sipërfaqësore deri në zgjidhje të qëndrueshme në komunën e Prilepit - Evgenija Markoska	89
Funksionimi i Këshillit Rinor Lokal në Gostivar - Fjolla Jakupi	99
Zgjidhje për të rinjtë në Strumicë - Hristijan Velkov	107
Pjesëmarrje aktive për rritjen e pavarësisë ekonomike të grave në zonat rurale të Komunës së Koçanit - Ivana Maksimova	115

Të rinjtë në shtëpi - qendër karriere për të rinj në Dellçevë - Katerina Antovska	125
Parku adrenalín për të rinjtë në Kumanovë - Nenad Bojkovski	133
Kush i përfaqëson të rinjtë? - Nikolla Cvetkoski	141
Lumenj të pastër për shëndet më të mirë - Rijad Fetaji	149
Kohë moderne, probleme të vjetra - Sinan Vejselovski	157
Të rinjtë nga Krusheva: Dimë, mundemi, duam! - Sotir Gabeloski	167
Aerodrom inkluziv për të gjithë - Stefanija Trajçeska	175
Kush çfarë frenon? - Teodora Dimitriovska	183
Nga të rinjtë për të rinjtë e Ohrit - Tijana Tesalonika Shishkoska	195

HYRJE

Kjo Përmbledhje e dokumenteve për politika të shkurta, e zhvilluar nga pjesëmarrësit në Akademinë për Politika Publike është pjesë integrale e Projektit Mbështetje për Reformat Zgjedhore në Maqedoninë e Veriut. Objektivi i përgjithshëm, është të mbështesë proceset demokratike dhe të besueshme zgjedhore që lehtësojnë pjesëmarrjen politike dhe integrimin shoqëror duke u mundësuar votuesve të zgjedhin lirisht përfaqësuesit e tyre dhe t'i thërrasin në përgjegjësi. Aktivitetet e Projektit kanalizohen për të mbështetur objektivin e përgjithshëm përmes arritjes së tre rezultateve:

Rezultati 1: Institucione të forcuara realizojnë procese zgjedhore të drejta dhe efikase.

Rezultati 2: Partitë politike të demokratizuara përbrenda tyre, paraqesin politika të orientuara ndaj qytetarëve dhe programeve zgjedhore.

Rezultati 3: Qytetarë të fuqizuar i mbajnë përgjegjëse partitë politike dhe funksionarët e zgjedhur.

Si pjesë e rezultatit të dytë, Projekti mbështet partitë politike në zhvillimin e burimeve dhe kapaciteteve për miratimin e programeve të bazuara në dëshmi dhe për angazhim me komunitetet lokale, duke përfshirë gratë, të rinjtë dhe grupet e tjera të rrezikuara.

Qasja për krijimin e politikave bazuar në dëshmi për planifikimin kërkon të përmirësojë mospërputhjen midis perceptimeve të politik-bërësve për nevojat e qytetarëve dhe realiteteve dhe kërkesave ekzistuese në terren duke informuar procesin e planifikimit me analiza të cilësisë së lartë dhe prova përkatëse. Në arenën politike, formulimi i politikave të bazuara në prova funksionon për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e politikave dhe programeve të propozuara, për të forcuar reagimin e partive politike dhe për t'i ndihmuar ato të bëhen më të orientuara nga qytetarët dhe më të përgjegjshme ndaj njësive të tyre zgjedhore.

Duke marrë parasysh sa më sipër dhe duke pranuar se pjesëmarrja efektive e të rinjve në jetën politike dhe publike është kritike për zhvillimin demokratik, Projekti organizoi Akademinë për Politika Publike kushtuar përfaqësuesve të forumeve rinore të partive politike. Akademia ishte paramenduar si mundësi për "mësim duke vepruar" që synonte të rriste kompetencat e liderëve të rinj në krijimin dhe ndikimin mbi politikat publike. Këtë e bëri duke kombinuar sesionet teorike mbi temat që lidhen me politik-bërjen me përvojën praktike nga angazhimi me komunitetin lokal që të zhvillohen përgjigje politike ndaj nevojave të qytetarëve.

Përmbledhjet e mëposhtme të dokumenteve të shkurta për politika, përfaqësojnë arritjen përfundimtare ose kurorën e përpjekjeve të degëve rinore të partive politike, të hartojnë përgjigje politike të bazuara në prova dhe vlera ndaj problemeve të komunitetit. Ato u zhvilluan me objektivin primar për të propozuar zgjidhje përkatëse të orientuara drejt qytetarëve, të parashikuara të jenë pjesë e programeve zgjedhore të partive politike. Në fazat fillestare të përgatitjes, të rinjtë e partive politike organizuan ndërveprime të gjera me komunitetet lokale dhe grupet e rrezi-kuara, që u ndihmohet të identifikonin nevojat dhe kërkesat më urgjente të qytetarëve. Njohuritë e siguruar nga këto ndërveprime shërbyen si bazë për hartimin e dokumenteve për politika të cilat u ndanë me lidërsipin e partisë, në mënyrë që të plotësohej zhvillimi i mëtejshëm i ideve të politikave dhe të bëhen pjesë e platformës së tyre në prag të Zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Rezultatet ishin më se frymëzuese: nga 22 zgjidhjet e propozuara nga liderët e rinj nga 6 parti politike, pothuajse të gjitha u pasqyruan në programet zgjedhore të partive të tyre. Këto rezultate janë dëshmi premtuese se partitë politike njohin përfitimet nga priorizimi i nevojave relevante të zgjedhësve të tyre, vërtetojnë programet e propozuara si provë dhe janë të gatshme të kalojnë në një qasje më qytetare dhe programore për zhvillimin e politikave, duke i bërë proceset zgjedhore më përfaqësuese dhe më inkluzive.

TETOVO STREET DOG COALITION

Strehimi dhe kujdesi për qentë
endacakë në komunën e Tetovës

- Abdulla Osmani





REZYME

Tetova, si një nga qytetet më të mëdha në Maqedoninë e Veriut, nuk ka krijuar një sistem koherent për kujdesin ndaj qenve endacakë, i cili është një problem serioz për shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve.

Tetovo Street Dog Coalition është një nismë joformale e të rinjve nga Tetova të cilët, duke qëndruar prapa të njëjtit synim në vitin 2021, angazhohen për të përmirësuar raportin e institucioneve ndaj çështjes së kafshëve të rrugës. Në këtë kuptim, ky dokument i politikave publike synon të kontribuojë në përmirësimin e kushteve për përkujdes ndaj qenve endacakë në territorin e komunës së Tetovës.

Dokumenti ofron një model alternativ që do të sigurojë qëndrueshmërinë e plotë të një stacioni për kujdes për qentë endacakë. Stacioni, ndër të tjera, do të kryente tre aktivitete kryesore:

- Detektimi, kapja dhe kujdesi për qentë endacakë në territorin e komunës së Tetovës;
- Trajtimi dhe shërimi i qenve endacakë që tashmë janë kapur dhe vendosur në stacionin për strehim;
- Angazhim informativ-edukativ dhe komunikues që duhet të kontribuojë në ndërgjegjësimin e mëtejshëm të qytetarëve për kujdes më të madh ndaj kafshëve, si dhe mundësitë për pranimin dhe mbështetjen e qenve, të vendosur në stacionar.

Propozohet që stacioni për përkujdesje ndaj qenve endacak të jetë subjekt i veçantë juridik i themeluar nga Komuna e Tetovës.

Nëpër prizmin e kësaj që u përmend, në vijim është shtjellim specifik i kësaj ideje përmes një përshkrimi të situatës aktuale, kuadrit ligjor, si dhe shembujve krahasues. Në fund, në bazë të sa më sipër, paraqiten vëzhgimet përfundimtare në të cilat paraqitet konkretizimi i mëtejshëm i kësaj nisme.

PROBLEMI - KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Sipas rezultateve nga hulumtimi i opinionit publik të kryer në gjysmën e parë të korrikut 2021, në një kampion përfaqësues prej 540 të anketuarve të moshës 18 deri në 55 vjeç, është evidente nevoja që pushteti lokal dhe qendror të ndërmarrin veprime për tejkalimin e këtij problemi shqetësues.

Përveç këtij pohimi, në vijim janë përgjigjet e pyetjeve nga hulumtimi:

Madje 78% e të anketuarve u përgjigjën se Tetova ka një problem të madh me kafshët endacake;

50.9% e të anketuarve janë shprehur se i konsiderojnë kafshët endacake si rrezik për ta;

60% e të anketuarve deklaruan se njihnin një person nga qyteti i tyre i cili kishte një problem apo aksident të shkaktuar nga një qen endacak ose kafshë tjetër endacake;

48.8% e të anketuarve deklaruan se deri më tani asnjë iniciativë koherente nuk është realizuar në Tetovë për të kapërcyer këtë problem të madh;

70.5% e të anketuarve deklaruan se duan të bëhen vullnetarë nëse formohet dhe zbatohet një iniciativë e përshtatshme për trajtimin dhe kujdesin e qenve endacakë në përputhje me praktikën e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Duke pasur parasysh sa më sipër, është e qartë se qytetarët e Tetovës kanë një nevojë të fortë për të krijuar një stacion për trajtimin dhe kujdesin e kafshëve endacake në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare.

Kuadri ligjor në lidhje me trajtimin dhe kujdesin e kafshëve endacake

Institucionalisht, të drejtat e kafshëve në Maqedoninë e Veriut rregullohen me Ligjin për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve¹.

Ky ligj përcakton kërkesat minimale për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve në lidhje me shumimin, ruajtjen, kujdesin dhe strehimin e tyre, mbrojtjen e kafshëve gjatë mbarështimit në fermë, mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve gjatë transportit (...), mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve shtëpiake dhe kafshëve endacake, kafshë në kopshtin zoologjik dhe kafshë që përdoren për qëllime eksperimentale ose arsimore.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit, institucioni kompetent për zbatimin e tij është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë².

Nga aspekti i temës së këtij punimi, brenda këtij institucioni qeveritar, ekziston një sektor i veçantë që kujdeset për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve³. Ky sektor, ndër të tjera, kryen detyrat më të rëndësishme në vijim:

- Monitoron gjendjen me sëmundjet e kafshëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Përgatit programe për kontrollin / çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve;
- Përgatit raporte për gjendjen shëndetësore të kafshëve dhe përgatit akte ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes së shëndetit të kafshëve;
- Mban evidencë dhe regjistër të shoqërive veterinare; dhe
- Komunikon me organizatat përkatëse ndërkombëtare.

1. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/07 dhe 136/11.

2. Shih fva.gov.mk.

3. Shih ueb faqen e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë: fva.gov.mk/mk/zdravstvena-zasita-blagosostojba-zivotni

Situata aktuale me qentë endacak në Tetovë

Tetova duhet të themelojë Qendër për trajtimin e qenve endacakë. Ky problem ka qenë i pranishëm për shumë vite. Në këtë kuptim, fëmijët dhe prindërit janë më të shqetësuar për këtë problem. Gjegjesisht, këta të fundit janë jashtëzakonisht të pasigurt në lidhje me sigurinë e fëmijëve të tyre të cilët duhet të udhëtojnë në shkollë, duke lëvizur në rrugë dhe duke qëndruar në oborret e shkollës të cilat janë shenjtorja kryesore e këtyre qenve endacakë⁴.

Vetëm në shkurt 2021, më shumë se 12 banorë u kafshuan nga qentë endacakë. Në përgjithësi, sipas vlerësimeve nga maji 2021, kishte më shumë se 400 qen endacakë në rrugët e Tetovës.

Pjesa më e keqe është se qentë bëhen më agresivë gjatë dimrit për shkak të sipërfaqeve të ngrira dhe mungesës së ushqimit. Njëkohësisht rritja e numrit të qenve nëpër rrugët e qytetit vjen si pasojë e neglizhencës së popullatës në komunat rurale, gjegjesisht këta qen endacakë të braktisur nga vendbanimet përreth mbërrijnë në Tetovë, duke kërkuar ushqim në kontejnerë, gjë që e komplikon edhe më shumë problemin.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, vetëqeverisja lokale e Tetovës për vitin 2021 për të kapërcyer këtë çështje, ka siguruar alokime buxhetore prej 3 milion denarë në krahasim me vitin e kaluar 2020 kur ishin parashikuar vetëm 1 milion denarë.

Kujdesi dhe trajtimi i qenve endacakë i është besuar një klinike veterinare e cila brenda mjeteve të kufizuara të akorduara nga Komuna, krejtësisht minimalisht e zbut problemin. Sipas këtij operatori ekonomik çmimi për kapjen dhe mjekimin e një qeni është 9 mijë denarë dhe mjetet e ndara nuk janë të mjaftueshme. Për zgjidhjen e plotë të problemit, komuna duhet të rrisë mjetet që i ndahen kësaj kompanie-klinika veterinare ose komuna të themelojë ndërmarrje të posaçme që do të kapte dhe trajtonte qentë endacakë me një kapacitet më të madh.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, mund të nxirren përfundimet e mëposhtme:

- Në Tetovë për momentin nuk ka organizim dhe fokus adekuat nga autoritetet komunale për të kapërcyer këtë situatë;
- Numri i denoncimeve nga qytetarët që janë sulmuar dhe kafshuar nga qentë endacak është vazhdimisht në rritje, duke çuar në përfundimin se ende mungojnë nismat konkrete për tejkalimin e kësaj situatë;
- Vetëqeverisja lokale në Tetovë njoftoi se në vitin 2021 do të ndajë 3 milionë denarë për investime në qendra për trajtimin e qenve endacak dhe kujdesin e tyre, por ky premtime ende nuk është realizuar.

Duke pasur parasysh këtë, në vijim është një përmbledhje e dy shembujve krahasues që mund të jenë një bazë e mirë për tejkalimin e problemit me qentë endacakë në Tetovë.

4 Shih Aline Gil Alves Guilloux et.all, Stray dogs in urban fragments: Relation between population's perception of their presence and socio-demographic factors, Pesquisa Veterinária Brasileira, janar 2018.

ZGJIDHJE ALTERNATIVE

Në përputhje me situatën aktuale, si dhe në përputhje me karakteristikat e veçanta të udhëheqjes aktuale komunale, në Maqedoninë e Veriut ekzistojnë përvoja të shumta krahasuese që mund të jenë të dobishme në zgjidhjen e problemit me qentë endacakë në Tetovë.

I pari i referohet Gostivarit, si komunë që ka bërë progres në këtë fushë dhe shembulli i dytë i referohet Shkupit, si njësi e vetëqeverisjes lokale që ka bërë përparim të madh.

Komuna e Gostivarit dhe problemi me qentë endacak

Banorët e Gostivarit, si dhe ata të Tetovës, në të kaluarën në një masë shumë më të madhe përballëshin me problemin me qentë endacakë. Sidoqoftë, kjo situatë zgjati deri në 2018/2019, kur pushteti vendor filloi të ndër marrë hapa konkretë për të lehtësuar dhe kapërcyer këtë problem.

Në kuptim konkret, zgjidhja e problemit me qentë endacakë në Gostivar mund të ndahet në dy faza:

- Faza përgatitore;
- Faza operative.

Lidhur me fazën e parë, administrata komunale gjatë vitit 2017/2018, në bashkëpunim me organizatat partnere, përgatit një studim fizibiliteti që përcakton madhësinë e këtij problemi, për sa i përket përcaktimit të numrit afërsisht të saktë të qenve endacakë. Konkretisht, sipas këtij dokumenti, Gostivari kishte midis 600 dhe 700 qen endacak.

Pasi të përcaktohet madhësia e kësaj sfide, në fazën e dytë komuna e Gostivarit fillon me një realizim konkret. Gjegjësisht, gjatë vitit 2018 dhe 2019, dy stacione për strehimin e qenve endacakë ndërtohen në territorin e ish -kazermës, në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare dhe vendase në këtë fushë. Kapaciteti i përgjithshëm i dy stacioneve për strehim është 200 qen. Gjatë vitit 2020/2021, Komuna e Gostivarit njofton se do të fillojë ndërtimi i një stacionit të tretë, gjë që e bën shumë të sigurt se ky qytet në përfundim të vendit do të jetë i pari që do të trajtojë plotësisht këtë sfidë serioze.

Qyteti i Shkupit dhe problemi me qentë endacak

Ekzistimi i strehimores për trajtimin dhe kujdesin e kafshëve endacake, kushtet e së cilës do të plotësojnë nevojat për trajtimin dhe kujdesin e qenve endacakë që është diçka për të cilën flitet prej shumë vitesh në kryeqytet.

Në këtë drejtim, duke ndjekur shembullin e qendrave të tjera të zhvilluara të qytetit, gjatë vitit 2020, qyteti i Shkupit hapi strehimoren për trajtimin e kafshëve endacake "Lajka".

Ky objekt synon, më në fund, pas kaq vitesh të vendos rend në këtë sferë, në territorin e kryeqytetit të shtetit.

Mënyra se si funksionon strehimi është në përputhje me standardet më të larta në këtë fushë. Gjegjësisht, "Lajka" është shumë më tepër se një stacion, përkatësisht ky institucion, sipas ekspertëve të kësaj fushe, është një shtëpi e vërtetë për të gjithë qentë që nuk kanë shtëpinë e tyre. Kapaciteti i objektit është rreth 100 qen.

Kapja e qenve brenda kësaj qendre kryhet me metoda humane, sepse kapësit kanë certifikatat përkatëse të lëshuara nga Qendra për Mirëqenien e Kafshëve pranë Fakultetit të Mjekësisë Veterinare. Në të njëjtën kohë, kutitë në të cilat strehohen qentë janë me ngrohje nën dysheme.

Një kafshë e kapur, pasi është sjellë në këtë qendër, kalon disa ditë në karantinë në mënyrë që të bëhen të gjitha ekzaminimet shëndetësore dhe ekzaminime të tjera. Pastaj, pasi të përcaktohet se qeni është i shëndetshëm, ai trajtohet në mënyrë njerëzore me sterilizim ose kastrim.

Menjëherë pas kësaj ndërhyrjeje, këto kafshë vendosen në një repart tjetër, pas çka, pas shërimit, transferohen te qentë e tjerë. Në këtë pjesë, fillon procesi i trajnimit të tyre (të hanë në një kohë të caktuar, të shëtisin në kohë të caktuar, etj.) të jenë gati për shtëpinë e tyre të re.

Përfundimisht, në fund të kësaj periudhe, qentë fotografohen, karakteristikat e tyre regjistrohen në dosjen e tyre dhe kthehen në vendin ku janë kapur, përveç nëse, ndërkohë, është siguruar një shtëpi tjetër për këto kafshë.

Pavarësisht dobësive të perceptuara në lidhje me trajtimin dhe kujdesin e qenve endacakë, është ende një fakt që qyteti i Shkupit, në krahasim me qytetet e tjera të vendit ka krijuar sistemin më gjithëpërfshirës në këtë fushë. Sigurisht, mbetet në të ardhmen që kjo sferë të zhvillohet më tej në mënyrë që më në fund banorët e kryeqytetit të shtetit të mos kenë absolutisht asnjë problem në lidhje me qentë endacakë.

Përveç kësaj, në përputhje me objektivat e këtij dokumenti, ekziston një përpunim specifik i mënyrave të mundshme për të kapërcyer këtë problem në qytetin e Tetovës.

Duke pasur parasysh ajo që u theksua në pjesët paraprake, mund të shohim ndryshimin në qasjen e qeverisë komunale në Tetovë në krahasim me qytetet e tjera në vend, sa i përket trajtimit dhe kujdesit për qentë endacakë.

Në çdo rast, si për gjithçka në jetë ashtu dhe në këtë sferë, udhëtimi më i gjatë fillon me hapin e parë. Në atë drejtim, kjo nismë synon të vendosë trajektoren për të gjithë hapat pasues deri në tejkalimin përfundimtar të këtij problemi. Në kuptim konkret, ndër të tjera duhet të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme:

REKOMANDIME DHE AKTIVITETE

- 1 Duhet të përgatitet një studim fizibiliteti për të zbuluar shkaqet për paraqitjen dhe numrin afërsisht të saktë të qenve endacakë që ekzistojnë në qytet. Në këtë kuptim, sipas të dhënave nga debati publik, nga një çift qensh, pas gjashtë deri në shtatë vjet, mund të ketë rreth 60.000 qen endacakë, nëse shtimi i pakontrolluar i tyre nuk rregullohet në kohë;
- 2 Komuna e Tetovës duhet të ndryshojë qëndrimin e saj ndaj kësaj çështje duke rritur alokimet buxhetore për trajtimin e qenve endacakë, së paku tri herë, pra nga 3 milion denarë aktual, për të rritur alokimet buxhetore në së paku 9 milion denarë. Këto fonde do të përdoren si urgjencë për të korrigjuar pasojat në periudhën derisa të zbatohet një zgjidhje sistemike;
- 3 Komuna e Tetovës, duke pasur parasysh burimet e kufizuara buxhetore, duhet të ndërtojë strategji për krijimin e një partneriteti me organizatat dhe fondacionet përkatëse ndërkombëtare që do të ndanin një pjesë të fondeve të tyre për ndërtimin e stacionit për trajtimin dhe kujdesin e qenve endacakë;
- 4 Duke pasur parasysh numrin e madh të objekteve shtetërore gjysmë të zbrazëta dhe të braktisura, në Tetovë nuk ka asnjë problem në lidhje me gjetjen e një hapësire të përshtatshme për ndërtimin e një stacioni të tillë;
- 5 Komuna përmes ndryshimit të duhur të planit të detajuar urbanistik duhet të parashikojë ndërtimin e një stacioni të tillë;
- 6 Shembujt me Gostivarin dhe Shkupin, mund të shërbejnë si një frymëzim i mirë për operacionalizimin e kësaj ideje të projektit;
- 7 Komuna e Tetovës, në bashkëpunim me nismat qytetare vendore, duhet të ndërmarrë angazhimin e duhur informativ-edukativ dhe komunikues i cili do të kontribuojë në ngritjen e mëtejshme të ndërgjegjësimit të qytetarëve për kujdes më të madh për kafshët, si dhe mundësitë për adoptimin dhe mbështetjen e qenve, të vendosur në qendrën e ardhshme e cila si entitet më vete, do të themelohet nga komuna e Tetovës.

BIBLIOGRAFIA

- Ligji për mirëqenien e kafshëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 113/07 dhe 136/11;
- Faqja zyrtare e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, fva.org.mk;
- Faqja zyrtare e komunës së Tetovës, tetova.gov.mk;
- Faqja zyrtare e Komunës së Gostivarit, gostivari.gov.mk;
- Ueb faqja zyrtare e qytetit të Shkupit, skopje.gov.mk;
- Aline Gil Alves Guilloux et.al, Stray dogs in urban fragments: Relation between population's perception of their presence and socio-demographic factors, Pesquisa Veterinária Brasileira, января 2018.

MANASTIRI SMART APP CITY

Bitola - SmartAPPcity

- Andrej Gulabovski





REZYME

Iniciativa “Bitola SmartAPPcity” është krijuar në bazë të nevojave të qytetarëve të Komunës së Manastirit, të cilat i referohen buxhetit komunal, transparencës dhe digjitalizimit të shërbimeve publike. Ky dokument mbulon një sërë reformash të propozuara që synojnë të rrisin besimin e qytetarëve në komunë duke rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për buxhetin; rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e planifikimit buxhetor; promovimin e transparencës së komunës përmes vendosjes së mjeteve digjitale për ndarjen e thirrjeve, dokumenteve strategjike, planeve të detajuara urbanistike, të dhënave statistikore; si dhe nëpërmjet digjitalizimit të shërbimeve publike.

METODOLOGJIA

Për nevoja të këtij dokumenti të politikave publike, kemi bërë hulumtime në mesin e banorëve të Komunës së Manastirit, intervista me punonjës në administratën komunale, dy fokus grupe me qytetarë nga ku kemi mbledhur të dhëna relevante përmes të cilave kemi krijuar konkluzione.

Pyetëtori i anketës që e realizuam në kuadër të këtij hulumtimi kishte për qëllim të hulumtojë qëndrimet e banorëve të Komunës së Manastirit për çështjet që kanë të bëjnë me transparencën e planifikimit buxhetor në komunë dhe digjitalizimin e shërbimeve publike. Në të morën pjesë 173 të anketuar.

Gjithashtu kemi realizuar dy fokus grupe me qytetarë ku jemi munduar të kuptojmë se sa e ndjejnë qytetarët nevojën për të vendosur reforma të tilla si dhe mundësinë e zbatimit nga administrata komunale.

Së fundi, për të kuptuar perspektivën e administratës komunale, kemi realizuar një sërë intervistash me udhëheqësit e njësive ose punonjësit e tyre: Njësia për çështje juridike dhe normative; Njësia për koordinim dhe kontroll buxhetor; Njësia për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit; Njësia e Teknologjisë Informatike në Komunën e Manastirit.

PËRKUFIZIMI, KONTEKSTI DHE RËNDËSIA E PROBLEMIT

Buxheti

Buxheti i Komunës së Manastirit publikohet në ueb faqe dhe në buletin zyrtar, por prezantimi kompleks i tij është pengesë që qytetari i thjeshtë të kuptojë thelbin dhe planifikimin dhe shpenzimin e mjeteve sipas dedikimit. Kjo konfirmohet nga hulumtimi ynë.


Si fillim, shumica e qytetarëve në Komunën e Manastirit nuk janë të njohur me buxhetin komunal (56%). 45% e qytetarëve e kuptojnë buxhetin ashtu siç paraqitet tani, 30% nuk e kuptojnë, dhe 25% nuk e kanë parë buxhetin.

Pothuajse të gjithë të anketuarit deklaruan se nuk ishin të përfshirë në krijimin e buxhetit dhe/ose planifikimin e shpërndarjes së mjeteve. Nga ata që kanë marrë pjesë, më së shpeshti ishte përmes dorëzimit të propozimeve dhe iniciativave në Komunë, përfshirje direkte nga vendi i punës, procese forumesh.

A keni qenë në ndonjë mënyrë të përfshirë në krijimin e buxhetit të Komunës dhe/ose planifikimit dhe alokimit të mjeteve?



Nëse përgjigja e pyetjes së mëparshme është po, kjo është bërë përmes:



Për këtë problem është në dijeni edhe Komuna e Manastirit. Përfaqësues i Njesisë për Koordinimin e Buxhetit dhe Kontrollin e Buxhetit tha se "...përfshirja e qytetarëve është në një nivel shumë të ulët dhe duhet gjetur një mënyrë për t'i inkurajuar ata të marrin pjesë."

TRANSPARENÇË

Komuna e Manastirit në vitin 2021, në indeksin e transparencës së Qendrës për Komunikim Civil është në vendin e 11-të në konkurrencën e 97 institucioneve në nivel lokal dhe qendror. Sipas autorëve:

Manastiri e humbi pozitën shumëvjeçare udhëheqëse [kur flasim për komunat], përkundër përmirësimit të transparencës aktive nga viti i kaluar 88% në 91%⁵.


⁵ Qendra për Komunikime Civile, Indeksi i Transparencës Aktive (2021). Në dispozicion në: <https://ww->

Edhe qytetarët e Komunës së Manastirit pajtohen se komuna në përgjithësi është transparente (73%). Sa i përket publikimit publik, transparent dhe me kohë të thirrjeve publike, planeve strategjike, dokumenteve dhe programeve, planeve të detajuara urbanistike, qytetarët kanë qëndrime të ndara.


A mendoni se Komuna është mjaft transparente?




A i publikon Komuna thirrjet publike në mënyrë të hapur, transparente dhe në kohë të saktë?



A i shpall Komuna publikisht të gjitha planet strategjike, dokumentet, programet?




A janë publike ndryshimet në planet e detajuara urbanistike (PDU) përpara miratimit të tyre?



Sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve në debatin publik për ndryshimin e planit të detajuar urbanistik, më shumë se 96% kanë deklaruar se nuk kanë marrë pjesë asnjëherë.

A keni marrë pjesë ndonjëherë në debat publik për ndryshimin e planit të detajuar urban?



Këtë problem e ka identifikuar edhe Njësia për Planifikim Urbanistik dhe Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Manastirit, andaj përfaqësuesi tha:

“Duke qenë se ndryshimet në PPU dhe miratimi i një plani të ri apo ndryshimet në planin e detajuar urbanistik, nuk janë aq të zakonshme, por sigurisht janë mjaft të pakuptueshme për qytetarët laikë në këtë pjesë, do të thosha se duhet përpjekje për të arritur sa më shumë lehtësira për një prezantim sa më të thjeshtë të qytetarëve”

DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Shërbimet publike janë baza e një shoqërie të drejtë, sepse në këtë mënyrë qytetarët kanë qasje në mundësitë për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre, por edhe për të mbrojtur anëtarët më rrezikuar të komunitetit. Kështu, shteti mundëson qasje në shëndetësi, arsim, shërbime sociale, por rregullon edhe detyrime për qytetarët, me qëllim të mbrojtjes së interesit publik. Për këtë arsye është e një rëndësie të veçantë që shteti të ketë: ofrimin e shërbimeve të orientuara nga qytetari, procedura administrative të drejta dhe efikase, mekanizma për sigurimin e cilësisë së shërbimeve publike dhe disponueshmërinë e shërbimeve publike⁶.

⁶ Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve, Si drejt shërbime publike më të mira për qytetarët (2019).

Komuna e Manastirit ka publikuar në ueb faqen e saj listën e dyzet shërbimeve që ofron për qytetarët⁷. Gjithashtu, Komuna e Manastirit në bashkëpunim me Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, si dhe në kuadër të Strategjisë për Reformën e Administratës Publike 2018-2022 (pika 4.2.5)⁸, hapi “Një pikë për shërbime” përmes së cilës 64 shërbime do të jenë në dispozicion të qytetarëve të Komunës së Manastirit⁹.

Në anketën që kemi bërë për nevojat e këtij hulumtimi, 92% e të anketuarve tanë nga Komuna e Manastirit besojnë se digjitalizimi i shërbimeve është diçka që nevojitet. Në pyetjen nëse Komuna e Manastirit ka shërbime të mjaftueshme elektronike, përqindja më e madhe e qytetarëve, gjegjësisht 48% besojnë se ka, por jo mjaftueshëm; 21% mendojnë se nuk ka fare shërbime elektronike; 16% mendojnë se ka mjaft; dhe 15% nuk kanë informacion. Qytetarët në masë të madhe besojnë se vendosja e shërbimeve elektronike do të zvogëlojë kostot e qytetarëve, kohën e nevojshme për qasje në shërbim dhe rrezikun nga korrupsioni.

Arsyet kryesore që aktualisht i pengojnë qytetarët të përdorin shërbimet elektronike janë mungesa e informimit (52%) dhe mungesa e qasjes në internet (30%). Qytetarët më së shumti do të donin që të mund t'i shtronin pyetje në mënyrë digjitale kryetarit të komunës (35%) dhe të mund të ndiqnin lëvizjen e lëndës së tyre në mënyrë digjitale (24%).

Mund të konstatojmë se problem kyç mbetet nevoja që Komuna e Manastirit të prezantojë mjete të digjitalizuara në ofrimin e qasjes në shërbimet publike si dhe rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në krijimin e buxhetit dhe kontrollin e shpenzimit të parave publike.

ZGJIDHJET E MUNDSHME

“Bitola SmartAPPcity” përfshin një sërë ndryshimesh që kontribuojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e situatës në fushën e shërbimeve digjitale dhe transparencës, me qëllimin përfundimtar rritjen e luftës kundër korrupsionit, si më poshtë:

Në lidhje me buxhetin:

Vendosja e buxhetit qytetar dhe qasje e digjitalizuar për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve në krijimin e buxhetit;

Për sa i përket transparencës:

Paraqitje publike e të gjitha transaksioneve të Komunës sipas dedikimit, datës së pranimit ose pagesës dhe vlerës;

Paraqitja publike e të gjithë debitorëve në bazë të tatimit mbi pronën;

Në lidhje me digjitalizimin e shërbimeve publike:

Krijimi i një sistemi për monitorimin e lëndëve, ku qytetarët do të kenë mundësi nga kudo të kontrollojnë shkallën e zgjidhjes së lëndës së tyre;

Krijimi i një aplikacioni për të rritur marrëdhënien dhe besimin mes kryetarit të komunës dhe qytetarit.

⁷ Komuna e Manastirit, Lista e shërbimeve. Në dispozicion në: <https://bit.ly/37JuY90>. [Qasur më 19.8.2021]

⁸ Qeveria, Strategjia për reformë të administratës publike 2018-2022 dhe Plani i Veprimit. Në dispozicion në: <https://mioa.gov.mk/?q=mk/node/1587>. [Qasur më 19.8.2021]

⁹ Komuna e Manastirit, Një pikë për shërbime. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3CLUV69>. [Qasur më 19.8.2021]

BUXHETI

Instalimi i mjetit buxhet qytetar

Një nga mënyrat për të tejkaluar problemin me kuptimin e buxhetit është vendosja e një forme më të thjeshtë të buxhetit komunal dhe prezantim më i thjeshtë i qëllimit, sa dhe çfarë është planifikuar në buxhetin e vitit, ose i ashtuquajtur "buxheti qytetar.". Angazhimi më i madh është zbulimi i të gjitha shpenzimeve të fshehura nën zërat e koduar të buxhetit.

Në këtë mënyrë, të anketuarit në hulumtim besojnë se një formë më e thjeshtë e buxhetit dhe prezantim më i thjeshtë për cilin dedikim, do të kontribuojë në besim më të madh nga ana e tyre ndaj komunës, gjegjësisht nëse një version i thjeshtuar në të cilin të gjitha të hyrat dhe shpenzimet janë të theksuara qartë do të inkurajonte qytetarët, të bëjnë këqyrje në buxhetin komunal çdo vit me rastin e miratimit të tij, rishikimit dhe llogarive përfundimtare.

ПОСЕБЕН ДЕЛ

		948.424.000	396.047.000	66.172.000	474.422.000	23.974.000	0	958.616.000
Програма Подпрограма Категорија Ставка	О П И С	Предходен буџет	Б У Џ Е Т					ВКУПНИ Расходи
			Буџет	Расходи од самофин. активности	Расходи од дотации	Расходи од донации	Расходи од кредити	
W0	ПРОТИВПОЖАРНА ЗАШТИТА	11.767.000	3.403.000	0	8.437.000	0	0	11.840.000
	ПРИХОДИ:							
W00	ПРОТИВПОЖАРНА ЗАШТИТА	11.767.000	3.403.000	0	8.437.000	0	0	11.840.000
	РАСХОДИ:							
40	ПЛАТИ И НАДОМЕСТОЦИ	8.437.000	0	0	8.437.000	0	0	8.437.000
401	Основни плати	5.812.000	0	0	5.812.000	0	0	5.812.000
402	Придонеси за социјално осигурување	2.625.000	0	0	2.625.000	0	0	2.625.000
42	СТОКИ И УСЛУГИ	3.330.000	3.403.000	0	0	0	0	3.403.000
421	Комунални услуги, греење, комуникација и транспорт	1.010.000	1.010.000	0	0	0	0	1.010.000
423	Материјали и ситен инвентар	1.760.000	1.760.000	0	0	0	0	1.760.000
424	Поправки и тековно одржување	560.000	633.000	0	0	0	0	633.000

Prezantimi standard i buxhetit ¹⁰

ARSIM



Shembull i një buxheti qytetar ¹¹

¹¹ Komuna e Shtipit, Buxheti për vitin 2021. Në dispozicion në: <http://www.stip.gov.mk/index.php/m-k/budjet/4197-budjet-za-2021>. [Qasur më 19.8.2021]

¹² Komuna Qendër, Buxheti qytetar i Komunës Qendër për vitin 2017. Në dispozicion në: <https://www.fosm.mk/CMS/Files/Documents/Gragjanski-budjet-na-opshtina-centar-za.pdf>. [Qasur më 19.8.2021]

Në Komunën e Manastirit ka një disponim pozitiv për këtë propozim. Një përfaqësues nga Njësia për Koordinim Buxhetor dhe Kontroll të Buxhetit deklaroi:

Sa i përket prezantimit të thjeshtuar, gjegjësisht “buxhetit të qytetarëve”, absolutisht pajtohem me nevojën e krijimit të një paraqitje të tillë të buxhetit sepse ne si dëshmitarë si administratë komunale dhe këshilltarët në Këshill, por më së shumti qytetarët se si është buxheti, mënyra se si publikohet buxheti është kompleks për t'u kuptuar...

Pjesëmarrja në krijimin e buxhetit

Gjithëpërfshirja në procesin e krijimit të buxhetit zakonisht nënkupton përfshirjen e aktorëve politikë dhe organizatave të shoqërisë civile, ndërsa shumë rrallë vetë qytetarët thirren apo pyeten për nevojat që kanë në vendbanimin e tyre.

Prandaj, propozojmë krijimin e një aplikacioni përmes të cilit çdo qytetar i Komunës së Manastirit do të mund të shprehë mendimin e tij për një projekt të caktuar, do të mund të parashtrojë propozim ide ose në ndonjë mënyrë tjetër të kontribuojë në krijimin e buxhetit. Vetë Komuna është e interesuar për një komunikim të tillë të dyanshëm, pasi në këtë mënyrë merr informacion “nga dora e parë” për nevojat dhe dëshirat e qytetarëve në një pjesë të caktuar të territorit të Komunës, të cilat mund të përdoren gjatë krijimit të politikave.

Disa komuna¹² në RMV kanë vendosur një mënyrë digjitale të përfshirjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në krijimin e buxhetit. Për shembull, përmes Anketave në Google¹³, në mënyrën më të thjeshtë, qytetarit i ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së shpejtë digjitale dhe paraqitjes së ideve përpara procesit të krijimit të buxhetit.

Siç e përmendëm në pjesën e parë, përgjithësisht qytetarët në një përqindje shumë të vogël marrin pjesë në përgatitjen e buxhetit. Megjithatë, gëzon fakti që gati 75% e qytetarëve do të donin të merrnin pjesë në krijimin e buxhetit, në përqindjen më të madhe përmes aplikimit digjital për sugjerime dhe ide (37%), përmes takimeve të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e Komunës dhe këshillit (25%) dhe proceset e forumit (20%). 74% e të anketuarve besojnë se me pjesëmarrje më të madhe në proceset buxhetore do të rritet besimi i tyre në Komunë. .

TRANSPARENCA

Transparenca fiskale

Përmirësim i dukshëm i transparencës do të kishim nëse Komuna e Manastirit vendos të prezantojë publikisht të gjitha transaksionet e saj dhe transaksionet e institucioneve dhe kompanive që i themelon, sipas dedikimit. Kjo praktikë tashmë është vendosur në nivel kombëtar, me prezantimin e Portalit të Financave të Hapura .

12 Komuna e Bogdancit, Pyetësi për mbledhjen e propozimeve buxhetore të NJVL Bogdanci për vitin 2021 - mer pjesë, planifiko, propozo. Në dispozicion në: <https://bit.ly/2W2nUSK>. [Qasur më 19.8.2021]

13 Komuna e Dojranit, Merr pjesë në krijimin e Buxhetit të Komunës së Dojranit për vitin 2021. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3Dakdv1>. [Qasur më 19.8.2021]

14 Ministria e Financave, Financa të Hapura. Në dispozicion në: <https://open.finance.gov.mk/mk/home>. [Qasur më 19.8.2021]


Në fakt, sipas të anketuarve tanë, monitorimi publik i transaksioneve të Komunës do të rrisë besimin tek Komuna, do të ulë rrezikun e korrupsionit, do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e Komunës. Edhe Komuna e Manastirit është e vetëdijshme se masa të tilla mund të rrisin besimin në komunë. Sipas një përfaqësuesi të Njësisë për Koordinim Buxhetor dhe Kontroll të Buxhetit:

Padyshim, prezantimi i thjeshtuar i buxhetit për sa i përket procesit të krijimit të tij, ndarja e buxhetit sipas zërave dhe prezantimi i qëllimeve specifike të mjeteve të planifikuara në buxhet kontribuojnë në pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në të gjithë procesin buxhetor dhe proporcionalisht rikthen besimin tek institucionet.

Edhe Njësia e TI-së, ka shprehur gatishmëri nëse paraprakisht zgjidhen dilemat ligjore.

Shumica e qytetarëve nga Komuna e Manastirit do të mund t'i përcjellin transaksionet komunale duke vendosur billboard në qendër të qytetit (36%), në rrjetet sociale (24%) dhe përmes ueb-faqes (17%).

Për ilustrim, në Komunën e Banja Lukës, BeH, është vendosur një sistem i monitorimit elektronik të transaksioneve të kryera nga Komuna përmes një billboardi publik të vendosur në rrugët më të frekuentuara të qytetit. Kështu, qytetarët mund të shohin në çdo kohë dhe të kontrollojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet nga arka e komunës.



Billboard publik me paraqitje të transaksioneve elektronike dhe informacione të tjera të dobishme të Komunës së Banja Lukës, BeH¹⁵

Informata veçanërisht të rëndësishme për qytetarët janë thirrjet dhe njoftimet publike të publikuara nga Komuna, ndërkaq nga të cilat varet qasja në shërbime të caktuara apo informacioni në kohë për krijimin e obligimeve për qytetarët. Megjithatë, duhet të jemi të vetëdijshëm për aftësitë digjitale të pabarabarta që kanë qytetarët, ndaj jo të gjithë dinë të menaxhojnë pajisjet elektronike në mënyrë që të informohen rregullisht dhe në kohë përmes ueb faqes së Komunës, zëdhënësit zyrtar ose në rrjetet sociale.

Përmes mjeteve digjitale, qytetarët do të kenë mundësi të informohen për të gjitha thirrjet publike të publikuara nga Komuna.

15 RTV BN, "Bićemo grad bez korupcije, kriminala i nepotizma" (22.2.2021). Në dispozicion në: <https://www.rtvbn.com/4001275/bicemo-grad-bez-korupcije-kriminala-i-nepotizma>. [Qasur më 19.8.2021]

Transparenca në publikimin e dokumenteve strategjike

Ndonëse Komuna e Manastirit ka një indeks përgjithësisht të lartë të transparencës, i cili ndër të tjera përfshin publikimin e dokumenteve kyçe, publikimi të programeve, planeve, strategjive dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Këshilli Komunal duhet të vazhdojë. Rekomandimi është që të plotësohen mediat përmes të cilave publikohen dokumentet, gjegjësisht të ndiqet shembulli i Komunës së Banja Lukës, BeH dhe të vendoset një billboard elektronik ose tabelë informative elektronike, në një vend të frekuentuar dhe lokacion të qasshëm.

Transparenca në publikimin e të dhënave statistikore

Qytetari gjykon sipas bindjes së tij personale dhe shpeshherë e ndërton qëndrimin e tij mbi bazën e informacionit të disponueshëm për këtë çështje, duke përfshirë statistikën e disponueshme për punën e komunës për vitet e kaluara ose sipas parametrave që ai i konsideron parësore dhe të rëndësishme gjatë marrjes së vendimit për cilin përfaqësues të japë votën e tij. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të dhënat statistikore në lidhje me operacionin të insistohet që t'i transmetohen çdo qytetari.

Paraqitja publike e të gjithë debitorëve në bazë të tatimit mbi pronën

Në shembullin e Komunës së Kavadarit¹⁶, dhe për të promovuar transparencën dhe disiplinën fiskale, propozojmë shpalljen publike të të gjithë personave fizikë dhe juridikë me vendbanim/ seli në Komunë që janë debitorë në bazë të tatimit mbi pronë, tatimit për firmë dhe shërbimeve të tjera. Një përqindje e madhe e të anketuarve pajtohen me këtë propozim.

DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Sistemi i monitorimit të lëndës

Në përputhje me reformat në administratën publike në nivel kombëtar, komunat duhet të prezantojnë edhe zgjidhje digjitale që do të mundësojnë monitorimin e hapave në procedurën administrative nëpër të cilat kalon kërkesa/lënda e paraqitur dhe të cili zyrtar ndodhet në momentin e marrjes së vendimit. Përmes mjeteve digjitale me kod të parapërgatitur, qytetarët do të kenë mundësi të inspektojnë procedurën administrative përmes së cilës zgjidhet lënda, përkatësisht kërkesa e paraqitur.

Tashmë kemi ndarë informacione se 24% e qytetarëve duan të ndjekin lëndën e tyre në mënyrë digjitale.

Në lidhje me mundësinë e Komunës së Manastirit që përmes procedurës administrative të sigurojë paraqitje digjitale të rrjedhës së lëndës, përfaqësuesi i NJësisë për Çështje Normative Juridike deklaroi:

¹⁶ Komuna e Kavadarit, Lista e debitorëve për tatimin mbi pronë të personave fizikë dhe juridikë dhe tarifa komunale për evidentim të firmës përfshirë vitin 2019. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3sxFjyw>. [Qasur më 19.8.2021]

Ne kemi një program të brendshëm digjital përmes të cilit mund të kontrollojmë në moment se te cili zyrtar gjendet rasti dhe te cili zyrtar duhet të dorëzohet, cilat dokumente janë dorëzuar dhe cilat dokumente mungojnë etj. Mendoj se është e nevojshme që fillimisht të sigurohet paraqitje e sigurt e rrjedhës së dokumenteve, në drejtim të lejimit të paraqitjes vetëm të parashtruesit të kërkesës/lëndës, por sigurisht nuk e di nëse kjo është e realizueshme nga departamenti i TI-së.

Përfaqësuesi i Njesisë për teknologji informatike për të njëjtën çështje deklaroi:

Sigurisht që mundet, por për mendimin tim është e nevojshme të krijohet një sistem i ri që do t'i përgjigjet nevojave që ndryshohen. Sigurisht, ky është një hap serioz që kërkon mbrojtje maksimale të të dhënave personale në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe krijimin e një sistemi të thjeshtë që qytetarët të mos kenë problem gjatë përdorimit.

Ueb aplikacioni "Kryetari im i komunës"

Besojmë se çdo pyetje e qytetarëve meriton një përgjigje të shpejtë, e cila nga ana tjetër do të rrisë kënaqësinë e qytetarëve në raport me shërbimet që Komuna është e detyruar të ofrojë. Prandaj, digjitalizimi ofron qasje të shpejtë në informacion, por edhe mjete përmes të cilave ai informacion transmetohet shpejt në anën tjetër. Prandaj, propozojmë krijimin e një aplikacioni përmes të cilit qytetarët do të mund t'i referojnë pyetjet në interes të tyre dhe interes publik tek shërbimet për marrëdhënie me publikun.

Më shumë se gjysma e të anketuarve tanë thanë se do ta përdornin këtë aplikacion.

I pyetur për mendim lidhur me idenë e "Kryetari im i komunës", përfaqësuesi i Njesisë së Teknologjisë Informatike në Komunën e Manastirit, tha:

...njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i përgjigjen çdo kërkesë për informacion publik brenda afatit të përcaktuar me ligj. Por nëse komuna ofron qasje alternative dhe më të shpejtë në informacione të tilla, sigurisht që është e dobishme për të dyja palët.

REKOMANDIMET DHE AKTIVITETET

Sipas të dhënave të mbledhura nga hulumtimi, intervistat me punonjës të administratës komunale dhe opinionet dhe pikëpamjet e pjesëmarrësve në të dy fokus grupet, si dhe bazuar në hulumtimet e mëparshme në fushën e transparencës dhe korrupsionit nga disa OJQ, i japim këto rekomandime adresuar Komunës së Manastir:

- 1 Prezantimi i paraqitjes më të thjeshtuar të mjeteve të planifikuara buxhetore, i ashtuquajtur i qytetarëve;
- 2 Vendosja e case management system, me çka do të mundësohet këqyrje e shpejtë digjitale në procedurat administrative, përkatësisht kërkesat e paraqitura apo rastet e iniciuara;
- 3 Sigurimi i pasqyrës së të gjitha transaksioneve të kryera nga Komuna, duke vendosur një billboard digjital në zonën e qendrës së qytetit;
- 4 Vendosja e mjeteve digjitale për përfshirjen e qytetarëve në procese të ndryshme, si përcaktimi i prioriteteve buxhetore apo miratimi i planeve të detajuara urbanistike;
- 5 Ofrimi i një mënyre të shpejtë dhe të thjeshtë komunikimi mes qytetarëve dhe organeve të Komunës, si p.sh. me prezantimin e aplikacionit “Kryetari im i komunës”.

BIBLIOGRAFIA

- Qeveria, Strategjia për reformë të administratës publike 2018-2022 dhe Plani i Vepërimit. Në dispozicion në: <https://mioa.gov.mk/?q=mk/node/1587>. [Qasur më 19.8.2021]
- Komuna e Manastirit, Lista e shërbimeve. Në dispozicion në: <https://bit.ly/37JuY90>. [Qasur më 19.8.2021]
- Komuna e Manastirit, Një pikë për shërbime. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3CLUV69>. [Qasur më 19.8.2021]
- Komuna e Bogdancit, Pyetësori për mbledhjen e propozimeve buxhetore të NJVL Bogdanci për vitin 2021 - mer pjesë, planifiko, propozo. Në dispozicion në: <https://bit.ly/2W2nUSK>. [Qasur më 19.8.2021]
- Komuna e Dojranit, Merr pjesë në krijimin e Buxhetit të Komunës së Dojranit për vitin 2021. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3Dakdv1>. [Qasur më 19.8.2021]
- Komuna e Kavadarit, Lista e debitorëve për tatimin mbi pronë të personave fizikë dhe juridikë dhe tarifa komunale për evidentim të firmës përfshirë vitin 2019. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3sxFjyw>. [Qasur më 19.8.2021]
- Komuna Qendër, Buxheti qytetar i Komunës Qendër për vitin 2017. Në dispozicion në: <https://www.fosm.mk/CMS/Files/Documents/Gragjanski-bud->

- Komuna e Shtipit, Buxheti për vitin 2021. Në dispozicion në: <http://www.stip.gov.mk/index.php/mk/budjet/4197-budjet-za-2021>. [Qasur më 19.8.2021]
- Ministria e Financave, Financa të Hapura. Në dispozicion në: <https://open.finance.gov.mk/mk/home>. [Qasur më 19.8.2021]
- RTV BN, "Bicemo grad bez korupcije, kriminala i nepotizma" (22.2.2021). Në dispozicion në: <https://www.rtvbn.com/4001275/bicemo-grad-bez-korupcije-kriminala-i-nepotizma>. [Qasur më 19.8.2021]
- Qendra për Komunikime Civile, Indeksi i Transparencës Aktive (2021). Në dispozicion në: <https://www.ccc.org.mk/images/stories/akt21.pdf>. [Qasur më 19.8.2021]
- Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve, Si drejt shërbime publike më të mira për qytetarët (2019). Në dispozicion në: <https://cup.org.mk/publication/publikacija%20mk.pdf>. [Qasur më 19.8.2021]

OHRID YOUTH HUB

Themelimi i qendrës
rinore në Ohër

-Angela Miteska





REZYME

Si një nga qytetet më të mëdha në vend, Ohri nuk ka një infrastrukturë të zhvilluar që do të plotësonte nevojat e të rinjve që jetojnë apo studiojnë këtu.

Për momentin, në këtë kuptim, ekziston institucioni kombëtar - Biblioteka "Grigor Prliçev" Ohër, e cila përveç veprimtarisë bibliotekare, nuk realizon aktivitete të tjera që do të parashikonin nevojat e popullatës së re.

Duke pasur parasysh dobësitë e perceptuara, qëllimi i këtij dokumenti është të tregojë nevojën për themelimin e një Qendre Rinore në Ohër (Ohrid youth hub), aktivitetet e së cilës do të parashikonin nevojat e të rinjve të moshës 15 deri në 29 vjeç.

PROBLEMI - KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Politika rinore është një fenomen i shoqërisë moderne, të cilin të gjitha vendet e zhvilluara përpiqen ta përmirësojnë, por më e rëndësishmja, rëndësia e së cilës kuptohet nga vendet në zhvillim.

Maqedonia e Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Maqedonia e V.) mund të thuhet se është diku në mes, sepse politikanët maqedonas janë të vetëdijshëm për nevojën dhe rëndësinë, por jo mjaftueshëm vigjilentë për të konkretizuar projektet që dalin nga politikat rinore.

Maqedonia e V. ndan vetëm 0,3% të buxhetit të përgjithshëm për zërin, arsim. Çdo komunë duhet të ketë një strategji rinore, që është rast për shumë autoritete lokale, por fatkeqësisht komuna e Ohrit nuk është pjesë e kësaj liste.

Gjithashtu, analiza e bërë për nevojat e këtij dokumenti ka treguar se Komuna nuk i shpenzon në mënyrë transparente paratë e dedikuara për zbatimin e politikave rinore dhe as nuk shfaq interes për përmirësimin dhe avancimin e këtij segmenti.

Pika fillestare e këtij dokumenti janë të rinjtë dhe e ardhmja e tyre si dhe mendimet dhe pikëpamjet e tyre për krijimin e një qendre që do të plotësojë nevojat e kategorive të ndryshme të të rinjve nga Ohri, si dhe të rinjve me qëndrim të përkohshëm në qytet për studime dhe arsimim.

Sipas hulumtimit të opinionit publik të realizuar në muajin qershor, nga 150 të rinj të anketuar të moshës 18 deri në 29 vjeç, që jetojnë në Komunën e Ohrit, 100% e tyre kanë përkrahur nevojën e krijimit të "Ohrid youth hub", në të cilën do të integroheshin funksionet e lartë përmendura.

Në të njëjtën kohë, sipas rezultateve të fokus grupeve të realizuara më 27 qershor 2021, në pyetjen se si do të tërhiqen të rinjtë nga Ohri që të bëhen pjesëmarrës aktivë në aktivitetin e qendrës rinore "Ohrid youth hub", përgjigjet e të anketuarve ishin se një qëllim i tillë mund të arrihet përmes organizimit të aktiviteteve tërheqëse për të rinjtë, duke shprehur jetësore, dëshirat, preferencat, karakteristikat psikologjike dhe demografike të të rinjve për të përmbushur nevojat e tyre kulturore dhe sociale.

Përfitimet për të rinjtë që nga themelimi i një Qendre të tillë, do të ishin vendosja e kontakteve me botën reale, reduktimi i delikuencës së të miturve dhe kanalizimi i energjisë të të rinjve në një drejtim pozitiv. Në fund, sipas pjesëmarrësve të fokus grupit, në raport me vendin (lokacionin) ku mund të ndërtohet Qendra në Ohër, është zona ku ndodhet ish-kazerma në qytet.

Analizë krahasuese

Bashkimi Evropian (BE) dhe vendet kandidate për anëtarësim, në vazhdimësi zbatojnë të ashtuquajturin “Dialog strukturor me të rinjtë”. Ky dialog është një lloj konsultimi i përhershëm në të cilin të rinjtë kanë mundësinë të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë aktivisht në procesin e krijimit të politikave që i prekin drejtpërdrejt. Bazuar në këtë proces të konfigurimit, Komisioni Evropian (KE) ka detyrimin të zhvillojë një dialog të vazhdueshëm me të rinjtë.

Përmes projektit “Ready for life, ready for society”¹⁷, nga ana tjetër, të rinjtë dhe KE po kërkojnë mënyra për të përmirësuar në radhë të parë standardin rinor.

Ky dokument strategjik identifikon tetë fusha në të cilat duhet të ndërmerren iniciativa, duke përfshirë ato që janë objekt i këtij hulumtimi, përkatësisht:

- **Edukimi dhe trajnimi;**
- **Punësimi dhe sipërmarrja;**
- **Shëndeti dhe mirëqenia.**

Ndryshe nga shembulli i mëparshëm, shembulli me Spanjën gjithashtu na jep njohuri të rëndësishme në këtë fushë¹⁸. Në këtë kuptim, shtyllën e shoqërimit rinor në Spanjë e përfaqësojnë, “Qendrat Informative Rinore” të cilat ndër të tjera ofrojnë informacion për të rinjtë lidhur me mundësitë për punë vullnetare.

Nga ana tjetër, Danimarka, ngjashëm me Spanjën, ka krijuar disa qendra rinore për nxënësit nën 18 vjeç, të cilat kanë funksionin e qendrave rekreative dhe argëtuese¹⁹.

Kroacia, si vend anëtar i BE-së, ka krijuar një numër të madh qendrash rinore në territorin e saj, të cilat kryejnë edhe funksionin e të ashtuquajturave “Inkubator” për promovimin dhe realizimin e ideve që duhet të përmirësojnë statusin e kësaj popullate²⁰.

- Radio MOF (2017) [Galeria] Patinatorët para Qeverisë në vitet 80 dhe 90. [online] Në dispozicion në: <https://www.radiomof.mk/galerija-skejterite-pred-vlada-vo-80-tite-i-90-tite-godini/> [Qasur në 9 gusht 2021].
- Radio MOF (2020) Një velodrom i dytë "pamprak" u hap në Parkun e Qytetit.[online] Në dispozicion në: <https://www.radiomof.mk/vo-gradskiot-park-otvoren-vtor-pamprak-velodrom/> [Qasur në 9 gusht 2021].
- Radio MOF (2014) Është hapur skejt parku i ri në Shkup. [online] Në dispozicion në: <https://www.radiomof.mk/otvoren-noviot-skejt-park-vo-skopje/> [Qasur në 9 gusht 2021].
- Radio MOF (2014) A do të ketë Shkupi një skejt park funksional? [online] Në dispozicion në: <https://www.radiomof.mk/ke-dobie-li-skopje-funksionalen-skejt-park/> [Qasur në 9 gusht 2021].
- MKD.mk (2014) Skejt parku i ri në kejin e Vardar është hapur (FOTOGALERI) [online] Në dispozicion në: <https://www.mkd.mk/makedonija/skopje/otvoren-noviot-skejt-park-na-kejot-na-varдар-fotogalerija#1> [Qasur në 9 gusht 2021].
- Veçer (2006) Skejterët zunë vendin e tyre nën diell - Veçer [online] Në dispozicion në: <https://bit.ly/37sKO7I> [Qasur në 9 gusht 2021].



LGBT + QYTETI INKLUZIV SHKUP

Masat dhe politikat e propozuara

- Evgenija Janakieska



REZYME

Diskriminimi është një fenomen që ndodh brenda çdo komuniteti vendor, në baza të ndryshme, përmes formave të ndryshme dhe në fusha që janë përgjegjësi e pushtetit qendror dhe atij vendor. Kështu, njerëzit LGBT + janë shumë më shpesh të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të dhunës të motivuar nga urrejtja dhe përgjithësisht jetojnë të rrethuar nga stigma, diskriminimi dhe dhuna e urrejtjes. Termi LGBT + është një shkurtim për lezbiket, gej-meshkuj, biseksualët dhe transgjinatorët, ndërsa shenja e veçantë "+" është prapashtesë për të gjitha ato identitete seksuale dhe gjinore që devijojnë nga norma hetero-normative dhe nuk mbulohen nga katër termat.

Të rinjtë LGBT + janë shënjestër e bullizmit, madje edhe dhunës fizike nga bashkëmoshatarët e tyre, dhe kur "dalin nga dollapi" (duke i deklaruar familjes dhe mjedisit se janë, për shembull, gej, lezbike ose trans), ata shpesh janë viktima të dhunës në familje. Për qytetarët e Maqedonisë, homoseksualët janë një nga grupet më pak të pranueshme të bashkëqytetarëve (31.7%)⁶⁶. 36.8% e personave LGBT + janë diskriminuar në vendin e punës, 39% janë diskriminuar në ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes sociale dhe 30.77% janë diskriminuar në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor kur raportojnë rastet në stacionet policore⁶⁷. Të dhënat thonë se 96.6%⁶⁸ e personave LGBT + përballën me një formë diskriminimi dhe 76.6% e tyre kanë qenë të diskriminuar në bazë të orientimit seksual. Të dhëna të tilla kontribuojnë që personat me vendosmëri LGBT + të jenë në rrezik më të madh për t'u pushuar nga puna, për t'u mohuar strehimin ose shërbimet publike nga institucionet, ose për t'u dëbuar nga një restorant apo zyrë vetëm për shkak të përcaktimit të tyre. Në këtë drejtim, në vendin tonë ka politika për parandalimin e diskriminimit në nivel qendror, por në nivel lokal nuk ka dokumente strukturore apo mekanizma për përmirësimin e pozitës së popullsisë LGBT+.

Komuna, si një komunitet në nivel lokal ku të rinjtë jetojnë dhe lëvizin çdo ditë, duhet të ofrojë sisteme mbështetjeje dhe këshillimi për personat LGBT +, asistencë për prindërit e të rinjve LGBT + dhe programe përmes të cilave ata do të fuqizohen dhe tu ndihmojnë për të jetuar të pavarur. Bashkësia lokale duhet të ofrojë një mjedis të sigurt që do të promovojë mos diskriminimin.

Pra, zgjidhja kryesore që propozon ky dokument duke ndjekur shembullin e qyteteve miqësore evropiane LGBT + është futja e një plani lokal për përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë LGBT +. Aktualisht, asnjë plan vendor nuk mbulon drejtpërdrejt popullatën LGBT +, gjë që e forcon më tej nevojën për të. Ky plan duhet të përfshijë një sërë aktivitete të destinuara për shërbime, mbështetje për popullatën LGBT+, por edhe rritje të edukimit të popullatës për ta pranuar atë.

66 Kultura Politike, Identitetet dhe Shoqëria Civile, FShHM, 2017 (në dorëshkrim)

67 Analizë e problemeve dhe nevojave të personave LGBTI në Republikën e Maqedonisë në fushën e mbrojtjes sociale, shërbimeve juridike dhe veprimeve policore. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut

e Republikës së Maqedonisë - Qendra për Mbështetjen e LGBTI,

68 Hulumtim mbi përvojat dhe njohuritë për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi i grupeve të cenueshme të qytetarëve, Instituti për të Drejtat e Njeriut, 2019, f. 64

PROBLEMI - KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Çfarë është LGBT+?

Akronimi LGBT mbulon një gamë të gjerë grupesh: lezbike, meshkuj-gej, biseksualë dhe persona transgjinorë⁶⁹ dhe si i tillë është përdorur që nga fillimi i viteve 1990 si një term gjithëpërfshirës për identitetin seksual dhe gjinor.

Me kalimin e viteve, shkurtesa ka ndryshuar dhe më vonë kësaj shkurtese i janë shtuar edhe identitete të tjera: LGBT-TIKA (T - transgjinor, T - transeksual, I - interseksual, K - kuier, A - persona aseksual). Megjithatë, për shkak të konsideratave të përjashtimit dhe shtimit të identiteteve të reja, sot përdoret shkurtesa LGBT +, e cila përfshin të gjitha ato identitete seksuale dhe gjinore që devijojnë nga norma heteronormative. Shkurtesa (LGBT +) në thelb përfshin dy koncepte: orientimin seksual, i cili karakterizohet nga tërheqja emocionale, romantike dhe seksuale ndaj njerëzve të një gjinie të caktuar. Identiteti gjinor (mënyra se si e përjetojmë veten) shpesh barazohet me gjininë⁷⁰. Transgjinorizmi është një term disi më kompleks, sepse nuk i referohet tërheqjes seksuale, por identitetit gjinor.

Personat LGBT + janë një grup i marginalizuar, i cili diskriminohet nga shoqëria (institucionet, bashkëqytetarët...), i cili përballet me rrezikun e varfërisë, paarritshmërisë ndaj shërbimeve themelore publike, si: kujdesi shëndetësor, mbrojtja policore, trajtimi dhe njohja e barabartë e identitetit. Të dhënat thonë se 96.6%⁷¹ e personave LGBT + përballesh me një formë diskriminimi dhe 76.6% e tyre kanë qenë të diskriminuar në bazë të orientimit seksual. Më konkretisht, personat LGBT+ më së shpeshti përjetojnë diskriminim në vendin e punës, pra 66.6% janë diskriminuar në vendin e punës, 40% janë diskriminuar në organet e drejtësisë dhe administrative dhe në qasjen në të mira dhe shërbime. Një masë e konsiderueshme 43.3% janë diskriminuar në arsim, shkencë dhe sport⁷². Edhe pse kuadri ligjor në bazë të Ligjit për Parandalimin e Diskriminimit është gjithëpërfshirës dhe i qartë, shumë nga këto probleme me të cilat përballet komuniteti LGBT+ janë për shkak të mungesës së mekanizmave të duhur në nivel lokal përmes të cilëve ata do të mund t'i ushtrojnë të drejtat e tyre.

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË KOMUNITETIT LGBTI

Vitet e fundit në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë bërë hapa të rëndësishëm në këtë temë:

- Strategjia Kombëtare për Barazi dhe Mosdiskriminim 2016-2020, e cila avokon për promovimin e mbrojtjes nga diskriminimi i kryer ndaj personave LGBT+, e cila krijoi kushte për miratimin e Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.
- Formimi i Grupit parlamentar ndërpartiak për LGBT+

69 Një fjalor i plotë i termeve është i qasshëm në lidhjen e mëposhtme <http://lgbti.mk/%D0%BF%D0%BE%D0%B8%D0%BC%D0%BD%D0%B8%D0%BA/>

70 Manual për punëtorët rinorë "Ngritja e kapaciteteve për të punuar me të rinjtë LGBT", Fronti Subversiv, 2017, f. 21

71 Hulumtim mbi përvojat dhe njohuritë për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi i grupeve të cënueshme të qytetarëve, Instituti për të Drejtat e Njeriut, 2019, f. 64

72 Ibid, f.65

- Miratimi i Ligjit për Mbrojtjen dhe Parandalimin e Diskriminimit, i cili paraqet orientimin seksual dhe identitetin gjinor si bazë për sigurimin e mbrojtjes nga diskriminimi dhe përcakton diskriminimin ndër sektorial.
- Themelimi i Komisionit për Mbrojtjen dhe Parandalimin e Diskriminimit, i cili është organ i pavarur dhe është në sajë të personit juridik. Ai përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët i zgjedh dhe i shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Komisioni ndërmerri aktivitete për promovimin dhe mbrojtjen e barazisë, të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit, jep mendime dhe rekomandime, promovon parimin e barazisë, të drejtën për mosdiskriminim dhe trajtimin e të gjitha formave të diskriminimit duke rritur ndërgjegjësimin, informimin dhe edukimin e publikut⁷⁴.
- Realizimi i trajnimeve kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes për punonjësit e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) dhe organeve të tjera shtetërore.
- Mbajtja e Paradës së parë të krenarisë në 2019, e dyta (e cila për shkak të pandemisë Covid-19 u mbajt online) dhe mbajtja e Paradës së tretë të krenarisë në qershor 2021.
- Miratimi i Ligjit të ri për arsimin fillor i cili përfshin orientimin seksual dhe identitetin gjinor (OSIGj) dhe eliminon diskriminimin ndaj OSIGj⁷⁵.
- Përgatitja e projektligjit për tekstet shkollore dhe materiale të tjera mësimore e didaktike në arsimin fillor dhe të mesëm⁷⁶. Miratimi i një rregulloreje të tillë do të kontribuonte në uljen e paragjykimeve dhe stereotipeve në tekstet shkollore, gjë që është një nga nevojat e ligjit dhe është shënuar në Raportin për vlerësimin e ndikimit të rregullores për të njëjtën.

QYTETI I SHKUPIT DHE LGBT+

Edhe pse pjesa më e madhe e kompetencave për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT+ janë të pushtetit qendror, megjithatë vetëqeverisja lokale luan një rol të rëndësishëm. Pa pjesëmarrjen aktive të Komunave dhe Këshillave në drejtim të miratimit të masave dhe politikave në nivel lokal dhe bashkëpunim me institucionet në nivel qendror, nuk mund të pritët asnjë hap real përpara në ndërtimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.

Konkretisht, bashkëpunimi i pushtetit lokal me stacionet policore lokale dhe shkollat nën juridiksionin e komunave, si dhe zbatimi i masave dhe politikave që janë në kompetencë të vetëqeverisjes lokale janë kyçe për krijimin e një mjedisi të sigurt për personat LGBT+

74 Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 101 nga 22.5.2019, e qasshme në -27.5-Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi.pdf (mtsp.gov.mk)

75 Carovska: Përmes një modeli të kombinuar të teksteve shkollore, deri te vënia në skenë e digjitalizimit dhe modernizimit të arsimit | Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në - <https://vlada.mk/node/24945>

76 Projektligji është ende në proces miratimi. Është i qasshëm në linkun e mëposhtëm - https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_detail&itemid=64178

Pushtetet vendore munden dhe duhet të miratojnë një Strategji Lokale për Mbrojtjen e grupeve të marginalizuara në komunitetin lokal (përfshirë LGBT +), për të ndarë fonde për të mbështetur dhe promovuar ngjarje kulturore dhe artistike kuier, për të ndarë fonde për ngritjen e shtëpive të sigurta dhe qendrave për asistencë dhe mbështetje për viktimat e dhunës LGBT+, si dhe ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë të punësuar në komuna për trajtim etik dhe mosdiskriminim në punën me personat LGBT +. Në këtë kontekst, për nevojat e këtij dokumenti janë realizuar fokus grupe me përfaqësues të popullatës LGBT+ në territorin e qytetit të Shkupit. Sfidat më të mëdha për mbrojtjen nga diskriminimi në nivel lokal janë si më poshtë:

- Nivelet e njohurive dhe shkathtësive për trajtimin e diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes në mesin e punonjësve të njësisve të vetëqeverisjes lokale janë mjaft të ulëta.
- Bullizmi në shkollat e mesme dhe fillore në territorin e qytetit të Shkupit, nga të cilat shkollat e mesme janë në kompetencë të drejtpërdrejtë të qytetit, ndërsa shkollat fillore janë në kompetencë të komunave në territorin e qytetit të Shkupit.
- Mungesa e një strategjie apo programi lokal që do të ndihmojë në uljen e stigmës ndaj kësaj kategorie qytetarësh dhe promovimin e mbështetjes, tolerancës dhe pranimit nga komuniteti.
- Mbrojtja joefektive e viktimave të dhunës LGBT+

Nga ana tjetër, qyteti i Shkupit ka ndërmarrë një sërë iniciativash që synojnë përmirësimin e gjendjes së popullatës LGBT+. Qyteti i Shkupit në vitin 2019 ka lëshuar një nga objektet e tij afariste për qëllime të projektit "Komiteti" – projekt i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (KHDNJ) për mbështetjen e personave LGBT+ në Shkup. Përmes një memorandum bashkëpunimi mes MKC dhe KHDNJ, hapësira në garazhin shumëkatësh Beko është vend për takime, trajnime, por edhe një program kulturor i dedikuar për këta persona. Pastaj, qyteti në vitin 2019 ka nënshkruar një memorandum me organizatën qytetare "Më të fortë së bashku" për të zbatuar Deklaratën e Parisit për t'i dhënë fund epidemisë së HIV-it, duke marrë në këtë mënyrë detyrimet ndërkom-bëtare për të punuar në çështjet që prekin më shumë aspektet shëndetësore të këtyre komuniteteve. Dhe së fundi, Qyteti i Shkupit ndihmon me financa dhe burime të tjera të iniciativave të ndryshme që punojnë në mbështetje të personave LGBT+ në Shkup, siç janë projektet e shëndetit seksual dhe riprodhues të zbatuara nga organizata e shoqërisë civile HERA, si dhe një sërë projektesh dhe ngjarjesh kulturore të financuara përmes konkursit kulturor i cili shpallet çdo vit nga qyteti⁷⁷.

ALTERNATIVA DHE ZGJIDHJE

Bazuar në sfidat dhe gjetjet e përmendura tashmë për situatën e popullsisë LGBT+, Mbështetja e personave LGBT+ duhet të shkojë në drejtim të ofrimit të sigurisë më të madhe në hapësirat publike, mbështetjes së mekanizmave të krijuar tashmë nga organizatat për mbrojtjen e viktimave të dhunës LGBT+, si dhe bashkëpunimit me stacionet policore në territorin e lokalitetit.

⁷⁷ Të dhënat janë marrë përmes një interviste të thellë me një përfaqësues të Qytetit të Shkupit të bërë në mënyrë elektronike në korrik 2021

Vetëqeverisja, trajtimi etik i viktimave, shmangia e viktimizimit të dyfishtë dhe mbrojtja efektive dhe efikase kundër dhunës dhe parandalimit.

Mbi të gjitha, nevojitet një qasje sistematike ndaj kësaj çështjeje, e cila në afat të gjatë do të përmirësojë situatën e popullsisë LGBT+ në nivel lokal. Kështu, më adekuate është krijimi i zgjidhjeve sipas shembullit të qyteteve miqësore evropiane LGBT+, pra futja e një plani lokal për përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë LGBT+.

Si pjesa e parë e planit duhet të mbulohen sensibilizimi i punonjësve ndaj çështjeve kuier dhe pranimi si nevoja relevante të komunitetit LGBT+. Të punësuarit në sektorë të ndryshëm të vetëqeverisjes lokale në qytetin e Shkupit dhe në komunat e Shkupit duhet të marrin pjesë në trajnime për trajtimin e diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe të forcojnë komunikimin me shërbimet e Qytetit të Shkupit (dhe komunat tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut).

Më tutje, **nevojitet një mbështetje më e madhe financiare për shërbimet e viktimave të dhunës të bazuara në OSIGj**. Një mbështetje e tillë do të përfshinte financimin e infrastrukturës ekzistuese të strehimoreve dhe ambienteve këshilluese të organizatave që punojnë me grupet e marginalizuara. Në këtë mënyrë, organizatat nuk do të shpenzojnë energji për të kërkuar mirëmbajtje, por do të fokusohen në ofrimin e mbështetjes për përdoruesit e shërbimeve të tyre, dhe njëkohësisht sigurohet zgjidhje e përhershme për funksionimin e qendrave të strehimit.

Gjithashtu, **është e rëndësishme të promovohet barazia, mos diskriminimi dhe pranimi i njerëzve kuier në nivel lokal** dhe kjo mund të bëhet duke zhvilluar fushata që promovojnë barazinë dhe vlerat që janë përfshirëse për të gjitha grupet, dhe ofrojnë mbështetje më të madhe për ngjarjet kulturore dhe artistike kuier (veçanërisht financiare).

Në aspektin arsimor, **është e rëndësishme që të ketë programe që flasin për ekzistencën e diversitetit dhe fushata në shkolla që promovojnë mos diskriminimin dhe sjellje jo të dhunshme**. Për një rezultat konkret në shkollat, krahas programeve, është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi me shërbimet profesionale nga shkollat dhe qendrat për punë sociale që kanë rolin kryesor në vërejtjen e dhunës dhe reagimin ndaj saj. Reagimi i shpejtë i punonjësve në shkolla dhe qendra për punë sociale nuk do të lejojë që dhuna të vazhdojë, apo ta fshehin atë nga prindërit që mund të kenë turp për dallimin e fëmijës së tyre, apo në rastet kur fëmija është viktimë e dhunës në familje për shkak të orientimi seksual të ndryshëm ose identitetit gjinor të ndryshëm nga prindërit. Është me rëndësi të theksohet se nën kompetencat e tij janë vetëm shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit.

Gjithashtu, qyteti i Shkupit si kryeqytet duhet të jetë bartës i ndryshimeve në përmirësimin e pozitës së popullatës LGBT+, me ç'rast mund të anëtarësohet në rrjetin e qyteteve të ylberit (Rainbow City Network)⁷⁸ i cili është një rrjet me mbi 30 qytete që kanë inkurajuar dhe shkëmbyer përvoja të inkluzionit social.

78 Më shumë informacion mund të gjeni në linkun e mëposhtëm- <https://www.rainbowcities.com/about-us/>

REKOMANDIME

- 1 Realizimi i alternativës së lartpërmendur kërkon në radhë të parë vullnetin politik dhe guximin e vendimmarrësve në nivel lokal. Këtu duhet të merret parasysh edhe mjedisi konservator dhe qëndrimet e qytetarëve ndaj popullatës LGBT +.
- 2 Megjithatë, futja e politikave dhe masave specifike në nivel vendor kërkon një proces të gjerë konsultimi me organizatat e shoqërisë civile deh dhe organizatat që punojnë me komunitetet e marginalizuara, përfshirë LGBT+.
- 3 Pas procesit të konsultimit, të iniciuar nga kryetari i qytetit të Shkupit, duhet të përgatitet një plan veprimi me hapa të definuar në të ardhmen drejt realizimit të zgjidhjeve alternative në nivel lokal si mekanizma të përhershëm që do të ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive, hapësira për zhvillim të kulturës kuier në nivel lokal, zona të sigurta dhe gjetja e një modeli optimal për funksionimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të mekanizmave të tillë lokalë, të cilët do të ndërtojnë një mjedis të sigurt për personat LGBT+ në komunitetin e tyre lokal.

BIBLIOGRAFIA

Ligje

- Ligji për parandalimin dhe mbrojtje nga diskriminimi, Neni 4, Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 258, nga 30.10.2020

Publikime dhe kërkime

- Hulumtim mbi përvojat dhe njohuritë për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi i grupeve të cënueshme të qytetarëve, Tatiana Temelkoska, Natasha Boskova, Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, 2019
- Manual për punëtorët rinorë "Ngritja e kapaciteteve për të punuar me të rinjtë LGBT", Fronti Subversiv, 2017
- Kultura Politike, Identitetet dhe Shoqëria Civile, FShHM, 2017 (në dorëshkrim)
- Analizë e problemeve dhe nevojave të personave LGBTI në Republikën e Maqedonisë në fushën e mbrojtjes sociale, shërbimeve juridike dhe veprimeve policore. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë – Qendra për Mbështetjen e LGBTI
- Intervistë e thelluar e realizuar me përfaqësues të Qytetit të Shkupit në mënyrë elektronike
- Intervistë e thelluar e zhvilluar me persona LGBT+ e realizuar në mënyrë elektronike
- Dy fokus grupe me individë LGBT+ dhe përfaqësues të organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile.

Ueb faqe dhe linqe

- <https://www.rainbowcities.com/about-us/>
- Carovska: Përmes një modeli të kombinuar të teksteve shkollore, deri te vënia në skenë e digjitalizimit dhe modernizimit të arsimit | Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (vlada.mk)
- 27,5-Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi.pdf (mtsp.gov.mk)
- LGBT_broshura_web.pdf (hera.org.mk)
<http://lgbti.mk>

QENTË ENDACAKË

Nga zgjidhje sipërfaqësore deri në
zgjidhje të qëndrueshme në
komunën e Prilepit

- Evgenija Markoska





REZYME

Qentë endacakë janë një problem në rritje në komunitetet urbane, dhe rrjedhimisht në qytete. Nuk bën përjashtim as Komuna e Prilepit, si një nga qytetet më të mëdha në vendin tonë. Komuna aktualisht nuk disponon të dhëna për numrin e qenve endacakë dhe ka as një zgjidhje strukturore për këtë problem. Sipas hulumtimit që kemi bërë për nevojat e këtij dokumenti, 92% e qytetarëve besojnë se Komuna e Prilepit po përballet me një numër të madh të kafshëve endacake dhe se ky numër çdo ditë po rritet. Gjithashtu, 2/3 e të anketuarve nuk ishin të njohur me masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga Komuna. Për zgjidhjen e përhershme të këtij problemi, Komuna e Prilepit duhet t'i ndryshojë veprimet e deritanishme sepse janë dëshmuar si të papërshtatshme dhe të pamjaftueshme. Qasja e tanishme e ofruar nga Komuna e Prilepit është bartja e përgjegjësisë për kujdesjen e qenve endacakë te NP Komunalec, përkundër faktit se ky nuk është aktiviteti i tyre primar dhe për këtë arsye nuk mund të investojnë plotësisht në zgjidhjen e problemit.

Ky problem krijon një sërë pasojash që ndjehen drejtpërdrejt nga qytetarët. Mbi të gjitha është pasiguria dhe frika e kafshimit nga qeni dhe mundësia e transmetimit të sëmundjeve, si dhe rritja e pakontrolluar e qenve dhe mungesa e kontrollit mbi ta. Përveç kësaj, ka edhe efekte në mjedis dhe pastërtinë publike, duke qenë se qentë endacakë dinë të shpërndajnë mbeturina dhe plehra nëpër rrugë; dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, pamundësia e trajtimit human dhe rritja e vdekshmërisë së qenve endacakë në mungesë të një qasjeje të strukturuar.

Sa i përket zgjidhjeve dhe alternativave të mundshme, si zgjidhje më e përshtatshme është krijimi i një shërbimi të pavarur apo ndërmarrje publike, aktiviteti primar i së cilës do të jetë përkujdesja ndaj kafshëve, p.sh. sipas dizajnit të NP Lajka - Shkup. Përfitimet nga instalimi i një kompanie të tillë janë: Monitorimi i rregullt i gjendjes dhe numrit të qenve endacakë përmes një baze të dhënash publike dhe të vetme; mundësia për të kërkuar identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve me një pronar; mundësi më e madhe për trajtimin, sterilizimin dhe kastrimin e qenve endacakë; rritja e mundësive për të adoptuar qen që tashmë janë nën kujdesin e kompanisë; duke ofruar shërbime veterinares për pronarët e qenve.

Gjithashtu, futja e një qendre të tillë do të sigurojë një fokus më të madh në edukimin e qytetarëve, që është një nga sfidat dhe rrënjët kryesore në zgjidhjen e këtij problemi.

PROBLEMI - KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Mbrojtja e të drejtave të kafshëve dhe kujdesi ndaj tyre është një problem që është vazhdimisht i pranishëm në shoqërinë tonë, por është bërë veçanërisht i rëndësishëm në 10 vitet e fundit. Pra, të drejtat e kafshëve janë pjesë e paletës demokratike të të drejtave ku një shoqëri duhet të tregojë progresin e saj në qëndrimin e saj ndaj kafshëve dhe të drejtën e tyre për jetë, në përputhje me natyrën e specieve të tyre. Një problem i veçantë në këtë çështje janë qentë endacakë, pra ata qen që nuk kanë pronarë dhe për shtëpi kanë rrugët e qytetit.

Çështja e kafshëve endacake dhe ekzistenca e statistikave të sakta rreth tyre është shumë komplekse⁷⁹, i mungojnë politikat moderne afatgjata për të adresuar çështjen e kafshëve endacake. Kështu, në mungesë të të dhënave zyrtare, nga pyetëtori i realizuar për nevojat e këtij dokumenti, 92% e qytetarëve⁸⁰ besojnë se Komuna e Prilepit po ballafaqohet me një numër të madh të kafshëve endacake dhe se ky numër çdo ditë po rritet. Nga ana tjetër, në vetë territorin e Komunës nuk ka një shërbim të posaçëm kompetent që mund të merret me këtë problem, natyrisht kur flasim për shërbim nënkuptojmë një institucion që do të ofrojë trajtim human të kafshëve. Qasja aktuale e ofruar nga Komuna e Prilepit është bartja e përgjegjësisë për përkujdesjen e qenve të rrugës tek Ndërmarrja Publike Komunalec, aktiviteti primar i së cilës nuk janë qentë endacak. Krahas përpjekjeve, një rol të madh luan edhe hapësira e papërshtatshme që ndahet për këto nevoja. Ky problem rrezikon më tej sigurinë e qytetarëve, ata janë të prekur nga rreziku i transmetimit të sëmundjeve, sjelljet agresive nga kafshët dhe ndotja e konsiderueshme e mjedisit, veçanërisht pranë kontejnerëve të mbeturinave.

Qentë endacakë kanë një ndikim negativ në mjedisin urban dhe shëndetin e njeriut. Ato shkaktojnë ndotje dhe rrezikojnë sigurinë. Përveç kësaj, qentë endacakë po bëhen një kërcënim i madh për shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe gjithashtu mund të transmetojnë dhe përhapin tërbimin, i cili është një sëmundje vdekjeprurëse.

Përpjekjet për të kontrolluar popullatën shpesh rrezikojnë mirëqenien e kafshëve përmes prirjes për t'i vrarë ato në masë, ose përdorimi i metodave çnjerëzore të vrasjes (helmim, pushkatim, mbytje, etj.), metoda mizore të kapjes dhe objekte të papërshtatshme për kujdesin dhe menaxhimin e tyre me Ligjin për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve⁸¹.

Në nivel evropian, me Traktatin e Lisbonës të vitit 2007, në veçanti nenin 13 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, statusi ligjor i kafshëve rregullohet në mënyrë që ato të mos konsiderohen objekte, as qenie të gjalla të zakonshme, por qenie të ndërgjegjshme. Në këtë drejtim, hapi i parë i rëndësishëm për përparimin evropian në lidhje me kafshët është Konventa Evropiane për mbrojtjen e kafshëve ledhatuese në 1987. Ka disa pika në preambulë që identifikojnë nevojën, ose më saktë, detyrimin për të vendosur disa detyra të njerëzve ndaj kafshëve: "Njeriu ka një detyrim moral të respektojë të gjitha qeniet e gjalla dhe të ketë parasysh se kafshët shtëpiake kanë një marrëdhënie të veçantë me njeriun; Të ketë parasysh rëndësinë e kafshëve shtëpiake në kontributin e tyre në cilësinë e jetës dhe vlerën e tyre në shoqëri; Të merren parasysh vështirësitë që dalin nga shumëllojshmëria e madhe e kafshëve të mbajtura nga njeriu; Të merren parasysh rreziqet që lindin në mbipopullimin e kafshëve për sa i përket higjienës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve dhe kafshëve të tjera". Më vonë, së bashku me Traktatin e Mastrohtit, u hartua Deklarata për Mbrojtjen e Kafshëve në të cilën ato njihen si qenie të ndërgjegjshme.

79 Në pyetëtorin e dërguar në Komunën e Prilepit kemi marrë përgjigje se NP Komunalec ka një numër të saktë të qenve endacakë që kanë çip. Megjithatë, NP Komunalec nuk ka dashur të na japë numër të saktë.

80 Të dhënat janë nga një sondazh online i kryer në korrik, të cilit iu përgjigjën 60 të anketuar.

81 Ligjit për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve, (Gazeta Zyrtare e RM nr. 149 datë 13.10.2014)

Zgjidhja e problemit të kafshëve endacake kërkon një qasje dhe bashkëpunim multisektorial midis institucioneve të sistemit, OJQ-ve dhe pushtetit vendor dhe kërkon marrjen e masave të përcaktuara ligjërish dhe zbatimin e aktiviteteve që do t'i japin fund dhe përfundimisht të zgjidhet ky problem shumëvjeçar. Për zgjidhjen e përhershme të këtij problemi, Komuna e Prilepit duhet t'i ndryshojë veprimet e deritanishme sepse janë dëshmuar si të papërshtatshme dhe të pamjaftueshme.

Cila është qasja lokale nga Komuna?

Neni 25 i Ligjit për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve, i cili i referohet qenve të pargjistruar, në paragrafin (1) thotë: “Për grumbullimin e qenve endacak, të pa regjistruar dhe akomodimin e tyre të përkohshëm në objektet përkatëse – strehimore janë kompetente komuna, komunat në qytetin e Shkupit, përkatësisht qyteti i Shkupit. Në këto objekte duhet të sigurohet mbrojtja elementare e kafshëve nga kushtet e pafavorshme atmosferike dhe të sigurohet mbyllja efikase e tyre”. Ky nen plotësohet me paragrafin (3) ku thuhet: “Strehimoret do të sigurojnë zbatimin e masave dhe personelit të duhur për mbrojtjen efektive të kafshëve, ushqyerjen dhe ushqyerjen e rregullt dhe nëse është e nevojshme trajtimin e kafshëve”.

Problemi me këtë ligj lind nga paragrafi (5) i cili shpjegon kontrollin e popullatës së vetë kafshëve, gjë që Ligji ynë e lejon eutanazinë e tyre. Vetë qasja e eutanazisë është një sfidë më vete, pasi eutanazia si mekanizëm për t'u marrë me popullatën e pastrehë është praktikuar me dekada dhe nuk ka dhënë asnjë rezultat. OJQ-të për mbrojtjen e kafshëve po kërkojnë ndryshime në Ligjin për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve, i cili do të ndalojë në mënyrë eksplicite eutanazinë e kafshëve. Domethënë, ligji i krijuar në këtë mënyrë është kontradiktor në vetvete, sepse nëse në paragrafët e mësipërm thuhet se ekzistojnë objekte të përshtatshme në të cilat do të ofrohen trajtime humane, atëherë si qenka eutanazia trajtim human nga paragrafi (5)? Kjo dilemë dhe sfidë është diçka që legjislacioni kombëtar duhet të harmonizojë në mënyrë që pushtetet vendore të mund ta ndjekin dhe respektojnë atë.

Komuna e Prilepit, nga ana tjetër, përveç kompetencave për përkujdesjen e qenve endacak që i referohen NP Komunalecit, ka ndër marrë edhe një sërë hapash të tjerë. Me vendim të Këshillit të Komunës së Prilepit, dhe me propozim të kryetarit të Komunës së Prilepit, është miratuar Program për zgjidhjen e problemit me pronarin dhe qentë endacak në territorin e Komunës së Prilepit 2019-2021. Megjithatë, një plan i tillë nuk është i disponueshëm publikisht. Gjithashtu, Komuna e Prilepit ka miratuar një projekt për përmirësimin e funksionimit komunal - Grant për qendrat për zhvillim të rajoneve planore (Rajoni planor i Pellagonisë) i cili ofron zgjidhje sistematike për qentë endacakë në rajonin e Pellagonisë, duke vendosur një qasje njerëzore për mirëqenien e qenve endacakë dhe promovimi i një mjedisi më të pastër dhe më të sigurt në zonat urbane dhe rurale të Pellagonisë. Vetë projekti parasheh përgatitjen e një studimi në nivel të Pellagonisë, si dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik për ndërtimin e qendrës rajonale për qentë endacakë.

Megjithatë, sipas anketës së realizuar, 2/3 e të anketuarve që janë banorë të Komunës së Prilepit⁸², nuk janë në dijeni se Komuna ka marrë ndonjë masë për parandalimin e problemit.

82 Të dhënat janë nga një sondazh online i kryer në korrik, të cilit iu përgjigjën 60 të anketuar

Është interesant fakti se për këtë problem janë të interesuar edhe qytetarët relativisht më të rinj të komunës, gjegjësisht 70% e të anketuarve në anketë ishin të rinj të moshës 19-29 vjeç. Kjo tregon se të rinjtë duan ta shohin komunën e tyre evropiane dhe të organizuar në mënyrë moderne. Sondazhi online doli gjithashtu në përfundimin se ky fenomen rrezikon sigurinë e qytetarëve sepse më shumë se gjysma e të anketuarve kanë thënë se janë në situatë ku janë sulmuar nga një kafshë endacake dhe se ky fenomen luan një rol të madh në ndotjen e mjedisit.

Qytetarët e Prilepit i kanë përcaktuar edhe arsyet pse paraqitet ky problem. U theksua se shkaqet e shfaqjes së kafshëve endacake mund të klasifikohen në disa grupe:

- **Pronësi e papërgjegjshme**- Kjo i referohet kryesisht rritjes së tepruar-të pakontrolluar të kafshëve shtëpiake, por edhe braktisjes së kafshëve shtëpiake;
- **Mungesa e edukimit për të drejtat e kafshëve;**
- **Menaxhimi joadekuat i strehimoreve (publike/private)**- Domethënë, në radhë të parë i referohet mungesës së personelit në strehimore dhe nga ana tjetër, punonjësit e paktë nuk u kushtojnë vëmendjen e duhur kafshëve dhe nuk i shohin ato si qenie të gjalla, gjë që prej vitesh është dëshmuar si problem në Komunë.
- **4. Mungesa e një kuadri ligjor të përshtatshëm që do të trajtojë dhe përfshijë të gjitha arsyet e mësipërme**

Si shembull pozitiv i një vendi që e trajton mirë këtë problem është Kroacia, e cila pavarësisht se ka një zgjidhje të detajuar ligjore⁸³ gjithashtu e trajton mirë problemin në praktikë. Në shtet janë 41 strehimore për kafshët e pastreha që menaxhojnë problemin. Vetë ligji parashikon ndërtimin e strehimoreve në territorin e secilës komunë (të paktën një strehë, në varësi të madhësisë së komunës), në të cilat strehimore do të kujdeseshin për të paktën 50 kafshë.

Puna në strehimore financohet nga buxheti në dispozicion të komunave. Çdo strehë duhet të ofrojë kujdesin adekuat veterinar për kafshët, copëzimin, për të siguruar sterilizimin e përhershëm. Gjithashtu, ndryshe nga ligji ynë, ligji kroat parashikon sterilizimin dhe çipëzimin e maceve, dhe jo vetëm të qenve, që është një tjetër ndryshim për sa i përket vendit ku jemi ne dhe ku ndodhet Kroacia. Në anën tjetër, përveç Ligjit për Mbrojtjen e Kafshëve i cili parasheh strehimoret "No-kill", ka edhe programe të tjera që adresojnë këtë problem, si: Programi për kontrollin e popullatës së qenve endacakë në Republikën e Kroacisë; Rregullore për kushtet që duhet të plotësojnë strehimoret e kafshëve;

ZGJIDHJE-ALTERNATIVE

Vetëqeverisja lokale dhe gatishmëria dhe vullneti i saj politik për zgjidhjen e problemit kanë rol kyç në zgjidhjen e problemit të lartpërmendur. Siç e pamë në tekst, ka një sërë sfidash në trajtimin e këtij problemi: nuk ka evidencë të saktë të qenve endacakë, ka mungesë informacioni të qytetarëve për punën e pushtetit vendor, mungesë e një institucioni të përshtatshëm për t'u kujdesur për qentë endacakë, si dhe pronarët e papërgjegjshëm që janë pjesë e problemit.

83 Ligji për Mbrojtjen e Kafshëve të Republikës së Kroacisë, i disponueshëm në linkun e mëposhtëm - <https://www.zakon.hr/z/257/Zakon-o-za%C5%A1titi-%C5%BEivotinja>

Zgjidhja më e përshtatshme për problemin është krijimi i një ndërmarrje publike të posaçme komunale për përkujdesjen e qenve endacak. Një zgjidhje e tillë është realisht e realizueshme dhe nuk ka pengesa ligjore për realizimin e saj. Zgjidhje të tilla janë pjesë e politikave të qyteteve të zhvilluara, janë të qëndrueshme dhe kontribuojnë në trajtimin më human të kafshëve, në këtë rast qenve endacakë. Për më tepër, krijimi i një ndërmarrjeje të tillë fokusohet në qasjen e qytetit ndaj zgjidhjes strukturore të problemeve, sesa në qasjen aktuale përmes një ndërmarrjeje tjetër publike.

Përfitimet e krijimit të një kompanie të tillë janë të mëdha:

- Mundësimi i monitorimit të rregullt të situatës dhe numrit të qenve endacakë në nivel lokal përmes një baze të dhënash publike dhe të vetme të kafshëve shtëpiake
- Mundësi për të imponuar identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve me një pronar
- Mundësi më e madhe për trajtimin, sterilizimin dhe kastrimin e qenve endacakë
- Rritja e mundësive për të adoptuar qen që tashmë janë nën kujdesin e ndërmarrjes
- Ofrimi i shërbimeve veterinarë për pronarët e qenve

Në mungesë të një kornize ligjore, Komuna duhet të marrë parasysh disa aspekte kur themelon një ndërmarrje të tillë publike. Kjo kryesisht i referohet hapësirës adekuate të pajisur me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, si dhe qasshmërinë e përshtatshme. Gjithashtu, vetë strehimoret duhet të sigurojnë pastrimin dhe dezinfektimin e duhur të pajisjeve dhe hapësirës. Përveç kësaj, vetë ndërmarrja publike duhet të prezantojë një politikë No-Kill, pra një politikë të mos vrasjes së kafshëve sipas shembullit të vendeve të zhvilluara evropiane.

Gjithashtu, futja e një qendre të tillë do të sigurojë një fokus më të madh në edukimin e qytetarëve, që është një nga sfidat kryesore. Edukimi është një nga zgjidhjet pozitive afatgjata për kontrollin e kafshëve endacake, ndaj është thelbësore të promovohen fushata edukative që synojnë promovimin e bashkëjetesës së qetë dhe konstruktive midis njerëzve dhe kafshëve. Për të arritur rezultatet e përmendura, është e nevojshme që në këto fushata, përveç pronarëve të kafshëve, të përfshihen të gjithë qytetarët (të rritur, të rinj dhe fëmijë) me përfshirjen e të gjithë aktorëve relevantë (p.sh. shkollat dhe mediat), si dhe njerëzit që punojnë me kafshët.

Një alternativë shtesë ndaj zgjidhjes së propozuar më sipër është thellimi i bashkëpunimit me qytetarët dhe organizatat lokale të shoqërisë civile. Kështu, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, ato mund të zbatojnë një program për zvogëlimin e numrit të kafshëve endacake, bashkëpunim që do të përfshinte edhe shoqata të ndryshme që merren me këtë çështje, stacione veterinarë, qytetarë (për shembull, sistemi i kuponëve apo klinikat e lëvizshme që do të shërbenin vendbanime të shumta, etj.). Shoqatat duhet të jenë ndërmjetësues legjitimë të njohur në procesin e promovimit të strehimit dhe të marrin një licencë për të operuar gardianët komunalë me mandat për t'iu përgjigjur parregullsive, për të raportuar dhe dënuar.

Për më tepër, është interesante qasja e përfshirjes së qytetarëve përmes parimit të "kujdesit të kafshëve të pastreha". Një qasje e tillë është futur në Beograd, Serbinë fqinje, ku tashmë ka kujdestarë të kafshëve endacakë⁸⁴.

84 Më shumë informacion në linkun e mëposhtëm - <https://www.rts.rs/page/stories/sr/story/125/drustvo/3219286/gradski-psi--lualice-kojih-niko-ne-treba-da-se-plasi.html>

Këta persona janë të regjistruar, me të dhëna personale dhe mbajnë përgjegjësi për qentë endacakë për të cilët kanë vendosur të kujdesen. Kujdestarët thonë se janë një lloj vullnetarësh dhe me këtë angazhim do të ndihmojnë qytetin në trajtimin e kësaj popullate kafshësh. Kjo praktikë zbatohet nga Ndërmarrja Publike Veterina - Beograd.

REKOMANDIME DHE AKTIVITETE

Krijimi i një kompanie publike për kujdesin e qenve endacakë është një zgjidhje realiste e zbatueshme në një afat të shkurtër dhe relativisht të lirë. Hapi i parë që duhet bërë është të bëhet një vlerësim dhe hulumtim për numrin e qenve ledhatues në qytet, por edhe numrin e qenve endacakë. Ky informacion do të jetë i nevojshëm për të planifikuar madhësinë e hapësirës së nevojshme për strehimin e qenve endacakë. Standardi⁸⁴ për këtë lloj hapësire kërkon 10m² për një qen.

Pastaj duhet bërë një program pune, sistematizimi i vendeve të punës, por edhe një kornizë financiare për fillimin e punës së ndërmarrjes publike. Nëse marrim shembullin e Shkupit me NP Laika, do të shohim se për themelimin e kompanisë janë dashur rreth 8000 euro⁸⁵, të cilat kryesisht ishin donacione nga ndërmarrjet tjera publike. NP Lajka ka të punësuar 8 persona. Nëse e kemi parasysh këtë, mund të konstatojmë se shpenzimet për themelimin e ndërmarrjes publike në Prilep do të ishin më të ulëta, duke pasur parasysh numrin e qenve dhe territorin në të cilin do të operojë kjo ndërmarrje publike. Gjithashtu, një plan i tillë duhet të përmbajë tregues të qartë për suksesin e funksionimit të ndërmarrjes.

Si hap tjetër, duhet të zhvillohen procedura standarde të funksionimit. Procedura të tilla do të formojnë bazën e operimit dhe funksionimit të kompanisë dhe do të mundësojnë profesionalizëm në qasjen. Krahas procedurave duhen edhe trajnime përkatëse që stafi të punojë me kafshët, por edhe të veprojnë në lidhje me procedurat. Ky është një aspekt kyç në funksionimin e një ndërmarrje të tillë.

Rekomandimet e lartpërmendura për aktivitete përbëjnë bazën për zgjidhjen afatgjatë të problemit me qentë endacak në Komunën e Prilepit. Por sigurisht që ngritja e një ndërmarrjeje të tillë nuk duhet të mbështetet vetëm në aktivitetet e mësipërme. Si diçka që u përmend në alternativat, është thelbësore që një kompani e tillë të jetë e dukshme dhe qytetarët të jenë të informuar për punën e saj. Për më tepër, është e nevojshme që kompania të realizojë fushata dhe aktivitete edukative vjetore për ndërgjegjësimin e popullatës. Së treti, vendimtar është edhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet joformale në nivel lokal, të cilat kanë informacion dhe përvojë në trajtimin e problemit dhe dinë të kontribuojnë në zgjidhjen e tij.

85 Informacioni është marrë nga ueb faqja e NP Lajka - <https://lajka.com.mk/>

BIBLIOGRAFIA

Ligje

- Ligjit për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 149 datë 13.10.2014)
- Ligji për mbrojtjen e kafshëve i Republikës së Kroacisë

Analiza dhe publikime

- U zhvillua diskutim me dy fokus grupe të moshave të ndryshme, të rinjtë deri në 29 vjeç dhe Fokus grup prej qytetarësh të rritur
- Analizë tryeze e zgjidhjeve aktuale ligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Analiza krahasuese, Kroacia si shembull pozitiv
- Pyetësor online me 60 të anketuar

Intervistë me një përfaqësues të Komunës së Prilepit

Ueb-faqet

- Faqja e internetit e NP Laika - <https://lajka.com.mk/>
- Faqja e internetit e Radio Televizionit të Serbisë - <https://www.rts.rs/page/stories/s-r/story/125/drustvo/3219286/gradski-psi--lualice-kojih-niko-ne-treba-da-se-plasi.html>

FUNKSIONIMI I KËSHILLIT RINOR LOKAL NË GOSTIVAR

Masat dhe politikat e propozuara

- Fjolla Jakupi





REZYME

Ne ditët e sodit politika zë një vend të rëndësishëm në shoqëri, teksa shoqërinë e udhëheq rinia. Prandaj, është e pamundur të rinjtë t'i shmangen përfshirjes në politikë. Ky dokument për politika publike përpiqet të identifikojë nevojat, kërkesat dhe pritjet që kanë të rinjtë në njësitë e vetëqeverisjes lokale, përkatësisht në Komunën e Gostivarit. Po ashtu, përmes këtij dokumenti, i cili bazohet në analizën përkatëse për nevojat e të rinjve, në Komunën e Gostivarit të riaktivizohet këshilli rinor, i cili ka disa vite që nuk funksionon.

Problemi i kahershëm me mosfunksionimin e këshillit rinor në Komunën e Gostivarit është shumë aktual dhe alarmant, sepse ky problem buron nga viti 2016. Pas zgjedhjeve lokale, këshilli rinor mbeti në hije, ndërsa të rinjtë mbetën pa një vend të përshtatshëm ku ata të mundeshin të shprehnin lirshëm nevojat e tyre dhe të mund të përparonin në fillimet e karrierës së tyre.

Ligji për Pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, është mundësi për të rinjtë por edhe detyrim i komunave ku përmes masave konkrete do të përmirësojë pjesëmarrjen e të rinjve, përkatësisht të vendosen mekanizma përkatës në nivel lokal të cilat do të sigurojnë përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e krijimit të politikave publike dhe marrjen e vendimeve me interes të rinisë.

Themelimi i një Këshilli Rinor Lokal do të mundësojë ndarjen e përgjegjësiave mes komunës dhe aktivistëve të rinj në një mënyrë që ndërton një partneritet mes tyre në mënyrë që të përmirësojnë kushtet e jetesës së të rinjve në komunën e Gostivarit. Në atë kontekst përfaqësuesit e këshillit lokal rinor kanë të drejtë të:

- Propozojnë pika në rendin e ditës të Këshillit Komunal që prek të rinjtë;
- Iniciojnë çështje për të rinjtë nga fusha e punës së komunës;
- Iniciojnë, marrin pjesë dhe japin reagime mbi procesin e strategjisë lokale rinore dhe politikat e tjera;
- Dorëzojnë informacione pranë Komunës së Gostivarit për çështjet që kanë të bëjnë me rininë; dhe
- Kryejnë aktivitete të tjera këshilluese dhe avokuese në përputhje me Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore;

PROBLEMI - KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Gostivari është qytet në pjesën perëndimore të Maqedonisë së Veriut, më saktë në pjesën jugore të Luginës së Pollogut. Gostivari është qendra e komunës me të njëjtin emër që mbulon një sipërfaqe prej rreth 650 km². Qyteti është një mjedis administrativ, politik, biznesi dhe kulturor për rreth tetëdhjetë mijë banorë, nga të cilët pothuajse 36.000 banorë jetojnë në qendër të qytetit⁸⁶.

86 <https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%93%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%B0%D1%80>

Qyteti është një mjedis tipik multikulturor, i banuar nga pothuajse të gjitha kombësitë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Maqedonas, Shqiptarë, Turq, Romë dhe të tjerë).

Në periudhën e kaluar, komuna e Gostivarit ka ndërmarrë disa aktivitete që synojnë mbështetjen e të rinjve në qytet.

Në vitin 2018, u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi me organizatën Democracy Lab me qëllim të hapjes së një Qendre për aktivitetet rinore në Gostivar⁸⁷. Projekti zbatohet nga Democracy Lab, dhe financohet nga Komuna e Gostivarit dhe Ambasada Amerikane në Shkup. Qendra synon të thellojë bashkëpunimin dhe besimin midis komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Gostivar, të heqë paragjykimet dhe të promovojë multietnicitetin. Në kuadër të Qendrës, do të iniciohen programe, trajnime dhe kurse të ndryshme për krijimin e një brezi të ri të qytetarëve aktivë të cilët do të jenë në gjendje të njohin të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si qytetarë.

Në fillim të vitit 2020 Komuna e Gostivarit ka ndarë dhjetë bursa për po aq talentë të rinj në fushën e sportit. Këtë mbështetje nga Komuna e Gostivarit e mirëpresin prindërit dhe vetë sportistët e rinj. Ndryshe, kjo është hera e parë që talentet e rinj sportivë përkrahen financiarisht nga Komuna e Gostivarit.

Në gusht 2020, filloi zbatimi i Projekti CoWork, i cili financohet nga Komuna e Gostivarit, si dhe nga organizata World Chicago nga SHBA dhe kompania vendore Lucky Media.

CoWork - Gostivar i organizatës YEP është një Qendër e Punës së Përbashkët (Coworking Space) e krijuar posaçërisht për mbështetjen e sipërmarrësve të rinj, si dhe për ata që punojnë në distancë, për kompani të ndryshme (Remote Work). CoWork është një hapësirë moderne dhe inovative që do të motivojë sipërmarrësit e rinj të bëjnë një hap përpara në karrierën e tyre profesionale. Anëtarët e hapësirës mund të jenë persona nga profesione të ndryshme, siç janë juristët, kontabilistët, menaxherët e marketingut, arkitektët, fotografët, redaktorët e videove, konsulentët dhe profesione të cilat janë të lidhura ngushtë me tendencat digjitale.

Komuna e Gostivarit mbështet projekte që kanë për qëllim përmirësimin e statusit të të rinjve dhe parandalimin e emigrimit të tyre.

Në vitin 2021 u hap një Qendër Burimore Rinore që do t'i shërbejë të gjithë Rajonin e Pollogut. Qendra është pjesë e projektit "Krijimi i mundësive për punë për të gjithë" i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) dhe Agjencinë e Punësimit, me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Komuna e Gostivarit kishte krijuar një këshill lokal rinor për të mbështetur përfaqësimin më të madh të të rinjve në procesin e vendimmarrjes. Megjithatë, deri në miratimin e Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, ky këshill nuk funksionoi dhe nuk dha rezultatet e pritshme. Një mundësi e re për të rinjtë në përgjithësi është zbatimi i Ligjit për Pjesëmarrjen e Rinisë dhe Politikën Rinore⁸⁸.

87 <http://gostivari.gov.mk/mk/category/%d0%b2%d0%b5%d1%81%d1%82%d0%b8/>

88 Ligji për Pjesëmarrje rinore dhe politika rinore 2020, <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2020/03/Zakon-za-mladinsko-uchestvo-i-mladinski-politiki-16-01-2020.pdf>

Ligji parashikon disa masa për të përmirësuar pjesëmarrjen e të rinjve përmes mekanizmave në nivel lokal që do të sigurojnë përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e krijimit të politikave publike dhe vendimmarrjes në interes të të rinjve. Kështu, duhet të krijohen këshillat rinorë lokalë në nivel lokal, të emërohet një person, nëpunës për punë me të rinjtë dhe të formohen qendrat rinore.

Qëllimi i këtij dokumenti të politikave publike bazohet në informacionin e marrë nga të rinjtë e Gostivarit në lidhje me pikëpamjen e tyre për këshillin rinor lokal, për të dhënë sugjerime dhe zgjidhje se si të formohet dhe ringjallet këshilli lokal rinor në Gostivar, si dhe rekomandimet për zbatim të dispozitave të tjera në nivel lokal nga ligji për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikave rinore.

Për këtë qëllim janë bërë intervista me të rinj nga qyteti i Gostivarit lidhur me atë që ju mungon në qytet dhe mendimin e tyre për (mos) funksionimin e këshillit rinor. Gjithashtu, në Gostivar u organizua një seminar 3-ditor në të cilin morën pjesë 21 të rinj të etnive të ndryshme.

Në pyetjen "Çfarë mendoni për të rinjtë në Gostivar?" rreth 80% e të rinjve mendojnë se nuk marrin asnjë mbështetje për realizimin e ideve të tyre. Pothuajse të gjithë të anketuarit pajtohen se nuk ka këshill funksional rinor në Gostivar. Të anketuarit kanë më shumë ide se cili duhet të jetë fokusi i punës së këshillit rinor, por një përqindje e lartë prej 45% e të anketuarve mendojnë se këshilli duhet të punojë në bashkimin e të rinjve nga Gostivari.

REKOMANDIME DHE AKTIVITETE

Është e qartë nga aktivitetet e zbatuara se të rinjtë duan të përfshihen në krijimin e politikave lokale dhe të marrin pjesë aktive në jetën publike. Ata duan të pyeten dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve në komunën e Gostivarit.

Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të mbështetet pjesëmarrja e të rinjve në zhvillimin e politikave rinore efektive dhe vendimmarrjen së bashku me institucionet sepse kështu sigurohet një jetë e mirë për të rinjtë dhe forcohet kapaciteti demokratik i komunitetit.

Rekomandime për autoritetet lokale:

- 1** Të fillojë procesi i zbatimit të ligjit për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikave rinore. Ligji për pjesëmarrjen e rinisë dhe politikave rinore rregullon dhe garanton organizimin dhe pjesëmarrjen rinore lokale për herë të parë.
- 2** Të formohet Këshilli rinor lokal (KRL) - Këshilli rinor lokal synon të rrisë pjesëmarrjen e të rinjve në Komunë dhe në komunitetin lokal. Për funksionimin e suksesshëm të Këshillit Rinor Lokal, është e rëndësishme të merren parasysh nevojat, kërkesat dhe interesat specifike të të rinjve nga mjedisi lokal. Prandaj, komuna duhet ta përshtatë këtë proces me nevojat reale të të rinjve dhe karakteristikat e qenësishme në mjedisin lokal, dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e të rinjve pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, orientimi politik.

Këshilli rinor lokal si trup i komunës përbëhet nga anëtarë, përfaqësues të formave të ndryshme të organizimit të të rinjve. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të KLR është tek, nuk mund të jetë më pak se pesë persona dhe nuk kalon më shumë se një të tretën e anëtarëve të Këshillit të Komunës së Gostivarit.

Komuna e Gostivarit duhet të zbatojë hapat e mëposhtëm për krijimin e një Këshilli Lokal Rinor:

- Vendimi statutor i Këshillit të Komunës së Gostivarit për ndryshimin dhe / ose ndryshimin e Statutit të Komunës - Themelimi i një trupi të veçantë në Komunë: Këshilli Lokal Rinor. Ky vendim mund të merret në bazë të nenit 16 të Ligjit për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikave rinore, si dhe në bazë të nenit 36 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe statuteve të komunave, ku thuhet se këshillat komunale mund të marrin vendim të krijojë trupa të veçanta si trupat këshilluese për komunat.
- Komuna po shpall një Thirrje për krijimin e një Bordi Iniciues (BI). Kjo thirrje mund të shpallet në përputhje me nenin 17 të Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore. BI mund të anëtarësojnë organizata rinore, organizata për të rinj, politikë, forumet rinore të partive politike, studentore dhe forma të tjera të shoqatave rinore që veprojnë dhe funksionojnë në territorin e Komunës dhe duan të marrin pjesë në themelimin e Këshillit
- Thirrje për anëtarësim në Kuvendi lokal rinor - Bordi Iniciues përmes Komunës shpall Thirrje Publike për anëtarësim në Kuvendin Lokal Rinor. Thirrja Publike duhet të tregojë qartë mënyrën e aplikimit, kriteret që duhet të plotësohen për aplikim, si dhe afatin e aplikimit.
- Mbajtja e një sesioni konstituiv të Kuvendit Rinor Lokal. Delegatët e zgjedhur të Kuvendit Lokal Rinor ftohen nga Bordi Iniciues për të marrë pjesë në seancën konstituive, e cila kryesohet nga BI së bashku me personin përgjegjës të Komunës. Nga radhët e Kuvendit Lokal Rinor, zgjidhet dhe votohet dhe zgjidhet një komision tre anëtarësh, i përbërë nga të rinj, i cili është përgjegjës për monitorimin e të gjithë procesit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Lokal Rinor.
- Thirrje për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Lokal Rinor. Seanca e parë e Kuvendit Lokal Rinor (menjëherë pas seancës konstituive) thirret nga Kryetari tashmë i zgjedhur i Kuvendit. Në sesion miratohen rregullat e procedurës të përgatitura dhe propozuara nga komisioni dhe merret vendimi për shpalljen e thirrjes për krijimin e Këshillit Lokal Rinor të Komunës, me kritere në përputhje me Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikën rinore.
- Anëtarët e zgjedhur të Këshillit Lokal Rinor verifikohen nga Këshilli Komunal pasi marrin një vendim për zgjedhjen e anëtarëve nga Kuvendi Rinor i Komunës. Pas zgjedhjeve të konfirmuara, komisioni verifikues i Kuvendit Lokal Rinor përgatit raport/procesverbal me një listë të anëtarëve të zgjedhur i cili miratohet nga Kuvendi Lokal Rinor dhe i paraqitet Këshillit Komunal për verifikimin e mandateve të tyre.
- Pas verifikimit, në mbledhjen e parë të Këshillit Lokal Rinor, zgjidhen kryetari dhe nënkryetari i Këshillit dhe së bashku me anëtarët miratohet Rregullorja e Punës. Në takimin e parë të punës të hapur dhe kryesuar nga anëtari më i vjetër i zgjedhur, anëtarët e Këshillit Lokal Rinor nga zgjedhin nga radhët e tyre një kryetar dhe një nënkryetar dhe sjellin rregullat e procedurës⁸⁹.

89 Doracak për këshillat rinorë lokale - https://www.osce.org/files/f/documents/a/c/491135.pdf?fbclid=IwAR23D5_ds7wLn5p4o2p9UWltXtXj20q3YgHH4zrA3DÖcZ16aG5jsQ_PhQjM

- 3** Të emërohet një nëpunës për të rinjtë në komunën e Gostivarit. Komuna e Gostivarit do të krijojë një zyrë rinore nga ku do të koordinohet puna për të rinjtë në komunë dhe do të jetë pika kryesore për qasjen e të rinjve në nivel lokal. Për këtë qëllim, komuna është e detyruar të caktojë nëpunës për të rinj, person përgjegjës për punën e Zyrës Rinore për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e çështjeve me interes për të rinjtë në fushëveprimin e kompetencës së institucionit. Gjithashtu, informacioni i kontaktit për nëpunësin për të rinj duhet të jetë publikisht i disponueshëm në ueb faqen e Komunës së Gostivarit.
- 4** Të organizohen trajnime për të rinjtë në mënyrë që ata të mund të përfshihen më aktivisht në proceset e krijimit të politikave publike dhe vendimmarrjes.
- 5** Të vazhdohet me mbështetjen e programeve aktuale rinore që të sigurohet vazhdimësi dhe qëndrueshmëri e nismave të ndërmarra. Kjo do të thotë, të mbështetet puna e Qendrës Burimore Rinore, qendrës së përbashkët për punë për mbështetjen e sipërmarrësve të rinj, dhe për ata që punojnë në distancë, bursa për talentet e rinj në fushën e sportit.
- 6** Të përgatitet strategji rinore për komunën e Gostivarit. Strategjia lokale për të rinjtë është dokument strategjik i komunës që duhet të jetë në përputhje me Strategjinë kombëtare rinore. Strategjia përcakton qëllimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe promovimin e intereseve të të rinjve në nivel lokal dhe përcakton masat organizative, financiare dhe administrative për arritjen e tyre. Strategjia lokale gjithashtu përmban Plan Vepërimi për zbatim me aktivitete të përcaktuara, dinamikë, bartës të aktiviteteve dhe projeksione të mjeteve buxhetore, si dhe kushte dhe indikatorë vlerësimi për zbatimin e Strategjisë Lokale Rinore. Strategjia lokale e të rinjve zhvillohet nga komuna në bashkëpunim me këshillin lokal të të rinjve dhe miratohet nga Këshilli i komunës për një periudhë pesëvjeçare. Strategjia lokale rinore zbatohet me mjete buxhetore nga komuna.


BIBLIOGRAFIA

- Ligji për Pjesëmarrje rinore dhe politika rinore 2020, <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2020/03/Za-kon-za-mladinsko-uchestvo-i-mladinski-politiki-16-01-2020.pdf>
- Faqja zyrtare e Komunës së Gostivarit www.gostivari.gov.mk
- Doracak për këshillat rinorë lokalë https://www.osce.org/files/f/documents/a/c/491135.pdf?fbclid=IwAR23D5_ds7wLn5p4o2p9UWltXtXj20q3YgHH4zrA3DOcZ16aG5JsQ_PhQjM

ZGJIDHJE PËR TË RINJTË NË STRUMICË

Masat dhe politikat e propozuara

- *Hristijan Velkov*





РЕШЕНИЈА ЗА МЛАДИ ВО СТРУМИЦА -АНАЛИТИЧКА СТУДИЈА-



В
Гра
тром
полож
зафа
на насе
осен гра
во Струмица
граѓани Турци
19 годишна возр



Во врска со условите за младите, од најм
развиен град. Постојат установи од најм
(јасли, градинка и воспитувања)
се остварува агр
заштита и

REZYME

Ka tendenca të forta në emigrimin e të rinjve nga vend, të cilët, janë popullsia më e përfaqësuar në mesin e personave që shpërngulen. Në mënyrë plotësuese, të rinjtë, si pjesa më e lëvizshme e popullsisë, kanë një shkallë papunësie jashtëzakonisht të lartë, pak më pak se 50% e të rinjve të aftë për punë janë të papunë dhe shkalla e punësimit për këtë kategori është 2,5 herë më e ulët se mesatarja kombëtare⁹⁰. Gjithashtu, sipas disa autorëve, "kërkimet e fundit tregojnë se të rinjtë nuk ndihen të përfshirë në zhvillimet socio-ekonomike, gjë që e forcon edhe më shumë dëshirën e tyre për tu shpërngulur nga vendi"⁹¹. Ky realitet reflektohet në masë të madhe në nivelin lokal, duke përfshirë edhe komunën e Strumicës.

Duke marrë parasysh situatën e të rinjve që largohen nga vendi, është jashtëzakonisht e rëndësishme që vendimmarrësit të ofrojnë zgjidhje adekuate që u kushtohen të rinjve dhe nevojave të tyre.

Premtimet dhe masat e propozuara deri më tani kanë ardhur kryesisht nga partitë politike pa konsultime më të gjera. Në të njëjtën kohë, këto ide u zbatuan në një masë shumë të vogël. Në këtë kuptim, duke u bazuar në të dhënat sasiore dhe cilësore dhe në bazë të perceptimit të saktë të situatës aktuale në të cilën jetojnë dhe punojnë të rinjtë në Strumicë, është e nevojshme të zbulohen problemet kryesore, pritjet dhe zhgënjimet e kësaj kategorie të bashkëqytetarëve tanë. Bazuar në këto gjetje, dokumenti i politikave publike ofron disa zgjidhje dhe aktivitete kyçe të propozuara për pushtetin vendor, por edhe aktorë të tjerë në mjedisin lokal dhe në vend, të cilat duhet të merren parasysh gjatë formulimit të politikave publike.

PROBLEMI - KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Strumica, përkundër faktit se konsiderohet si një nga komunat më të zhvilluara në vend, ka mungesë të theksuar të mundësive dhe infrastrukturës për të rinjtë. Në programet e partive politike, nga ana tjetër, të rinjve iu premtuan projekte të shumta. .

Premtimet nga fushata zgjedhore e VMRO-DPMNE-së, për Strumicën



Општина Струмица #СегоашРабота #НоваЕра

90 Ministria e Financave, "Programi i Reformës Ekonomike 2018-2020", Janar 2018, finance.gov.mk.

91 Punësimi i të rinjve në Republikën e Maqedonisë, Studim themelor dhe rekomandime, epi.org.mk.

ЖИВОТ ВО СТРУМИЦА ЗА СИТЕ

ПОВЕЌЕ ПАРИ ЗА ГРАЃАНИТЕ
МОЖНОСТИ ЗА СИТЕ

- Ја активираме спиралата на поканување на платите. Носиме директна поддршка за домашните фирми, прво со за младите и севашта приоритетна.
- Обезбедуваме повеќе пари за општините, а со тоа и повеќе можности и повеќе пари за секој граѓанин на локално ниво.
- Обезбедуваме еднакви услови и за странските инвеститори.
- Вложуваме во младите, отвораме центри за отпочнување и развој на бизнис.
- Ги здружуваме бизнисите, општината и граѓаните, со единствена цел – нови и подобро платени работни места.
- Ја вклучуваме бизнис заедницата во дефинирање на приоритетите на општината и воведуваме бизнис форуми како редовна активност за проaktivizacija и следење на локалниот економски развој.
- Посветената и одговорна работа ги носи парите директно кај граѓаните.



Premtimet parazgjedhore në Programin e kandidatit për kryetar komune nga LSDM

Pushteti aktual lokal premtoi disa projekte kyçe në vitin 2017, përkatësisht konvikt të ri për shkollën e mesme, qendër kulturore rinore, sallë kinemaje, bursa për 50 nxënësit më të mirë, rinovim i fushave ekzistuese të futbollit në vendbanimet ku luhet aktivisht futboll, ndërtimi i dy kënde lojërash të vogla me bar artificial, si dhe ndërtimi i këndeve të reja multi-funksionale të lojërave. Katër vite më vonë, nga të gjitha projektet e përmendura, shumica e tyre nuk janë realizuar.

Njëkohësisht, kjo pjesë shoqërohet me zbatimin e dobët të aktiviteteve dhe politikave për të rinjtë që dalin nga Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, që do të thonë përfitime për të rinjtë. Gjegjësisht, edhe pse komuna e Strumicës ka formuar Këshillin Rinor dhe ka emëruar nëpunës rinor, puna e këtyre organeve është krejtësisht e pa përfillshme. Në këtë drejtim, Komuna nuk ka miratuar strategji lokale për të rinjtë, dhe as nuk ka themeluar zyrë rinore dhe qendrën rinore.

Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, është e rëndësishme të theksohen rezultatet e sondazhit të opinionit publik të realizuar gjatë qershorit 2021 mbi 700 të anketuar, nga mosha 18 deri në 29 vjeç, që jetojnë në komunën e Strumicës. Nga rezultatet e signuaruara mund të nxirren tre përfundimet e mëposhtme të rëndësishme:

- **66%** e të anketuarve mendojnë se kryetari i komunës nuk e kryen punën e tij me sukses;
- **55%** e të anketuarve mendojnë se Këshilli i komunës nuk e kryen punën e tij;
- Të rinjtë janë të pakënaqur me përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrjes dhe politikë bërjes.

ÇËSHTJET KRYESORE RINORE NË NIVEL LOKAL

Përkundër pakënaqësisë së manifestuar qartë me qëndrimin e vetëqeverisjes lokale ndaj nevojave të tyre, të rinjtë nga Strumica, të cilët si të anketuar ishin pjesë e sondazhit të opinionit publik, qartë i paraqesin aspiratat, dëshirat dhe nevojat e tyre. Rezultatet sugjerojnë në gjashtë përfundimet e mëposhtme, më të rëndësishme:

- Problemi më i theksuar në Strumicë është urbanizimi jo cilësor i qytetit, gjegjësisht mungesa e rrugëve dhe parkingjeve cilësore. Në këtë grup përfshihet edhe ajri i ndotur, pastrimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore, mungesa e qendrës kulturore rinore dhe infrastruktura e dobët sportive;
- Çështje të tjera të rëndësishme janë pastërtia publike, cilësia e ajrit, si dhe infrastruktura sportive dhe kulturore;

- Të anketuarit shprehin pakënaqësinë më të madhe për mos ndërtimin e shtigjeve për biçikleta në Strumicë, për transportin publik, si dhe për standardin e nxënësve dhe studentëve;
- Sipas të anketuarve - të rinj, projektet më të mira janë renovimi i shkollave dhe kopshteve, si dhe parqet e reja që janë projektuar në komunë;
- Problemi më i madh, është korrupsioni në funksionimin e komunës, deponitë ilegale dhe arsimi;
- Në shkallën nga 1 deri në 5, nota mesatare për punën e administratës lokale komunale është 2.5.

Zbatimi i Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore

Ligji për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore (i quajtur në gjuhën e folur Ligji për rininë) është një projekt mbipartiak i votuar në Kuvend nga të gjitha partitë parlamentare në janar të vitit 2020.

Si pionier në zgjidhjen e disa çështjeve rinore, ky ligj parasheh disa aspekte dhe detyra kyçe për komunat në vend.

Një nga qëllimet kryesore të ligjit është forcimi i pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e krijimit të politikave për të rinjtë, informimi aktiv, promovimi dhe mbrojtja e interesave të të rinjve, si dhe forcimi i ndërgjegjësimit për rëndësinë e të rinjve dhe rolin e tyre shoqëror. Për sa i përket përfaqësimit, Ligji synon gjithashtu të inkurajojë dialogun strukturor në nivel kombëtar dhe lokal⁹².

Neni 16 i Ligjit përcakton se “komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qyteti Shkup me statut parashikojnë themelimin e këshillave rinore lokale”. Në këtë kuptim, këshillat rinore lokale kanë një rol këshillues dhe përfaqësues në komuna në kuadër të çështjeve dhe politikave rinore, me autoritet për të propozuar pika në rendin e ditës të këshillit bashkiak, si dhe për të iniciuar çështjet rinore brenda fushëveprimit të punës komunale.

Në Strumicë Këshilli Rinor funksionon për një kohë të gjatë, por si organizatë kuazi joqeveritare. Gjegjësisht, pas miratimit të Ligjit, Strumica është një nga komunat e para në vend që themeloi një organ përfaqësues për të rinjtë sipas dispozitave të Ligjit. Megjithatë nuk ka informacion më të detajuar për funksionimin e tij, ka filluar hapi i parë drejt vendosjes së pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.

Neni 20 i Ligjit për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore parasheh miratimin e një strategjie lokale për rininë. Në këtë kuptim, edhe pse komuna ka miratuar Strategjinë për Rininë 2015-2020, megjithatë, pas miratimit të Ligjit të ri, ende nuk ka informacione se administrata lokale e Strumicës ka filluar procesin e miratimit të Strategjisë së re për rininë.

Në nenin 21 i ligjit, parashikon themelimin e zyrës për rininë nga ku duhet të koordinohet puna për të rinjtë nëpër komuna. Në këtë kuptim, edhe pse afati për hapjen e një zyre të tillë ka skaduar në janar të vitit 2021, në Strumicë nuk ka informacione s'është hapure ky lloj pikë kontakti.

92 Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, Gazeta zyrtare e RMV, nr. 10 nga 16.1.2020;

REKOMANDIME DHE AKTIVITETE

Zgjidhjet për problemet me të cilat përballen të rinjtë duhet të gjenden përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me të rinjtë. Të rinjtë duhet të pyeten për situatat me të cilat përballen, për problemet në shoqërinë e përditshme dhe më pas t'i lidhin me zgjidhjet e mundshme, si dhe me vendimmarrësit e drejtpërdrejtë në nivel lokal. Analiza të tilla duhet të plotësohen nga një qasje proaktive nga vendimmarrësit, të cilët, së bashku me të rinjtë, do t'i përcaktojnë propozimet kryesore të politikave rinore brenda fushave të përcaktuara prioritare për të rinjtë.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, në vijim propozohen masat që synojnë përmirësimin e pozitës së përgjithshme të të rinjve. Në këtë kuptim, duke qenë se autori i këtij studimi i përket një partie politike, masat e propozuara ndahen brenda ciklit zgjedhor politik në dy faza:

Faza parazgjedhore: periudha deri në ditën e zgjedhjeve (18 muaj deri në ditën e zgjedhjeve);

FAZA PARAZGJEDHORE		
AKTIVITETI	MBARTËS I AKTIVITETIT	QËLLIMI
Hulumtim anketues për nevojat e të rinjve	Përfaqësuesit politikë, administrata komunale	Zbulimi burimor i problemeve të të rinjve
Punëtori për krijimin e një Programi Lokal	Partitë politike, organizatat e shoqërisë civile	Përfshirja e të rinjve në procesin e krijimit të ofertës politike
Përcaktimi i fushave prioritare për veprim në lidhje me të rinjtë	Përfaqësuesit politikë, administrata komunale	Qasje e planifikuar dhe sistematike ndaj të rinjve
Të përcaktohen projekte konkrete për çështjet me interes më të madh për të rinjtë e Strumicës: arsimi, infrastruktura, mundësitë për sport dhe rekreacion.	Përfaqësuesit politikë, administrata komunale	Zbatimi i masave me rëndësi reale për të rinjtë
Vendosja e të rinjve në listat zgjedhore (të paktën 1 vend në Këshillin e komunës)	Partitë politike dhe parashtruesit e listave	Përfshirja në trupat përfaqësues në nivel lokal
Komunikimi i programit zgjedhor me zgjidhje për të rinjtë drejtpërdrejt me të rinjtë	Të rinjtë në listat zgjedhore, vendimmarrësit kryesorë	Takimi, informimi i të rinjve për masat e parashikuara për ta
Thirrje direkte për të rinjtë që të jenë pjesë e fushatave dhe lëvizjeve politike	Përfaqësues politikë, organizata të shoqërisë civile	Përfshirja e të rinjve në proceset politike

*Faza post-zgjedhore.*⁹³

FAZA POSTZGJEDHORE		
AKTIVITETI	MBARTËS I AKTIVITETIT	QËLLIMI
Plotësimi i të gjitha kërkesave ligjore që dalin nga Ligji për Rininë (Zyra për Rininë, Strategjia Rinore, Qendra Rinore)	Përfaqësuesit politikë, administrata komunale nga burimet e veta dhe ndihma nga organizatat partnere	Zgjidhje reale e çështjeve të parapara të Ligjeve që i referohen rinisë
Fillimi i një procesi të gjerë konsultimi për miratimin e një Strategjie të re Lokale Rinore dhe Planit të Veprimit për zbatim	Administrata komunale në bashkëpunim me organet përfaqësuese rinore dhe organizatat e shoqërisë civile	Qasje sistematike në përcaktimin e aspekteve themelore të punës së komunës ndaj rinisë
Përcaktimi i aktiviteteve urgjente, afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për synimin e fushave prioritare	Administrata komunale në bashkëpunim me organet përfaqësuese rinore dhe organizatat e shoqërisë civile	Trajtimi sistematik i fushave prioritare që prekin të rinjtë
Rritja e aktivitetit të Këshillit Rinor Vendor	Këshilli Rinor Lokal i Strumicës, Këshilli i komunës së Strumicës	Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në elaborim, debate dhe vendimmarrje
Hapja e një Zyre për të rinjtë	Administrata komunale	Krijimi i një pike kontakti për komunikim në nivel rini-komunë
Përcaktimi i një pjese të buxhetit komunal për aktivitete rinore	Administrata komunale nga buxheti i saj (rekomandim për ndarjen e 0.1% të buxhetit të saj)	Ndarja financiare e fondeve të nevojshme për zbatimin e plotë të masave
Platformë për monitorimin e zbatimit të masave, politikave dhe projekteve për të rinjtë	Administrata komunale në bashkëpunim me organet përfaqësuese rinore dhe organizatat e shoqërisë civile	Zbatim real, llogaridhënie dhe transparencë në funksionimin e komunës
Matja e rregullt e kënaqësisë së qytetarëve (të rinjve)	Përfaqësuesit politikë, administrata komunale me mjete nga buxheti i saj	Përgjegjësi, proaktivitet dhe reagime nga puna

93 Best practices in electoral security, a guide for democracy, human rights and governance programming, usaid.gov;

BIBLIOGRAFIA

- A Guide to Political Party Development, National Democratic Institute for International Affairs (NDI), 2008;
- Best practices in electoral security, a guide for democracy, human rights and governance programming, e qasshme në usaid.gov;
- Enhancing youth political participation throughout the electoral cycle, - a good practice guide, e qasshme në undp.org;
- How youth can be involved in municipal elections, e qasshme në ceyc.ca;
- Youth participation in electoral processes, handbook for electoral management bodies, e qasshme në aceproject.org;
- Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, Gazeta zyrtare e RMV, nr. 10 nga 16.1.2020;
- Programi i reformave ekonomike 2018-2020, Ministria e Financave, janar 2018, e qasshme në finance.gov.mk;
- Punësimi i të rinjve në Republikën e Maqedonisë - studim bazë dhe rekomandime, e qasshme në hepi.org.mk;
- Strategjia Kombëtare për Rininë e Republikës së Maqedonisë 2016 - 2025;
- Nga të rinjtë për të rinjtë: perspektiva mbi sfidat shoqërore. - Shkup, Instituti për Politika Evropiane, e qasshme në epi.org.mk;
- Faqja zyrtare e komunës së Strumicës, strumica.gov.mk;
- Programi i LSDM-së për komunën e Strumicës, zgjedhjet lokale 2017;
- Strategjia për Rininë e Komunës së Strumicës 2015-2020.

PJESËMARRJE AKTIVE

Për rritjen e pavarësisë ekonomike
të grave në zonat rurale të Ko-
munës së Koçanit

- *Ivana Maksimova*





REZYME

Ky dokument paraqet analizën e bërë të nevojave dhe prioriteteve të grave dhe vajzave nga zonat rurale në territorin e Komunës së Koçanit.

Përvojat dhe hulumtimet e deritanishme tregojnë se shumica e vajzave dhe grave që jetojnë në zonat rurale në Republikën e Maqedonisë së Veriut përballen me një sërë problemesh. Nga distanca e shërbimeve që u nevojiten për funksionim normal, deri te varësia ekonomike, mundësitë e kufizuara për sukses dhe përparim, në pjesë ku ka izolim të plotë të gruas nga proceset shoqërore.

Ky dokument i përmban ato informatat të fituara parësore dhe interpretimet e përgjigjeve të hulumtimit të realizuar përmes pyetësorit online të dedikuar për identifikimin e nevojave dhe problemeve të grave dhe vajzave që jetojnë në zonat rurale të Komunës së Koçanit dhe rezultatet e të zbatuarave tre fokus grupe me vajza dhe gra që jetojnë në të njëjtin mjedis.

Rezultatet tregojnë se ekziston një varësi e madhe ekonomike e grave, edhe pse lidhin marrëveshje subvencionimi për një kulture të caktuar bujqësore apo blegtorale, fondet nuk menaxhohen prej tyre, nuk janë të njohura me mundësitë e anëtarësimit në kooperativa dhe aplikimit për ato mundësit, as nuk kanë qenë ndonjëherë pjesë e ndonjë lloj shoqate të grave në zonat rurale. Gjithashtu, asnjë nga gratë e anketuara nuk ishte e njohur me pakon e re të masave që mbulon Komuna e Koçanit, por edhe në të cilën mund të aplikojnë me idetë e tyre për bizneset e vogla.

Të gjitha analizat e mëparshme të dokumenteve në dispozicion nga politikat dhe strategjitë e Komunës së Koçanit në lidhje me barazinë gjinore, zhvillimin e bujqësisë dhe shfrytëzimin e masave IPARD tregojnë se nuk ka plan të qartë, as strategji për informim dhe as për motivimin e vajzave dhe grave të reja për të marrë të përfshihen në procese, të ndryshojnë gjendjen e tyre ekonomike dhe të jenë aktorë aktivë në shoqëri. Kjo është arsyeja pse ne kemi përzgjedhur këto dy fusha që mbulohen nga dokumenti i politikave publike dhe për të cilat besojmë se duhet bërë një analizë më e thellë duke përfshirë publikun e gjerë që do të ndihmojë në identifikimin e problemeve, zgjidhjeve të mundshme dhe prioriteteve për të cilat komuna do të duhet të ndajë mjete nga buxheti komunal, por edhe të ndryshohen Strategjitë ekzistuese për barazi gjinore.

PROBLEMI - KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Maqedonia e Veriut është një vend kandidat për anëtarësim në BE. Shteti gjithashtu ka krijuar mekanizma të mundësive të barabarta që synojnë promovimin e barazisë gjinore. E frymëzuar nga politika e përbashkët bujqësore e BE-së, Maqedonia e Veriut po vendos politikën e saj të zhvillimit rural. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse 45% e popullsisë së vendit jeton në zonat rurale. Gjatë përcaktimit të prioritetëve të zhvillimit në politikën e zhvillimit rural, si dhe në fusha të tjera të politikave (si arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale dhe ekonomia), është e nevojshme të vendoset një perspektivë gjinore sepse 49% e popullsisë rurale janë gra.

Në përputhje me nenin 24 të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural (nr. 134/2007), zonat rurale përkufizohen si “zona gjeografike” e përcaktuar me kriteret e mëposhtme: popullsia e vogël ose dendësi e ulët e popullsisë; karakteristikat specifike socio-ekonomike”. Kriteret përcaktohen në detaje me urdhëresë të qeverisë, sipas së cilës lista e vendbanimeve rurale publikohet në Gazetën Zyrtare.

Një analizë e tërthortë e listës, lokaliteteve dhe statistikave zyrtare nga regjistrimi i fundit i vitit 2002 arrin në përfundimin se 45% e popullsisë së përgjithshme (915,665 banorë) në Maqedoninë e Veriut jetojnë në zonat rurale. Gratë rurale përfaqësojnë popullatën femërore që jeton në zonat rurale.

Pjesëmarrja ekonomike e grave rurale kufizohet kryesisht në aktivitetet bujqësore, ndërsa pjesëmarrja e tyre në biznesin bujqësor tip individual/familjar është e balancuar me pjesëmarrjen e burrave ndërsa pjesëmarrja e tyre në kompanitë është më e ulët se ajo e burrave.

Sipas regjistrimit të bujqësisë, të kryer në vitin 2007, ka gjithsej 192.675 ndërmarrje bujqësore individuale, të cilat në thelb përfshijnë ferma familjare (për një përkufizim të detajuar dhe të plotë, shih Metodologjinë e Regjistrimit (SSO, 2007)). Gjithsej 471.069 anëtarë të ekonomive familjare punojnë në ndërmarrje individuale bujqësore. Prej tyre, 202.325 janë gra, që do të thotë se shkalla e pjesëmarrjes së grave është pothuajse 42.8%.

Punësimi formal i grave në bujqësi, pylltari dhe menaxhim me ujëra është 20,3% e numrit të përgjithshëm të grave të punësuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Komuna e Koçanit ka një pjesë të madhe që bie në zonat rurale, ku pjesa më e madhe e popullsisë merret me bujqësi. Komuna përbëhet nga 27 vendbanime (zona rurale). Rreth 80% e vendbanimeve janë në pjesën kodrinore dhe malore, dhe rreth 20% janë fushore.

Gratë rurale janë bartëse të bujqësisë, pra edhe të stabilitetit ekonomik në të gjithë këtë rajon. Paqëndrueshmëria e tyre ekonomike është arsyeja pse nuk kanë arsim të lartë, për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në bujqësi pa qenë bartës aktivë të një ferme bujqësore dhe kjo është lidhja me institucionet e nivelit shtetëror që mund t'i ndihmojnë realisht të ndryshojnë situatën e tyre. Gratë që përballen me varësinë ekonomike dhe mungesën e arsimimit janë pothuajse të panjohura me procesin politik dhe në fakt pjesëmarrja aktive në to mund të përmirësojë pozitën e gruas në mjedisin e tyre.

Komuna e Koçanit ka përgatitur një strategji të përgjegjshme gjinore për zhvillim të qëndrueshëm të Komunës së Koçanit 2019 - 2023. Plani Strategjik për Zhvillim Ekonomik të Përgjegjshëm Gjinor është kornizë veprimi, që merr parasysh burimet, pengesat dhe mundësitë në dispozicion që çojnë drejt një qasje konkrete dhe në zhvillimin e përgjithshëm të dëshiruar ekonomik.

Në këtë kontekst, Strategjia e Komunës së Koçanit fokusohet në qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm duke marrë parasysh kontekstin dhe nevojat lokale, veçanërisht:

- planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal duke vendosur prioritete zhvillimore dhe strukturore, me qëllim që të mundësohet zhvillim i qëndrueshëm dhe i balancuar ekonomik dhe të reduktohen pabarazitë sociale dhe ekonomike ndërmjet grupeve të ndryshme të komunitetit;
- bërja e politikave ekonomike lokale dhe zbatimi i masave dhe aktiviteteve për gjetjen e kushteve për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës, veçanërisht duke marrë parasysh nevojat e grupeve të marginalizuara dhe të grave;
- mbështetja e nismave sipërmarrëse dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në nivel lokal dhe zhvillimi i komunitetit lokal dhe rrjetit të institucioneve dhe agjencive duke promovuar partneritet dhe shfrytëzim racional të burimeve natyrore;
- planifikimi i masave dhe aktiviteteve që dalin nga Karta Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në jetën lokale.

Komuna e Koçanit në qëllimin e saj strategjik: Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ka planifikuar realizimin e këtyre veprimeve:

- Tërheqja e investimeve të reja, duke ofruar përfitime nga Komuna,
- Arsimit në funksion të biznesit (arsim që krijon punëtorë të nevojshëm për biznesin),
- Promovimi i masave aktive për punësim dhe ndërmarrësi të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë,
- Prezantimi i "Ditës së Tregtarëve",
- Mbështetje për sipërmarrjen e grave,
- Mbështetje për sipërmarrjen sociale,
- Mbështetje për sipërmarrësit/et e rinj / të reja.

Në qëllimin strategjik 2, në Komunën e Koçanit, bujqësia njihet si degë fitimprurëse në të cilën angazhohen qytetarët dhe për këtë arsye është planifikuar të realizohen këto veprime:

- Stimujt për fermerët e rinj dhe gratë fermere,
- Rritja e përdorimit të IPARD për të mbështetur bujqësinë, veçanërisht nga gratë,
- Inkurajimi i prodhimit organik të orizit,
- Bashkëpunimi efektiv i ministrisë kompetente me fermerët.

Ekonomia është veçuar si fushë prioritare për ndërhyrje në Komunën e Koçanit, para së gjithash për shkak të rëndësisë së saj jetike për komunën. Gjithashtu, në fushën e ekonomisë, komuna ka përfshirë të gjitha degët ekonomike dhe të shërbimeve, përveç turizmit dhe bujqësisë, të cilat janë të ndara si fusha të veçanta strategjike.

Si mundësi më e madhe për zhvillim, komuna identifikon përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, por edhe mbështetjen e komunës për zhvillimin e sipërmarrjes sociale tek gratë. Në Buxhetin e Komunës së Koçanit për vitin 2021 është paraparë programi Barazi gjinore, nënprogrami Subvencione dhe transfere, zëri Transfere të ndryshme me buxhet të përgjithshëm prej 308.000,00 denarë në krahasim me vitin paraprak kur për këtë program ishte paraparë buxhet i përgjithshëm prej 240.000,00 denarë. Raporti tremujor për realizimin e Buxhetit të Komunës së Koçanit për periudhën 01.01.2021 – 31.03.2021 nuk parasheh mjete financiare për pjesëmarrje më të madhe të vajzave dhe grave rurale në miratimin e politikave në Komunën e Koçanit.

Qasja metodologjike

Qasja metodologjike në hulumtimin e këtij problemi konsistonte në një anketë të kryer në një kampion përfaqësues prej 100 gra dhe vajza nga fshatra të ndryshme dhe mbulon popullatën e përgjithshme femërore të moshave të ndryshme, me status të ndryshëm social dhe etni të ndryshme. Vlerësimi i nevojave dhe problemeve lokale të grave dhe vajzave që jetojnë në zonat rurale të Komunës së Koçanit është bërë duke përgatitur dhe realizuar një pyetësor online përmes faqes zyrtare në Facebook të nismës “Hap drejt më të mirës” dhe grupeve të grave lokale në Facebook – me pyetje të strukturuar nga 2 fusha: bujqësia dhe përfshirja në proceset shoqërore dhe politike. Në fokus grupe morën pjesë gjithsej 21 persona kryesisht vajza dhe gra të papunësuar.

Analiza e pyetjeve që janë pjesë e hulumtimit online tregon nevojën e fuqizimit ekonomik të grave. Gratë që jetojnë në zonat rurale të Komunës së Koçanit pothuajse nuk janë në dijeni të mundësive të hapura për mbështetje financiare nga bujqësia.

Të pyetura nëse kanë lidhur kontrata për prodhim bujqësor në emër të tyre, 100% e të anketuarave janë përgjigjur jo. Ato që kanë dijeni nuk inkurajohen të aplikojnë, sepse nuk i dinë kushtet, por edhe nuk kanë pronë (ara në emër të tyre) që është e nevojshme për regjistrimin si grua - fermere.

$\frac{3}{4}$ e grave të anketuara nuk janë të njohura me kuadrin ligjor për regjistrimin dhe drejtimin e një aktiviteti bujqësor, përkatësisht 50% janë përgjigjur se nuk janë fare të njoftuara dhe 33% se janë shumë pak të njoftuara. Përgjigjet e marra tregojnë faktin se gratë nuk i njohin kompetencat e Komunës, nuk dinë se si realizohet buxheti i komunës dhe nuk i dinë mjetet se si mund të ndikojnë në miratimin e buxhetit. Por në të njëjtën kohë dëshirojnë që Komuna të ketë programe të veçanta për mbështetjen e gjendjes së vajzave dhe grave në Komunën e Koçanit (Grafiku nr.3)

Sipas Ju, a duhet që Komuna të krijojë programe të veçanta në kuadër të Strategjisë për Barazi Gjinore për përmirësimin e gjendjes së vajzave dhe grave rurale në Komunën e Koçanit?



Vetëm 1% e grave besojnë se mund të bëjnë ndryshim nëse janë aktive në politikë dhe parti politike.

Në analizimin e gjendjes së vajzave dhe grave që jetojnë në zonat rurale të Komunës së Koçanit, përmes zbatimit të fokus grupeve, gjetja e parë negative e perceptuar është varësia ekonomike e tyre, që është shumë e lartë. Nga të gjithë të anketuarit, vetëm një grua deklaroi se kishte pronë në emër të saj. Kjo ndikon seriozisht në varësinë e tyre ekonomike, sepse gratë pa pronë në emër të tyre nuk mund të aplikojnë për mundësinë grua - fermere, dhe të kenë sigurim pensional dhe invalidor të paguar.

Shumë gra lidhin vetëm marrëveshje për subvencione për një kulture apo bagëti të caktuar, por të njëjtat mjete dhe menaxhimi i llogarive të transaksionit nuk janë në duart e tyre. Të gjithë vendosen në "buxhetin e familjes". Një nga pjesëmarrëset tha:

“Sot i mjel delet, i qeth, bëj qumësht dhe gjizë por asnjë dele nuk është e imja. Nuk mund të tregoj se cila dele është e imja. Ndërsa para nuk kam fare”.

Asnjë nga gratë nuk e dinte se çfarë është Agjencia për Pagesat Direkte në Bujqësi, edhe pse disa prej tyre kishin lidhur marrëveshje për subvencione. Mos dija e tyre është tregues i pafuqisë dhe mos menaxhimit me mjetet dhe kontratat.

Gratë nuk i dinë mundësitë e anëtarësimit në kooperativa dhe aplikimit për ato mundësi, as nuk kanë qenë ndonjëherë pjesë e ndonjë shoqate të grave në zonat rurale.

Vetëm 3 nga gratë e pranishme ishin të njohura me masat IPARD. Asnjëra prej tyre nuk ka ditur për pakon e re të masave që përfshin Komunën e Koçanit, por edhe në të cilën mund të aplikojnë me idetë e tyre për biznese të vogla.

“Dua të aplikoj për masat IPARD për të hapur një furrë buke në fshatin tim, por im shoq më thotë, nuk është aq e lehtë, nuk je për atë punë”, tha një nga pjesëmarrëset.

“Gjërat me dokumentet janë të komplikuar, pse nuk mund te trajnojnë ndonjëherë nga ne dhe ajo të na informojmë për gjithçka?!”
- ishte sugjerimi i pjesëmarrëseve.

Këto deklaratatë të të anketuarve tregojnë qartë se ka një hendek midis institucioneve të sistemit dhe vajzave dhe grave që jetojnë në zonat rurale.

Vajzat më të reja që morën pjesë në fokus grupe deklaruan se janë të informuara për disa nga masat në bujqësi përmes internetit, por ky nuk është informacion i plotë që mund ta përdorin për të aplikuar dhe për të filluar biznesin e tyre.

Mos gjetja e një “dere të hapur” dhe qasja jo profesionale e institucioneve ndaj kësaj kategorie të qytetareve, i dekurajon ato të përpiqen të kapërcejnë problemin e varësisë ekonomike, por edhe të realizojnë ëndrrat e tyre.

Asnjë nga gratë nuk ka marrë kredi në emër të saj dhe as nuk e dinë se cilat janë kushtet e nevojshme për të.

Një nga gratë tha se ka një ide për të krijuar një biznes inovativ, por nuk di se ku të drejtohet apo si të aplikojë.

Gratë nuk janë të njohura me Strategjinë për Barazi Gjinore të komunës dhe nuk mendojnë se duhet ta dinë për të, sepse nuk besojnë se kjo do të ndryshojë diçka në jetën e tyre.

Gjysma e grave nuk mund të kërkojnë punë në qytet dhe as nuk shkojnë shpesh në qytet sepse nuk ka linja të rregullta autobusësh. Asnjë nga të anketuarat nuk posedon automjet në emër të saj dhe të gjitha kanë përmendur se nëse vendosin të shkojnë në qytet me transport publik, duhet të informojnë burrin e tyre një ditë më parë. Pesëmbëdhjetë gra thanë se dëshironin të rikualifikoheshin dhe të trajnoheshin më tej për të rritur mundësitë e tyre të punësimit.

REKOMANDIME DHE AKTIVITETE

Rekomandime për përmirësimin e informimit dhe trajnimit të grave nga zonat rurale në Komunën e Koçanit:

- 1** Hapja e zyrave ose krijimi i një ekipi mobil nga Zyra Rajonale e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, që do të vizitojë gratë në zonat rurale.
- 2** Trajnimi i të ashtuquajturve “Gra lidere” nga zonat rurale, të cilat do t’u ofrojnë grave informacionin e nevojshëm për të aplikuar në programe të hapura, por që do të jenë edhe një lloj ure midis grave dhe institucioneve.
- 3** Trajnime për fuqizim ekonomik: përfaqësimi i interesave të grave nga zonat rurale, punë kreative, krijimi i produkteve me vlerë të shtuar etj.
- 4** Kontakte të rregullta me komisionin për mundësi të barabarta ndërmjet burrave dhe grave pranë Këshillit të Komunës së Koçanit.
- 5** Përfaqësim për ndryshimin e legjislacionit për lidhjen e kontratave të ndërmarrjeve për grumbullim me fermere.
- 6** Krijimi i masave për grumbullimin e garantuar të produkteve bujqësore të prodhuara nga gratë fermere.
- 7** Trajnime për zgjidhje inovative dhe aplikim për projekte inovative nga gratë dhe vajzat që jetojnë në zonat rurale, për t’i motivuar të ndryshojnë kushtet në të cilat jetojnë, por edhe mënyrat për të promovuar dhe përmirësuar bujqësinë dhe plasmanin e produkteve bujqësore.

BIBLIOGRAFIA

- Buxheti i Komunës së Koçanit për vitin 2021
- Raporti tremujor për realizimin e Buxhetit të Komunës së Koçanit për periudhën 01.01.2021 - 31.03.2021
- Strategjia e përgjegjshme gjinore për zhvillim të qëndrueshëm të Komunës së Koçanit 2019 - 2023
- Strategjia Kombëtare për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për periudhën 2021-2027
- Raporti vjetor i njësive të vetëqeverisjes lokale për progresin e situatës me mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat (periudha raportuese 2020, Komuna e Koçanit)
- Strategjia Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020
- Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/2012, 30/2013, 166/2014 dhe 150/2015 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 53/2021)
- Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural
- Ligji për themelimin e Agjencisë për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë
- Strategjia për zhvillim të barabartë rajonal 2020-2030
- http://www.ipardpa.gov.mk/Root/mak/_docs/%D0%A3%D0%B-F%D0%B0%D1%82%D1%81%D1%82%D0%B2%D0%BE%20115_26112019.pdf
- http://www.ipardpa.gov.mk/root/mak/vest_dolga_mak.asp?VestiID=3010

TË RINJTË NË SHTËPI

Qendër karriere për të rinj në
Dellçevë

- *Katerina Antovska*





REZYME

Problemi të cilit i adresohet ky dokument i politikave publike është emigrimi i të rinjve jo vetëm nga Komuna e Dellçevës, por në përgjithësi nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Shteti po përballlet me të ashtuquajturën “Murtaja e bardhë”, e pandalshme dhe në përmasa shqetësuese emigrimi i të rinjve, sidomos nga pjesa lindore e vendit. Supozohet se kategoria dominuese e personave që largohen nga vendi, janë të rinjtë e papunë, gjë që ndikon negativisht në gjendjen e përgjithshme në tregun e punës.

Disa analiza tregojnë se çdo i treti person i arsimuar largohet nga vendi dhe tetëdhjetë për qind e studentëve të fakulteteve teknike mendojnë ose planifikojnë të largohen pas diplomimit.

Me këtë dokument dëshirojmë të theksojmë këtë problem në Komunën e Dellçevës dhe të ndërgjegjësojmë politike bërësit realë, veçanërisht për politikën rinore, për rëndësinë e mbajtjes së të rinjve në shtëpi. Politike bërësit duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të programojnë politika që do t'i lidhin të rinjtë me sektorin e biznesit, në mënyrë që këto dy palë të jenë partnerë mbështetës dhe të fortë në zhvillimin e një klime më të mirë ekonomike dhe karriere në Dellçevë dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në zhvillimin më të madh të komunës dhe sigurisht popullsia e re e aftë për punë të mbetet në qytet, si parakusht për zhvillimin e tij.

Një nga zgjidhjet e mundshme për zbutjen e këtij problemi është formimi i një qendre karriere në të cilën të rinjtë do të mund të kryqëzojnë dëshirat dhe nevojat e tyre me nevojat e sektorit të biznesit në atë mënyrë që qendrat e karrierës do të kenë për detyrë të gjejnë biznesmenë, gjegjësisht sipërmarrës në fushat që janë prezentë në Komunë, të cilët do të ndihmojnë në krijimin e kuadrove të rinj që do të punonin në bizneset e tyre në të ardhmen, përmes bursave eventuale për arsim të lartë të të rinjve, të cilët pas diplomimit do të detyrohen të kthehen në komunë dhe njohuritë e tyre do t'i përdorin në kompaninë që ka dhënë bursën për shkollimin e tyre.

Themelimi i qendrës së karrierës do të mund të kontribuojë në zvogëlimin e emigrimit të të rinjve nga Dellçeva dhe do të rrisë vetëdijen për nevojën e zhvillimit të komunave të vogla duke investuar në gjeneratat e reja. Për herë të parë do të ofrohet një zgjidhje e planifikuar për zgjidhjen e këtij problemi që zvarritet me vite. Përveç paraqitjes reale të stafit të nevojshëm për industrinë ekzistuese, do të sigurohet edhe një plan zhvillimor i saktë, gjegjësisht udhëzimi i stafit të ri, se si të ndërtojnë më tej karrierën e tyre nëse duan të qëndrojnë në vendlindje.

PROBLEMI - KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Republika e Maqedonisë së Veriut po përballet me problemin kronik të papunësisë dhe migrimit dhe e gjithë situata me korona krizën e ka përkeqësuar edhe më shumë situatën. Numri i të papunëve nga fillimi i janarit 2020 kur ishte 104.409 persona, deri në fund të majit 2020 (në vetëm 5 muaj) u rrit me 16.800 persona të rinj, dhe konkretisht nga marsi deri në maj 2020 – kur kriza ekonomike u përshkallëzua për shkak të shpërthimit të Covid-19, numri i të papunëve u rrit me rreth 15.400 persona.

Nëse hymë edhe më thellë në shifrat zyrtare, të dhënat në këtë periudhë të analizuar tregojnë rritje të papunësisë tek të rinjtë në të gjitha kategoritë e moshave. Në maj të vitit 2020, në Agjencinë për Punësim janë regjistruar gjithsej 25.886 persona të papunë të moshës 15 deri në 29 vjeç, që krahasuar me janarin e të njëjtit vit është një rritje prej 5.063 persona të rinj të papunë. Konkretisht, në vetëm pesë muaj, numri i të papunëve të moshës 15 deri në 19 vjeç është rritur për 146, tek të rinjtë e moshës 20 deri në 24 vjeç për 2.458, dhe numri i të papunëve të moshës 24 deri në 29 vjeç është rritur për 2.459. Kjo tregon se 21,4% e punëkërkesve aktivë të regjistruar në muajin maj ishin të rinj. Me intensifikimin e krizës shëndetësore, vetëm nga fillimi i marsit deri në fillim të qershorit 2020, numri i të rinjve të papunë u rrit me 3.482 të papunë të rinj.

Përveç Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut (APRMV), shkallën e papunësisë e mat edhe Enti Shtetëror i Statistikave. Në fund të tremujorit të parë ekonomik në vitin 2020, shkalla më e lartë e papunësisë (përqindja e të papunëve në krahasim me ata që duan të punojnë) prej 34,9% u regjistrua tek të rinjtë e moshës 15 deri në 24 vjeç, ndërsa njëkohësisht te ky grup i të rriturve është regjistruar dhe shkalla më e ulët e punësimit prej 20,8%. Më shumë se 7.800 të diplomuar nga fakultetet dhe shkollat e larta profesionale të vendit u larguan vitin e kaluar, sipas Entit Shtetëror të Statistikave. Për të gjithë ata, punësimi është zakonisht hapi i parë drejt pavarësisë financiare dhe sociale dhe duhet të hapë derën drejt botës së të rriturve. Nga punësimi varet edhe cilësia e jetës, vetëbesimi i tyre, por edhe vendimet praktike në lidhje me besimin dhe formimin e familjes.

Nga viti 2015 deri në fund të vitit 2019, numri i të rinjve të papunë, sipas statistikave zyrtare, është në rënie. Megjithatë, trendi i uljes së papunësisë tek të rinjtë ndalet në vitin 2019, kur krahasuar me vitin 2018, është regjistruar numër në rritje i të papunëve në nivel vjetor. Pse ka rritje? Nga APRMV thotë se janë dy arsye, të dyja lidhen me mos evidentimin e të rinjve të papunë deri më tani. Së pari, vendosja e masës Garanci rinore përmes së cilës mobilizoheshin të rinjtë e papunë për herë të parë të evidentohen në listat e të papunëve. Arsyeja e dytë janë ndryshimet në Ligjin për mbrojtjen sociale nga maji 2019, të cilat në APRMV, evidentohen të gjithë anëtarët e papunë të një familje, përfitues të ndihmës minimale të garantuar, përfshirë të rinjtë deri në 29 vjeç.

Sipas hulumtimit të Istok që përfshin të rinjtë deri në 35 vjeç, 77,3% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht se duan të largohen nga vendi. Të pyetur se pse do të shkonin në një vend tjetër, rreth 57% u përgjigjën se do të shkonin për fitim, ndërsa vetëm 15% thanë se do të shkonin jashtë vendit si turist. Rreth 80% e të anketuarve janë pajtuar se vendet e tjera ofrojnë mundësi më të mëdha për të rinjtë.

Disa shkojnë për arsim, disa për karrierë dhe disa për mbijetesë. Por të gjithë ata që vendosin të largohen thjesht, nuk e shohin veten në vendin e tyre. Të dhënat nga ai hulumtim tregojnë gjithashtu se lartësia mesatare e të ardhurave është nga 500-700 euro, të cilën mërgimtarët e dëshirojnë si kusht që përfundimisht të kthehen në vendlindje.

Vendi, përveçse nuk ka strategji për të ndaluar këtë trend, nuk ka statistikat e veta për numrin e saktë të personave të shpërngulur, ndaj pyetja është se si do të reflektohet në planin afatgjatë, si do të kompensohet mungesa e stafit të kualifikuar. Rreth 53% e të rinjve duan të largohen nga vendi, sipas një studimi të Fondacionit Friedrich Ebert. Banka Botërore njoftoi se deri në vitin 2013, rreth 600 mijë njerëz kishin emigruar nga Republika e Maqedonisë së Veriut; Sipas shërbimit statistikor të Bashkimit Evropian – Eurostat, në periudhën nga viti 1998 deri në vitin 2011 nga Republika e Maqedonisë së Veriut janë larguar rreth 230 mijë qytetarë, kryesisht të rinj. Republika e Maqedonisë së Veriut nuk ka statistika të veta për numrin e personave të shpërngulur nga vendi. Mijëra të rinj që kanë shkuar jashtë vendit, siç dëshmojnë hulumtimet e institucioneve ndërkombëtare, për Republikën e Maqedonisë së Veriut do të nënkuptojnë humbje të potencialit njerëzor dhe fuqisë së nevojshme për zhvillimin e ardhshëm të vendit. Situata alarmante me largimin e të rinjve dhe të arsimuarve konfirmohet nga dokumenti i Qeverisë “Strategjia kombëtare për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e largimit të kuadrove 2013-2020”. Rreth tridhjetë për qind e stafit me arsim të lartë jetojnë dhe punojnë jashtë vendit.

Modeli i qeverisë për studime të disperzuara në qytetet e vogla, si koncept, ka kontribuar vetëm në rritjen e numrit të njerëzve që presin punë me diplomë në dorë. Po rritet edhe rritmi i largimit të kuadrove për punë fizike (zejtarë) të cilët ende kërkohen në vendet perëndimore. Por edhe mjekë, inxhinierë, shkencëtarë, studentët, gjithashtu po largohen. Vetëm në tre vitet e fundit më shumë se 1780 mjekë nga rajoni janë larguar me dëshirë për zhvillim profesional dhe të ardhura më të larta. Kategoria më e zakonshme që shpërngulet janë moshat 15-24 dhe 25-40 vjeç.

Strategjia e re kombëtare për të rinjtë 2016-2025 e përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, vë në dukje një nga problemet kryesore në lidhje me situatën financiare, si dhe çështje të tjera që lidhen me cilësinë e jetës. Sipas informacioneve joformale, madje edhe ata që gjejnë punë në vitin e parë pas diplomimit, ende mendojnë të largohen. Për të zgjidhur problemin duhet parë eksperiencën e vendeve të tjera, por duhet edhe strategji për mbajtjen dhe kthimin e të larguarve.

SITUATA NË KOMUNËN E DELLÇEVËS

Për të tejkalluar problemin e migrimit të popullatës së re nga Komuna e Dellçevës, është e nevojshme të hulumtohen nevojat si të rinisë ashtu edhe të sektorit afarist në komunë, ndërsa autoritetet komunale të kenë një pasqyrë të qartë të situatës në bazë të së cilës mund të fillojnë të zgjidhin këtë problem të madh.

Për këtë qëllim u mbajt punëtori me 20 pjesëmarrës të rinj dhe punëtori me përfaqësues të sektorit afarist në Dellçevë, nga industria e tekstilit (konfeksion), hoteleria, për-punuesit e plehrave artificiale dhe materiale të tjera bujqësore, pronarë butikësh dhe dyqanesh të tjera, pronarë restorantesh etj.

Gjithashtu është zhvilluar një intervistë me 20 të anketuar, të rinj, orientimi profesional dhe karriera e të cilëve është në ndërtim e sipër.

Më shumë se gjysma e të rinjve të intervistuar veten e shohin jashtë vendit në të ardhmen. Të anketuarit besojnë se grup moshë më e zakonshme që largohet nga komuna është deri në 30 vjeç.

Arsyet e shpërnguljes janë të ndryshme, por më shpesh të kombinuara. Asnjëherë nuk është vetëm një arsye, si ajo ekonomike që i bën të rinjtë të largohen nga vendi, por shpeshherë në këtë vendim ndikojnë zhvillimet politike dhe (pa) siguria ligjore. Nga punësitoria me pjesëmarrës të rinj mund të konstatohet se të rinjtë tregojnë vetëdije dhe racionalitet në perceptimet e tyre për problemin e migrimit.

Në punësitorinë me përfaqësues të sektorit të biznesit, pjesëmarrësit patën mundësinë të paraqesin pikëpamjet e tyre për këtë problem. Është e qartë se ata nuk janë të kënaqur me trajnimet që marrin të rinjtë, gjegjësisht se nuk kanë staf të gatshëm që mund të përfshihen menjëherë në punë, por nga ana tjetër thonë se kanë nevojë për fuqi punëtore.

Kështu, sipas tyre, "kur dikush fillon biznesin e tij, efektin dhe fitimet i sheh vetëm pas 10 vitesh, nuk bëhet biznesmen brenda natës, duhet shumë punë dhe mund; qëllimi i daljes jashtë vendit nuk duhet të jetë prioritet; edhe këtu ka punë por duhet punuar; produktiviteti i punëtorëve është i ulët; struktura e moshës së punëtorëve është 35-40 vjeç e lart".

REKOMANDIME DHE AKTIVITETE

Të gjitha hulumtimet e deritanishme kanë konfirmuar disa nga faktorët e nevojshëm për tejkalimin e problemit me migrimin. Disa prej tyre janë krijimi i klimës së mirë për biznes, me inkurajimin e sipërmarrjes tek të rinjtë dhe me përmirësimin e shërbimeve sociale.

Megjithatë, një rol shumë të rëndësishëm luan edhe tranzicioni nga procesi arsimor. Tre lloje shërbimesh dallohen si veçanërisht të rëndësishme për sa i përket ofrimit të mbështetjes për punësimin e të rinjve dhe zhvillim të aftësive të nevojshme, konkretisht: orientimi në karrierë, praktika dhe trajnimi për të fituar aftësi për punësim. Në Komunën e Dellçevës ekziston qendra e karrierës në kuadër të shkollës së mesme, ka edhe shërbime të caktuara në kuadër të APRMV-së. Është e qartë se e gjithë kjo nuk jep rezultatet e pritura.

Një nga zgjidhjet e mundshme për këtë problem është hapja e një qendre karriere. Qendra Komunale e Karrierës do t'u ofrojë të rinjve qasje në shërbime cilësore të karrierës që do t'i ndihmonin ata të fitojnë aftësi në menaxhimin e karrierës së tyre, do të ofrojë koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet palëve kryesore të interesuara në mënyrë që të rinjtë të mund të zbulojnë lehtësisht udhëzimet për shërbimet e karrierës në dispozicion të tyre; të rinjtë do të kenë qasje në informacionin përkatës për karrierën dhe do të përdorin më mirë mundësitë e trajnimit për të fituar aftësi për punësim.

Themelimi i qendrës komunale për karrierë do të mundësojë përfshirje më të madhe të të rinjve nga Dellçeva në shërbimet e këshillimit për karrierë (informim për karrierë, këshillim për karrierë dhe edukim për karrierë).

Qendra Komunale e Karrierës do të krijojë mekanizma efektivë për koordinim dhe komunikim ndërmjet institucioneve të ndryshme të përfshira në ofrimin e udhëzimeve për karrierë. Këta mekanizma janë thelbësorë si nga këndvështrimi i politikave - në drejtim të shmangies së fragmentimit të politikave dhe dyfishimit të përpjekjeve, ashtu edhe nga këndvështrimi i të rinjve - në aspektin e identifikimit të lehtë të gjërave në dispozicion të tyre.

Në komunën e Dellçevës ka disa industri të cilave u mungon kuadri i arsimuar, i cili është adekuat dhe kompetent në fushat e tyre, me qëllim zhvillimin e tyre, si: industria e tekstilit, industria e drurit, bujqësia dhe pylltaria, industria e makinerive, si dhe sfera për prodhimin e produkteve të qumështit dhe ushqimit. Qendra e Karrierës do të lidhë pronarët e bizneseve dhe stafin e ri të Komunës, në atë mënyrë që do të ofrojë program për mbështetje reciproke, gjegjësisht do të bëjë një plan dhe strategji për bashkëpunimin e tyre, analiza të tregut të punës, si dhe përpjekje konkrete nga të gjithë aktorët për të gjetur zgjidhje të përshtatshme dhe të qëndrueshme.

Me këtë, të rinjtë do të kenë mundësi për mbështetje financiare nga sipërmarrësit në formë të bursave për arsimimin e tyre, do të mund të ndiqnin punë praktike në të njëjtat kompani dhe pas përfundimit të shkollimit të punësoheshin dhe të përdornin njohuritë e tyre në zhvillimin e atyre sektorëve. Komuna do të përfshihej edhe në ofrimin e mbështetjes për të rinjtë dhe bizneset, e cila do t'u ofrojë përfitime këtyre dy target grupeve përmes bursave shtesë për të rinjtë, përkatësisht promovimit të bizneseve që do të përfshihen në programet e përgatitura nga Qendra e karrierës.

Për të zbutur migrimin e të rinjve në Komunën e Dellçevës nevojiten masa të tjera që duhet të zbatohen paralelisht me iniciativën për hapjen e Qendrës komunale të karrierës.

BIBLIOGRAFIA

- Agjencia e Punësimit <https://av.gov.mk/>
- Enti Shtetëror i Statistikave <https://www.stat.gov.mk/>
- Studimi i Fondacionit Friedrich Ebert <https://library.fes.de/pdf-files/id-moe/15266.pdf>
- Strategjia Kombëtare për Rrjetëzimin, Bashkëpunimin dhe Reduktimin e Largimit të Personelit 2013-2020 <https://mon.gov.mk/stored/document/Izvestaj-%20Strategija%20za%20sprecuvanje%20na%20odliv%20na%20mozoci-%20juni%202021.pdf>
- Strategjia Kombëtare për Rininë 2016-2025 <https://www.sega.org.mk/images/E-Library/Strategies/NSMK.pdf>




PARKU ADRENALIN

Për të rinjtë në Kumanovë

- Nenad Bojkovski

PEACE



LOVE AND  SKATE

REZYME

Komuna e Kumanovës është komunë urbane me sipërfaqe të pamjaftueshme të gjelbra dhe vende për rekreacion. Si rrjedhojë, të rinjtë e kalojnë pjesën më të madhe të kohës së lirë në kafeteri ose para kompjuterëve të tyre. Edhe për shkak të situatës aktuale me pandeminë të rinjtë janë kryesisht të izoluar nga njëri-tjetri, bëhen antisocial, shmanget argëtimi dhe shoqërimi. Për të gjitha këto arsye, të rinjtë duhet të kenë një vend ku do të mund të shoqërohen sërish dhe të bëjnë atë që duan.

Qëllimi i këtij dokumenti për politika publike është të propozojë masa për përmirësimin e komunikimit ndërmjet të rinjve dhe inkurajimin e të rinjve që të socializohen dhe të bëjnë më shumë aktivitete fizik përmes sporteve adrenalike në mënyrë që të rriten në individë të shëndetshëm, moral dhe social, të cilët do të ndërjegjësohen për gjendjen e tyre në shoqëri dhe të gatshëm për të zgjidhur problemet në përputhje me parimin sportiv të konkurrencës dhe shoqërimit. Kjo do të arrihej duke ndërtuar një vend për rekreacion (park modern adrenaline) brenda të cilit do të ndërtohej një skejt park, park për biçikleta dhe një mur ngjitjeje - climbing.

Skejt parku është planifikuar të pasurohet me grafite nga artistë vendas. Do të jetë një vend për të gjithë të rinjtë, një vend krijimtari, miqësie dhe argëtimi, një vend pa paragjykime dhe pa përçarje.

Kjo iniciativë është një përpjekje për të pasuruar jetën në komunën e Kumanovës. Nga zbatimi i tij pritet që të përfitojnë të gjithë qytetarët, jo vetëm të rinjtë. Parku do të kishte hapësirë edhe për prindërit që do të shëtisnin atje me fëmijët e tyre, por edhe për të rritur që mund të pushonin në stola, të lexonin gazetë dhe të kujtonin ditët kur ishin të rinj dhe kur bënë miq pa paragjykime.

PROBLEMI - KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Komuna e Kumanovës është komuna më e madhe në Republikën e Maqedonisë e Veriut. Sipas regjistrimit të vitit 2002, Kumanova ka 105.484 banorë, prej të cilëve 25 771 janë të rinj të moshës 15 deri në 30 vjeç (regjistrimi i vitit 2002, të dhënat nga Enti Shtetëror i Statistikës). Struktura kombëtare e popullsisë në Komunën e Kumanovës është si vijon: maqedonas 59.58%, shqiptarë 26.44%, turq 0,28%, romë 4,03%, vllahë 0,14%, serbë 8,59%, boshnjakë 0,02% dhe të tjerë 0,64%.

Duke qenë se zhvillimi i komunitetit përcaktohet nga aftësia e njerëzve vendas për të mobilizuar burimet dhe për të përcaktuar nevojat lokale, të rinjtë janë një burim i paçmuar. Nëpërmjet përfshirjes dhe bashkëpunimit të tyre, të rinjtë fitojnë aftësi, siguri, vetëvlerësim dhe aftësi drejtuese. Një rol të rëndësishëm për ta në zhvillimin e komunitetit luan motivimi i tyre për këtë lloj angazhimi qytetar dhe paraqet fokus të rëndësishëm në shumë kërkimeve dhe ndërtimin e programeve zhvillimore. Që përfshirja e të rinjve të ketë efekt, duhet të pranohet nga institucionet dhe të zbatohet në proceset që ndikojnë mbi të rinjtë në jetën e përditshme.

Vitet e fundit vërehet se organizatat e shoqërisë civile në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë gjithnjë e më shumë të përfshira në proceset e politikëbërjes dhe miratimit të ligjeve. Ekzistojnë disa dokumente që ofrojnë bazën për përfshirjen e publikut në procesin e miratimit të ligjeve, ndërsa progres i veçantë në këtë drejtim është miratimi i Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore⁹⁴. Ligji parashikon disa masa për të përmirësuar pjesëmarrjen e të rinjve përmes mekanizmave në nivel lokal që do të sigurojnë përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e krijimit të politikave publike dhe vendimmarrjes në interes të të rinjve. Pra, duhet të krijohen këshillat rinorë lokalë në nivel lokal, të emërohet një person, referent për bashkëpunim me të rinjtë dhe të formohen qendrat rinore. Procesi i zbatimit të këtij ligji tashmë është duke u zhvilluar.

Komuna e Kumanovës nuk ka një strategji aktuale lokale për rininë. Strategjia më e fundit për të rinjtë⁹⁵ i Komunës së Kumanovës ishte për periudhën 2014-2019 dhe parashiheshin hapa konkretë për zhvillimin e sektorit të rinisë në komunë në mënyrë që të jetë platformë për pjesëmarrje më të madhe të të rinjve në proceset vendimmarrëse. Strategjia parashikonte gjithashtu 6 prioritete strategjike, duke përfshirë projekte që trajtojnë çështje të caktuara në fusha të rëndësishme për të rinjtë.

Duke pasur parasysh se komuna e Kumanovës është qytet multietnik, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet krijimit të përmbajtjeve ku të rinjtë me përkatësi të ndryshme fetare dhe etnike do të mund të takohen, socializohen dhe shkëmbejnë mendime dhe ide. Mënyra më e mirë për të lidhur të rinjtë është përmes aktiviteteve sportive dhe rekreative, përmes të cilave të rinjtë ndërtojnë më lehtë bashkëjetesën, punën në grup dhe fer plej.

Në periudhën nga 16 korriku deri më 23 korrik, janë realizuar një sërë aktiviteteve si pararendëse e këtij dokumenti të politikave publike, me qëllim skanimin e situatës në terren në drejtim të krijimit dhe zbatimit të politikave rinore dhe shkallës së mbulimit të nevojave rinore në Komunën e Kumanovës. Një nga aktivitetet ishte realizimi i pyetësorit me të rinjtë nga komuna e Kumanovës, me qëllim të përcaktimit të prioriteteve dhe nevojave të tyre. 200 të rinj nga komuna janë intervistuar dhe 52 të njëjtit pyetësor iu përgjigjën online përmes portalit kumanovonews.

Pjesë integrale e analizës janë rezultatet e siguruar nga dy fokus grupe në të cilat kanë marrë pjesë gjithsej 20 pjesëmarrës nga struktura të ndryshme moshash dhe profile të ndryshme profesionale (përfaqësues të institucioneve, sektorit të biznesit, përfaqësues të organizatave rinore të shoqërisë civile lokale).

Ky dokument është bërë në bazë të rezultateve të siguruar me qëllim të nxjerrjes së konkluzioneve që pasqyrojnë gjendjen aktuale dhe rekomandimeve të dhëna për përmirësimin e kushteve për cilësi më të mirë të jetës për të rinjtë në Komunën e Kumanovës.

94 Ligji për Pjesëmarrje rinore dhe politika rinore 2020, <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2020/03/Zakon-za-mladinsko-uchestvo-i-mladinski-politiki-16-01-2020.pdf>

95 Strategjia për të rinjtë e Komunës së Kumanovës 2014-2019 <https://kumanovo.gov.mk/wp-content/uploads/2018/03/%d1%81%d1%82%d1%80%d0%b0%d1%82%d0%b5%d0%b3%d0%b8%d1%98%d0%b0-%d0%b7%d0%b0-%d0%bc%d0%bb%d0%b0%d0%b4%d0%b8-2014-2019.pdf>

Analiza sipas hulumtimit dha përgjigje në pyetjet e parashtruara në hulumtim:

- Shkalla e informimit dhe shkalla e komunikimit ekzistues ndërmjet të rinjve dhe institucioneve kompetente që krijojnë politika rinore në nivel lokal;
- Shkalla e zhvillimit të planifikimit strategjik në institucionet përgjegjëse për krijimin dhe zbatimin e politikave publike në fushën e politikave rinore;
- Shkalla e interesimit për përfshirje më të madhe në aktivitetet e mëtejshme të të rinjve në politikëbërje;
- Niveli i cilësisë së jetës së të rinjve në Komunën e Kumanovës sipas të anketuarve;
- Përcaktimi i prioritetit të të rinjve në Kumanovë;
- Mesazh për autoritetet.

Rezultatet e hulumtimit treguan se 65% e të rinjve të anketuar nuk i janë drejtuar asnjëherë një institucioni kompetent për zgjidhjen e një problemi, ndërsa pjesa më e madhe prej 35% që i janë drejtuar institucioneve me një kërkesë specifike janë punonjës (gjë që tregon pasivitetin e studentëve dhe gjimnazistëve).

Ata që iniciuan komunikimin me vetëqeverisjen lokale, më së shpeshti synimi i tyre ka qenë kryetari i komunës nga i cili kanë kërkuar rregullimin e shtigjeve për biçikleta, si dhe një sërë aktivitetesh kulturore. Qytetarët ia kanë deklaruar komunës problemet dhe nevojat e tyre dhe disa prej tyre, siç na kanë theksuar, kanë qenë: mungesa e vendeve ku të rinjtë mund të mblidhen dhe të luajnë sport, ndërtimi i një parku rekreativ dhe një vend për shoqërim në lagje, ndërtim i skejt parkut, kërkesë në NP Pastërti për grumbullim të rregullt të mbeturinave, kërkesë për ndërtimin e këndit të lojërave për fëmijë, lirim të hapësirës për promovimin e talenteve të rinj në mjedis të hapur, rregullimin e shtigjeve në keq, zgjidhje të problemit me qentë endacak dhe kërkesa për hapjen e qendrave rinore.

Hulumtimi tregoi gjithashtu se termi dhe koncepti "politika rinore" njihet vetëm nga 39% të të anketuarve, gjë që tregon se shumica prej 61% e të anketuarve nuk e dinë se cilat janë politikat rinore.

Sa i përket pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e politikëbërjes, të pyetur nëse komuna e tyre i ka konsultuar ata në krijimin e Programit për të rinjtë përmes pjesëmarrjes në debat publik, forum apo formë tjetër të pjesëmarrjes së të rinjve, vetëm 17 persona kanë konfirmuar se janë kontaktuar.

Edhe pse një përqindje e vogël e të rinjve u kontaktuan dhe u përfshinë në procesin e politikëbërjes, ka ende një përqindje të lartë të të rinjve të interesuar për pjesëmarrje aktive në politikëbërje, përkatësisht vetëm 20% e të anketuarve thanë se nuk kanë interes të përfshihen në proceset.

Cilësia e jetës për të rinjtë në Kumanovë për shumicën e të anketuarve është 42% e dobët, për 40% është e kënaqshme, ndërsa vetëm 10% e vlerësojnë me notë shumë të mirë, ndërsa për 6% e të anketuarve cilësia e jetës në Kumanovë është e shkëlqyer. Të anketuarit besojnë se vetëm 8% e të rinjve janë aktivë në komunitet, 67% besojnë se nuk ka aktivizëm rinor, ndërsa 25% nuk kanë informacion për aktivizmin rinor për shkak të të cilit nuk iu përgjigjën pyetjes.

E përbashkëta për të gjithë është se si prioritet për të rinjtë e Komunës së Kumanovës është nevoja për ndërtimin e parkut adrenalini.

REKOMANDIME DHE AKTIVITETE

Nga hulumtimi i bërë mund të veçohen disa rekomandime që do të përmirësojnë pjesëmarrjen e të rinjve, por edhe cilësinë e jetës së të rinjve në komunën e Kumanovës.

Rekomandim kyç për përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve nga Kumanova është ndërtimi i parkut adrenalini.

Parqet adrenalinike janë bërë shumë të njohura vitet e fundit në vendet e zhvilluara dhe në vendet fqinje. Në fakt, ato janë terrene të dizajnuara mirë që ofrojnë argëtim dhe rekreacion përmes aktivitetit fizik.

Parqet adrenalinike kanë një gamë të gjerë përdorimi, mund të përdoren nga njerëz me aftësi të ndryshme fizike dhe të moshave të ndryshme. Ato në përgjithësi janë të dizajnuara si poligone lartësie të vendosura midis pemëve ose shtyllave, të lidhura me litarë dhe kablllo dhe kanë disa dizajne dhe variante si të ashtuquajturat poligone me litar, poligone të lartësisë, poligone të ultësirës, zip line etj.

Parqet e adrenalinit bashkojnë synime edukative, zhvillimore dhe rekreative. Rezultatet më të përmendura nga përdorimi i parqeve adrenalinike përveç argëtimit janë: bashkëpunimi më i mirë, vendimmarrja e mirë, rritja e vetëbesimit, marrja e rrezikut pozitiv, lidhje më e mirë, besimi, rritja e vetëvlerësimit, vendosja e mirë e qëllimeve, puna e mirë ekipore, të gjitha përmes aktivitetit fizik.

Në rajon janë ndërtuar shumë parqe adrenalinike në lagje banimi dhe në zona të mëdha urbane dhe kryesisht në vende turistike për të plotësuar atraktivitetin e ofertës turistike. Kroacia është lider në rajon për investime në këtë segment krahas ofertës klasike turistike, andaj në këtë drejtim do të përmendim parqet adrenalinike të zhvilluara në vijim: në eko-fshatin Zhumberak (2006); në Konavle, Poljicë (80 m, 2013); Auto-kamp Strasko, Novalja, si dhe Adrenaline Park Rizvan City i vendosur në Lika në fshatin Rizvanusha në parkun kombëtar Velebit.

Deri më tani në Maqedoni janë ndërtuar 2 parqe aventureske: Parku Panorama Pehçevë dhe Parku Sportiv-Adrenaline në Karposh të Shkupit.

Parku i aventurave Panorama Pehçevo ka një gjatësi totale prej 600 metrash, si dhe 36 rampa, nga të cilat 24 janë vetëm për të rritur, ndërsa 12 për fëmijë. Parku përbëhet nga dy pjesë: shtegu adrenalini, 360 metra i gjatë, i cili kërkon përgatitje të madhe fizike dhe mendore dhe shkakton frikë dhe është i destinuar për të rriturit; Zip line me gjatësi 240 metra për të rritur dhe fëmijë, i cili është pjesë e ekosistemit të banjës "Ezerce". Parku sportiv-adrenalini në Karposh përbëhet nga shkëmbi ngjithës, seksioni adrenalini, fusha futbollit dhe volejbollit në rërë, skver, skejt park dhe pajisje të reja urbane. Përvojat e përmendura mund të përdoren në dizajnimin e përmbajtjes së parkut adrenalini në Kumanovë.

Aktivitetet fillestare në këtë drejtim do të ishin:

- 1** Harta e vendndodhjes për parkun adrenaliniq;
- 2** Zhvillimi i një zgjidhje projektimi për parkun adrenaliniq;
- 3** Përgatitja e elaboratit për parkun adrenaliniq;
- 4** Aksion vullnetar për pastrimin e lokacionit që do të përzgjidhet si park adrenaliniq;
- 5** Sigurimi i financave dhe kryerja e procedurës për përzgjedhjen e kontraktorit;
- 6** Ndërtimi i parkut adrenaliniq.

BIBLIOGRAFIA

- Ligji për Pjesëmarrje rinore dhe politika rinore 2020, <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2020/03/Za-kon-za-mladinsko-uchestvo-i-mladinski-politiki-16-01-2020.pdf>
- Strategjia për të rinjtë e Komunës së Kumanovës 2014-2019 <https://kumanovo.gov.mk/wp-content/uploads/2018/03/%d1%81%d1%82%d1%80%d0%b0%d1%82%d0%b5%d0%b3%d0%b8%d1%98%d0%b0-%d0%b7%d0%b0-%d0%bc%d0%b-b%d0%b0%d0%b4%d0%b8-2014-2019.pdf>

KUSH I PËRFAQËSON TË RINJTË?

Propozim masa dhe politika për
përmirësimin e situatës së të
rinjve

- *Nikolla Cvetkoski*





REZYME

Ky dokument synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe informimin për çështjen e sfidave rinore.

Hulumtimet e kryera për qëllimet e këtij punimi tregojnë se të rinjtë ndiejnë se shoqëria është në një gjendje të pashpresë, për këtë arsye ata refuzojnë plotësisht të përfshihen në çështjet sociale, ndërsa ata që tashmë kanë marrë pjesë në iniciativa qytetare dhe politike më vonë heqin dorë.

KONTEKSTI DHE RËNDËSIA E PROJEKTIT

Popullata e re në vend, e veçanërisht në komunën kryesore të Shkupit - Qendër, po përballlet me ndikim të parëndësishëm social. Gjegjësisht, ky grup i bashkëqytetarëve është një grup jashtëzakonisht jo aktiv dhe grup social që tregon ngurrim të theksuar për të marrë pjesë në proceset aktuale politike në nivel lokal. Efekti i këtij realiteti është:

- Përfaqësimi i pamjaftueshëm i të rinjve në institucionet lokale;
 - Pjesëmarrja e pamjaftueshme e të rinjve në proceset aktuale politike dhe sociale në nivel lokal;
 - Mos informim i theksuar dhe mos dije për dinamikat politike lokale dhe sfidat e komunitetit lokal.
- Në favor të kësaj që u përmend më lartë, flasin edhe tre grupe të argumenteve:
- Në Këshillin e Komunës Qendër, nga gjithsej 23 këshilltarë, aktualisht vetëm një këshilltar është nën moshën 29 vjeçare⁹⁶;
 - Në Kuvend, nga gjithsej 120 deputetë, vetëm 1 është nën 29 vjeç ;
 - Termi “politika rinore” nuk përdoret në sistemin juridik të vendit tonë prej 19 vitesh .

Nuk është aspak e shëndetshme për çdo sistem liberal dhe demokratik siç është sistemi maqedonas, kur të rinjtë, si bartës të ideve të reja dhe ambasadorë të mendje hapjes dhe progresivizmit, refuzojnë të marrin pjesë në jetën politike edhe në një nivel minimal në kuptimin e pjesëmarrjes në një proces zgjedhor. Rinia politikisht pasive nuk është kurrë një karakteristikë pozitive sociale. Apatia vërehet jo vetëm në mungesën e pjesëmarrjes dhe organizimit të të rinjve, por edhe në pjesën e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Të rinjtë mendojnë se është e kotë të hedhin ndonjë hap, pikërisht sepse nuk kanë mundësi adekuate për t'u përfshirë në proces, prandaj me vetëdije zgjedhin të qëndrojnë mënjana.

96 Shiko centar.gov.mk/?page_id=4992, korrik 2021.

97 Shiko sobranie.mk/segashen-sostav-2020-2024.nspk, korrik 2021.

98 Shiko <https://bit.ly/2PA80LU>, korrik 2021.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT PËR HARTIMIN E DOKUMENTIT PËR POLITIKA PUBLIKE

Premisa bazë për dinamizimin e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politike në nivel lokal është që ata të dëgjohen, që është edhe synimi kryesor i kësaj nisme.

Nëpërmjet prizmit të kësaj që u përmend, për arritjen e këtij qëllimi janë bërë këto aktivitete:

- Përgatitja e analizës krahasuese legislative;
- Përgatitja e pyetësorit të anketës dhe kryerja e hulumtimit të opinionit publik;
- Punëtori tematike me pjesëmarrjen e 20 të rinjve.

Analiza krahasuese legislative dha një pasqyrë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të të gjitha rregulloreve ligjore përkatëse në fushën e pjesëmarrjes rinore dhe politikave rinore, përkatësisht:

- Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore;
- Programi për arsim dhe pjesëmarrje rinore për vitin 2021
- Strategjia nacionale për të rinjtë 2015 - 2025.

Njëkohësisht, në kuadër të kësaj analize është bërë një pasqyrë e detajuar e lëndës së punës, si dhe e aktiviteteve të:

- Zyrës për të rinj të Komunës Qendër;
- Këshillit Rinor Lokal;
- Qendrës Rinore si dhe
- Nëpunësit për të rinj.

Së fundi, në finale të këtij dokumenti, bëhet një analizë krahasuese e kësaj çështjeje përmes shembullit të Republikës së Kroacisë, i cili u zgjodh si vend referencë për shkak të kaluarës së përbashkët, si dhe për të ardhmen e përbashkët evropiane që ka një ndikim pozitiv në drejtim të mundësimin të zbatueshmërisë më të madhe në rendin maqedonas të përvojave, nga ky vend shumë i rëndësishëm për ne.

Konkluzioni kryesor që del nga analiza krahasuese legislative është se zbatimi i Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore është në një nivel të parëndësishëm, gjë që redukton në mënyrë drastike mundësitë për organizim më të mirë të të rinjve, përkatësisht përfshirjen aktive të të rinjve në proceset shoqërore dhe politike.

Pyetësi i anketës realizuar në 55 të anketuar, në mënyrë elektronike, në periudhën prej 7 deri më 16 qershor 2021, për të anketuarit nga moshë 18 deri në 29 vjeç, në territorin e komunës Qendër nga ana tjetër, qartë pasqyron përshtypjen se ekziston pjesëmarrje rinore shumë e vogël në proceset politike lokale dhe sociale. Në një kuptim konkret, tetë faktet e mëposhtme imponohen në mbështetje të përfundimit të deklaruar:

- Të rinjtë shfaqin tendenca për përfshirje të prolonguar (më vonë) në proceset shoqërore dhe politike në nivel lokal;

- Gratë e reja, nga ana tjetër, shfaqin tendenca të përmbajtjes më të theksuar nga aktivizmi politik dhe social në nivel lokal në krahasim me meshkujt;
- Anëtarësimi në organizatat politike dhe shoqërore të të rinjve është në përpjesëtim të drejtë me nivelin e njohjes me proceset lokale politike dhe sociale. Gjegjësisht, njohja më e madhe presupozon angazhim më të madh. Dhe anasjelltas!;
- Arsimi formal për të rinjtë luan një rol vendimtar në drejtim të përfshirjes në proceset politike dhe sociale në nivel lokal. Gjegjësisht, arsimi i lartë nënkupton tendenca më të theksuara për përfshirje dhe anasjelltas: arsimi i ulët është tregues i pjesëmarrjes së reduktuar në proceset politike dhe sociale në nivel lokal të një personi të ri;
- Më shumë se gjysma e të rinjve legjitimojnë OJQ-të kundrejt partive politike, që është tregues i besimit të ulët në partitë politike;
- Në të njëjtën kohë, të dhënat tregojnë se të rinjtë mendojnë praktikisht, gjegjësisht e drejtojnë vëmendjen dhe përkushtimin e tyre në organizatat studentore, si shoqata që merren drejtpërdrejt me sfidat më urgjente rinore, përkatësisht studimet dhe arsimin;
- Edhe pse pjesa më e vogël e përgjigjeve është se asnjë organizatë nuk i përfaqëson të rinjtë, duke pasur parasysh se pothuajse 1/8 e të anketuarve e kanë dhënë këtë përgjigje, na çon drejt përfundimit se shumica e të rinjve në komunën Qendër ndihen të pa përfaqësuar;
- Një motivim më i madh për të rinjtë që të votojnë do të ishin kandidatët politikë të rinj/më modernë ose opsionet politike që ofrojnë një diskurs të ndryshëm qeverisjeje.

GJETJA E SFIDAVE MË TË MËDHA RINORE

Hulumtimi i kryer për qëllimet e këtij dokumenti ka përcaktuar sfidat e mëposhtme: **1)** papunësinë; **2)** arsimin; **3)** emigracionin; **4)** partitë politike, **5)** apatia politike dhe sociale si sfidat më të mëdha të të rinjve.

Edhe pse partitë politike nuk u ofruan aspak si përgjigje, të anketuarit gjatë një zgjedhje të lirë, përveç që i përmendin drejtpërdrejt partitë politike si sfidën kryesore sociale të të rinjve, në të njëjtën kohë i lidhin ato me të gjitha sfidat e tjera.

Sa i përket papunësisë, megjithatë, hulumtimet kanë treguar se kjo dukuri lidhet drejtpërdrejt me problemin e “punësimeve partiake”, si dhe nepotizmin, korrupsionin dhe emërimin e kuadrove joadekuate në poste drejtuese.

Në aspektin arsimor, analiza rinore e lokalizon sërish problemin në politikën që nuk arrin të ofrojë më shumë mësim praktik, që tregon neglizhencë për shëndetin psikologjik të nxënësve dhe që imponon gabimisht interesa të ngushta partiake në institucionet arsimore.

Për sa i përket emigracionit, të dhënat tregojnë se të rinjtë në pjesën më të madhe tregojnë politizimin e segmenteve shoqërore, si dhe standardet e ulëta të jetesës dhe standardin ekonomik si arsye për rritjen e këtij procesi në vend.

Partitë politike, si shkak i përmendur në hulumtim janë përmendur si sfidë sociale e të rinjve për shkak të përfshirjes së dukshme në segmentet sociale që lidhen drejtpërdrejt me sfidat kryesore rinore, përkatësisht: avancimi në punë, si dhe diskriminimi në punësim në bazë të anëtarësimit, përkatësisht mos anëtarësimit në parti politike.

Përfundimisht, por jo më pak e rëndësishme, janë veçanërisht mbresëlënëse të dhënat sipas të cilave të rinjtë e anketuar në një pjesë të madhe të përgjigjeve njohin dhe vënë në dukje apatinë rinore politiko-sociale, e cila ishte problemi kryesor në analizë. Në këtë drejtim, sipas tyre, apatia e tillë është për shkak të ekzistencës së ndjenjës së mungesës⁹⁹ së shpresës tek të rinjtë, sipas së cilës asnjë angazhim social i të rinjve nuk do të japë rezultate. Kjo, nga ana tjetër, si efekt përfundimtar ka efektin e dekurajimit të mëtejshëm të përfshirjes së të rinjve në proceset politike dhe sociale në nivel lokal si dhe një shkallë shqetësuese të lartë mosbesimi ndaj institucioneve shtetërore.

PERCEPTIMET E TË RINJVE PËR ZGJIDHJET ADEKUATE

Perceptimet e të rinjve për zgjidhjet adekuate mund të paraqiten sipas rendit të mëposhtëm:

- Ndërgjegjësim më i lartë shoqëror;
- Meritokracia⁹⁹;
- Përfshirja në institucionet shtetërore;
- Programe të shumta kulturore si dhe
- Largimi nga shteti.

Perceptimet e të rinjve për zgjidhjet adekuate trajtojnë kryesisht çështjen e ndërgjegjësimit për proceset politike dhe shtetërore. Njëkohësisht, të anketuarit përmendin meritokracinë si zgjidhje për papunësinë, si dhe për të rritur shanset për sukses kundër punësimeve partiake, lidhjeve dhe nepotizmit.

Përfshirjen në institucionet shtetërore, të rinjtë e intervistuar e perceptojnë si:

- interesim më i madh i organeve shtetërore për qytetarët e rinj;
- qasje më e madhe dhe më e drejtpërdrejtë e institucioneve tek të rinjtë;
- ndërgjegjësim më i madh i të rinjve për masat dhe mundësitë rinore;
- hartëzimi më i përshtatshëm i nevojave të të rinjve nga institucionet;
- perspektiva më të mira për ndërmarrjen e një qasjeje strategjike, të qëndrueshme dhe të koordinuar nga të gjitha palët e interesuara;
- rritja e mundësive për punësimin e studentëve më të mirë menjëherë pas diplomimit
- uljen e mëtejshme të moshës së daljes në pension me qëllim që të rinjtë të mund të trashëgojnë të moshuarit pas daljes në pension.

Nisur nga sa më sipër, është shqetësues fakti se një numër i konsiderueshëm i të rinjve që kanë marrë pjesë në hulumtim, besojnë se shpërngulja është zgjidhja e vetme më e mirë për sfidat me të cilat përballen dhe shfaqin skepticizëm të fortë për ekzistencën e mundësive për përmirësim të menjëhershëm të gjendjes së tyre.

⁹⁹ Meritokracia është një sistem menaxhimi ose administrimi (siç është administrimi i biznesit) ku përgjegjësitë u caktohen objektivisht individëve në bazë të "meritave" të tyre (kontributeve), pra në bazë të inteligjencës, aftësisë dhe edukimit të tyre, të cilat përcaktohen përmes vlerësimeve ose testeve. Përkufizimi më i zakonshëm i meritokracisë është merita e konceptuar për sa i përket kompetencës dhe aftësisë së testuar, më së shpeshti përcaktohet nga IQ ose teste të standardizuara. (Shiko Levinson, David, Sadovnik, Ian R., Education and sociology: an encyclopedia, Taylor & Francis, 2002, f. 436).

ALTERNATIVA

Duke pasur parasysh gjithçka që u theksua në pjesët e mëparshme të këtij punimi, imponohen rekomandimet e mëposhtme:

- 1** Rritja e përfshirjes së të rinjve në seancat e këshillit të komunës, veçanërisht kur bëhet fjalë për diskutime për tema që prekin jetën e të rinjve. Në këtë kuptim, organizimi i fushatave publike për njohjen më të mirë të të rinjve me masat dhe politikën, si dhe me mundësitë institucionale, me qëllim rritjen e qasjes dhe përdorimit të duhur;
- 2** Angazhimi i pushtetit lokal dhe qendror për ngritjen e mëtejshme të ndërgjegjësimit social-qytetar tek të rinjtë, me qëllim që ata të jenë më të informuar për përgjegjësinë personale, si dhe për mundësitë në drejtim të avancimit të mundësive të përbashkëta shoqërore;
- 3** Rrjetëzimi i drejtpërdrejtë i institucioneve për çështje zyrtare të natyrës së njëjtë ose të ngjashme, pa krijuar ndërmjetësues institucionalë plotësues;
- 4** Krijimi i mekanizmave të duhur elektorale dhe të tjerë për eliminimin ose minimizimin e ndikimeve partiako-politike në zgjedhjen e përfaqësuesve të të rinjve në organizatat universitare;
- 5** Rritja e numrit dhe cilësisë së analizave lidhur me sfidat dhe perceptimet rinore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të statusit të të rinjve në vend;
- 6** Lirim i plotë nga tarifat e shkollimit për studentët që do të obligohen mos largohen nga vendi dhjetë vjet pas diplomimit, si instrument për parandalimin e emigracionit.

BIBLIOGRAFIA

- Guidelines for successful e-participation by young people, IJAB, 2014;
- Levinson, David, Sadovnik, Ian R., Education and sociology: an encyclopedia, Taylor & Francis, 2002;
- Martin S., Pittman K., Ferber T., McMahon A., Building effective youth councils a practical guide to engaging youth in policy making, Forum for Youth Investment, July 2007;
- Përfaqësimi i bazuar në të dhëna, Instituti për Shkenca Sociale dhe Humane - Shkup, 2016;
- Zoran Ilievski, Manual mbi Politikat Rinore, Pjesëmarrjen dhe përfaqësimin, Fondacioni "Shërbim Sipërmarrës për të rinjtë": <https://bit.ly/2PA80LU>;
- Ivanoska Krstevska M., Gajtanoski T., Manual për pjesëmarrjen e të rinjve, Koalicioni i Organizatave Rinore SEGA, Mars 2010;
- Ilieski Z., Ivanoska Krstevska M., Gajtanoski T., Markovska E., Nashkovska M., Spasenovski D., Manual për krijimin e strategjive lokale rinore, Koalicioni i Organizatave Rinore SEGA, Mars 2010;
- Ilieski Z., Ivanoska Krstevska M., Gajtanoski T., Manual për përfaqësim dhe lobim, Shoqata për edukim Youth Info International, Shkup, shtator 2014;
- Thoni mendimin tuaj, Manual mbi Kartën Evropiane të rishikuar për pjesëmarrjen e të rinjve në jetën lokale dhe rajonale, Këshilli i Evropës, nëntor 2015;
- Faqja zyrtare e Agjencisë për Rini dhe Sport: ams.gov.mk;
- Faqja zyrtare e Komunës Qendër: centar.gov.mk;
- Faqja zyrtare e Kuvendit: sobranie.mk;
- Savo Klimovski, Tanja Karakamisheva, Aleksandar Spasenovski, Partitë politike dhe grupet e interesit, Fakulteti Juridik "Justiniani I", Fondacioni Konrad Adenauer, 2016.

A photograph of a duck in a stream. The water is dark and reflects the surrounding environment. There is a significant amount of plastic waste, including bottles and bags, floating in the water and along the banks. The duck is white with a black cap and a yellow beak, looking towards the right. The background shows some green foliage and a small boat.

LUMENJ TË PASTËR PËR SHËNDET MË TË MIRË

Masat dhe politikat e propozuara

- Rijad Fetaji



REZYME

Uji i pastër është jetik për shëndetin dhe ekonominë tonë. Prodhimi, bujqësia, turizmi, rekreacioni dhe sektorët e tjerë ekonomikë kanë nevojë për ujë të pastër për të funksionuar dhe për t'u zhvilluar. Mirëpo, ruajtja e ambientit në të cilin jetojmë është bërë një nga sfidat më të ndjeshme për shumë vendbanime në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e kjo kryesisht ndodh për shkak të mosrespektimit të ligjeve që kanë të bëjnë me ruajtjen e ambientit, vetëdijen e ulët të qytetarëve për pasojat nga ndotja, si dhe mangësitë në funksionimin e ndërmarrjeve publike komunale në mënjanimin dhe parandalimin e ndotjeve.

Ndonëse hedhja e mbetjeve në natyrë dhe lumenj përbën rrezik për përhapjen e sëmundjeve të ndryshme të banorët dhe dëmtimin e rëndë të kulturave që ujitën nga uji i lumenjve, për shkak të pasivitetit të institucioneve publike që kanë autoritetin për të zgjidhur problemin, praktika të tilla vazhdojnë. Për më tepër, këtë problem duhet ta marrin shumë më seriozisht autoritetet lokale dhe komuniteti lokal, sepse me përqendrim më të madh të mbetjeve në shtratin e lumit krijohet rrezik për përmytje në rast të reshjeve dhe raste të tilla kemi pasur edhe në të kaluarën tek ne dhe në vendet fqinje. Kjo do të thotë se pozicioni specifik gjeografik dhe kushtet natyrore në vend, së bashku me ndërëgjësimin e pamjaftueshëm të qytetarëve dhe pasivitetin e autoriteteve mund të çojnë në fatkeqësi të rënda natyrore.

Nga ana tjetër, nëse shihet në një dimension tjetër më afatgjatë, mbeturinat e hedhura në lum kanë potencialin më të madh për të dëmtuar mjedisin, tokën pjellore dhe prodhimet bujqësore. Ndotja e tokës është problemi numër një i shkaktuar nga depozitimi dhe deponimi jo i duhur i mbeturinave. Disa deponi përfundojnë duke lëshuar kimikate të rrezikshme që depërtojnë në tokë. Si shembull mund të marrim rastin e shisheve plastike, të cilat në procesin e dekompozimit të tyre çlirojnë një përbërje kancerogjene që ndikon drejtpërdrejt në shëndetin tonë. Ndotja e tokës jo vetëm që ndikon në rritjen e bimëve, por është gjithashtu e pashëndetshme për njerëzit dhe kafshët që ushqehen me ato bimë.

Për më tepër, banorët pranë këtyre deponive janë të ekspozuar në rrezik të infeksioneve të mundshme të padëshiruara, si dhe të problemeve shëndetësore afatgjata. Masat e ndërmarra nga autoritetet lokale si dhe nga Ministria e ambientit dhe planifikimit hapësinor për pastrimin e lumit nga mbeturinat nuk kanë mjaftuar për të ngritur vetëdijen tek banorët që kjo dukuri të mos përsëritet. Për më tepër, mosndëshkimi i ndotësve dhe mos gjetja e zgjidhjeve afatgjata le vend për të diskutuar alternativa tjera të cilat ndoshta mund të tregohen të jenë edhe më efikase.

Në këtë dimension, në bazë të analizave do të ofrojmë disa zgjidhje afatshkurte dhe afatgjate, të cilat mendojmë se do të japin një shtytje pozitive në drejtim të përmirësimit të problematikës së parashtruar. Këtu kryesisht e kemi fjalën për gjetjen e një modusi për edukim permanent dhe profesional të popullatës mbi rreziqet shumëdimensionale të cilat paraqiten si rezultat i ndotjes së shtratit të lumit, dëmtimit të kulturave bujqësore. Gjithashtu do të paraqesim edhe çështjen për rivlerësimin e dënimeve të shqiptuara ndaj shkelësve dhe ndotësve të ambientit dhe gjetjen e një modusi tjetër më efikas, duke aplikuar dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjë e cila mund të kontribuojë në zvogëlimin e numrit të shkelësve dhe ndotësve.

Të dhënat e paraqitura në këtë punim, të cilat kryesisht janë mbledhur dhe analizuar gjatë zbatimit të iniciativës me titull “Lumenj të pastër për shëndet më të mirë”, do të përdoren për të krijuar politika publike që synojnë parandalimin e këtyre dukurive devijuese të rrezikshme për shëndetin dhe ekonominë e vendit tonë. Gjithashtu, nga analiza e të dhënave do të jepen edhe rekomandime për avancimin dhe krijimin e politikave të reja publike mbi ruajtjen e lumit dhe menaxhimin me mbeturinat. Duke pasur parasysh rolin jetik të ujit dhe ambientit të pastër në të gjitha aspektet e jetës sonë, një qasje më e integruar e politikave do të na ndihmojë të mbrojmë dhe ruajmë fillimisht shëndetin, por edhe vendin në të cilin jetojmë.

KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Shtrati i lumit Kumanovka i cili kalon nëpër vendbanimin e Likovës në disa vende është i stërm bushur me mbeturina dhe degë kullosash të cilët në kohë të reshjeve mund të përbëjnë një rrezik për vendbanimet përreth. Toka e grumbulluar, zhavorri, paketimi plastik dhe lloje të tjera të mbeturinave shihen kudo. Kjo ndodh për shkak të qytetarëve të pandërgjegjshëm, të cilët mbeturinat e veta shtëpiake i hedhin në lum, duke mos e ditur për pasojat të cilat mund të ndodhin më tej për pronën e tyre, si dhe në lidhje me shëndetin e tyre.

Për më tepër, përveç qytetarëve dhe ndërmarrje të ndryshme private i hedhin materialin e tyre të panevojshme në lum (si p.sh. materiale ndërtimore, kimikale të ndryshme, etj.), duke rrezikuar kështu edhe rrjedhën e lirshme të ujit, por në të njëjtën kohë edhe ambientin.

Një problem tjetër që lajmërohet, e që nuk është shumë i diskutuar janë pasojat afat-shkurte dhe afat-gjate nga hedhja e mbeturinave në shtratin e lumit Kumanovka mbi prodhimet bujqësore. Pasi që në të shumtën e rasteve tokat e punuara në vendbanimin e fshatit Likovë ujiten me ujin e lumit Kumanovka, mund të ndodh që kimikali të liruara nga hedhjet e mbeturinave në lum të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në shëndetin e njerëzve të cilët konsumojnë produktet bujqësore. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe me bagëtinë e cila furnizohet me ujë nga i njëjti lum.

Në bazë të monitorimit në terren, lumi i këtij fshati vazhdon të jetë i ndotur dhe i degraduar nga ndikimi i faktorit njeri. Kjo është dokumentuar edhe me fotografi të shumta të bëra të cilat tregojnë papërgjegjshmërinë e banorëve në aspektin e hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave.

Po ashtu, nga identifikimi i këtyre pikave të ndotjes vlen të theksohet se tek lagjet e banuara kemi ndotje më të theksuar të lumit, ku behet hedhja e pa kontrolluar e mbeturinave nga ana e banorëve, sidomos mbeturina organike nga mbetjet ushqimore. Është e qartë se banorët nuk janë të vetëdijshëm për lumenjtë e pastër dhe rreziqet nga ndotja e lumenjve, sepse ujërat e këtij lumi ujitin shumë kultura në pjesën fushore të fshatit. Ndotja e lumenjve rezulton në ndotje të produkteve bujqësore.

Krahas inspektimit në terem gjithashtu edhe bëmë intervistë me një pjesë të banorëve të fshatit nga ku mësuam se momentalisht në fshatin tonë mbledhja e mbeturinave bëhet nga ndërmarrja publike "Pisha" e cila bën mbledhjen e mbeturinave vetëm tek ata shtëpi që e paguajnë taksën për mbledhjen e mbeturinave. Nga biseda kemi marrë informacion se vetëm një pjesë e vogël e shtëpive kanë nënshkruar kontratë për grumbullimin e mbeturinave. Por banorët e shumë shtëpive që ndodhen përreth lumenjve nuk kanë kontratë me ndërmarrjen dhe mbetjet e tyre nuk grumbullohen.

Nga kjo mund të themi se ndotja e lumit të fshatit kryesisht vjen nga shtëpitë që jetojnë rreth lumenjve dhe nga shtëpitë që nuk kanë lidhur kontratë me ndërmarrjen publike për mbledhjen e mbeturinave. Kjo përbën një çështje tejet serioze e cila duhet të shqyrtohet nga autoritetet lokale dhe të gjendet një zgjidhje afatgjate për banorët në lagjet e apostrofuara, sidomos me ata amvisëri të cilët nuk kanë lidhur kontratë me ndërmarrjen publike për mbledhjen e mbeturinave.

Nga na tjetër, derdhja e ujërave të zeza në lumin e fshatit është si pasojë e mungesës së kanalizimit në fshat. Ujërat e zeza janë një rrezik i madh për shëndetin tonë për shumë arsye sepse ato janë shkaktarë të përhapjes së shumë sëmundjeve infektive. Fekalet e njerëzve dhe kafshëve të infektuara me patogjenë të ndryshëm si baktere, viruse, organizma të tjerë parazitare, nëse bien në kontakt me burimet e ujit të pijshëm ose tokën, mund të shkaktojnë pasojë të rënda për shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe kafshëve. Në kuadër të pyetësorit të realizuar dhe analizave të rezultateve të cilat janë përfituar nga instrument standard për detektimin e faktorëve, motiveve dhe shkaqeve të ndotjes së lumit në fshatin Hotël të qytetit të Kumanovës u gjet se:

- ndotja e lumit vjen si pasojë e mungesës së kontejnerëve,
- nuk ka kujdes të duhur për pastërtinë e lumit,
- autoritetet vendore nuk marrin masat dhe aktivitetet e duhura për mbrojtjen e lumit, mjedisit dhe shëndetit të banorëve.
- ndërmarrja përgjegjëse për pastrimin e mbetjeve nuk kujdeset sa duhet për mjedisin dhe as nuk mbledh të gjitha mbetjet,
- banorët nuk shfaqin interes për mbrojtjen e natyrës, e me këtë edhe ruajtjen e shëndetit.

Duke vlerësuar faktorët përkatës që ishin përfshirë më parë në treguesit e instrumentit matës (pyetësor) për të testuar praninë e tyre, të anketuarit treguan se çfarë do të bënin për të ndryshuar gjendjen aktuale të ndotjes së lumenjve. Si një faktor të rëndësishëm, ata theksuan nevojën e ndëshkimit të rregullt të ndotësve të shtratit të lumit, fushatë edukative për banorët për mirëmbajtjen e lumit, si dhe vendosjen e koshave të plehrave përreth lumit dhe në fshat, si dhe krijimin e aktiviteteve sportive përreth lumit.

ALTERNATIVA - ZGJIDHJE

Në bazë të të dhënave të prezantuara më sipër, shihet qartë se për të arritur deri në zgjidhjen e problemit të parashtruar, duhet të merren parasysh disa aktivitete paralele në të njëjtën kohë. Për këto arsye duhet të bëhet pastrimi i shtratit të lumit në Likovë, me çka do të pastrohen të gjitha ato vende që paraqesin pengesa në shtratin e lumit, si dhe vendet përgjatë lumit që keqpërdoren si deponi ilegale.

Qytetarët duhet të sensibilizohen edhe për nevojën e ruajtjes së mjedisit. Është veçanërisht e rëndësishme që të gjithë të jenë të vetëdijshëm për rreziqet që mund të lindin nga ndotja dhe hedhja e mbeturinave në shtratin e lumit, si shkaktimi i përmbytjeve dhe ndotja e produkteve bujqësore dhe helmimi i bagëtive. Për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, edukimi i të gjitha brezave është i domosdoshëm për rritjen e ndërgjegjësimit.

Për ta arritur këtë duhet fillimisht të bëhen matjet dhe analizat e duhura nga ana e ekspertëve të fushës së higjienës, të cilët do të bëjnë analiza të ujit dhe llojit të mbeturinave, e më pastaj do të shpjegojnë përmes kontakteve me qytetarë pasojat e hedhjes së mbeturinave për shëndetin e njerëzve dhe bagëtisë, duke paraqitur në të njëjtën kohë gjetjet nga analizat e bëra. Në këtë mënyrë, informacioni do t'u transmetohet banorëve përmes prezantimit të drejtpërdrejtë të pasojave shëndetësore dhe do të jepen rekomandime për të rritur ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit.

Edukimi shëndetësor është një masë e përgjithshme për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit. Ky edukim duhet të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme, si masë parandaluese. Qëllimi kryesor i edukimit shëndetësor është edukimi i individëve apo grupeve dhe ngritja e nivelit të përgjegjësive së çdo individi për shëndetin e tij, për shëndetin e familjes dhe për shoqërinë e gjerë. Qëllimi i punës edukative dhe shëndetësore është që popullata të pranojë dhe praktikojë parimet e jetesës së shëndetshme, për përdorimin e arsyeshëm dhe në kohë të masave të mbrojtjes së shëndetit, për të dhënë kontribut individual dhe kolektiv në promovimin e shëndetit të tyre dhe higjienën e mjedisit të jashtëm.

Nga aspekti i abuzuesve dhe ndotësve, autoritetet lokale përveç identifikimit dhe shqiptimit të gjobave në para, duhet të mendojnë në ndryshimin e dispozitave ligjore dhe të mendojnë për aplikimin e dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Sipas kësaj parashihet që personi i dënuar të kryej punë në dobi të përgjithshme dhe pa pagesë duke bërë mbledhjen e mbeturinave përgjatë shtratit të lumit. Me aplikimin e dënimit të tillë, konsiderohet se në një rën anë do të fitojë shoqëria, ku në rastin e cekur do të bëhet largimi i mbeturinave nga shtrati i lumit, por në anën tjetër nga ushtrimi i këtyre punëve do të fitojë edhe subjekti i ndëshkuar, ku synimet orientohen¹³sidomos në riedukimin e tij, krijimin e shprehive përkatëse të punës si dhe aftësimin e tij në ndonjë profesion.

Sipas hulumtimeve të realizuara nga Ministria e Drejtësisë në Mbretërinë e Bashkuar, duke krahasuar shkelësit e ngjashëm dhe veprat e ngjashme, të dhënat tregojnë se dënimet me punë në dobi të përgjithshme në bashkësi janë për 8.3 % më efektive në uljen e normave të përsëritjes së veprës, krahasuar me llojet tjera të dënimeve.

REKOMANDIME DHE AKTIVITETE

Në bazë të të dhënave të prezantuara, analizave dhe pyetësorit të realizuar në teren me banorët, rezulton se hapat të cilat duhet ndërmarrë nga ana e autoriteteve lokale janë si në vijim:

- 1 Ndëshkimi i personave që ndotin lumin;
- 2 Mirëmbajtja e rregullt e shtratit të lumit nga ndërmarrja komunale;
- 3 Trajnime edukative për banorët rreth mirëmbajtjes së lumit;
- 4 Vendosja e kontejnerëve për mbeturina;
- 5 Krijimi i aktiviteteve sportive rreth lumit.

Për të arritur deri tek rezultatet e dëshiruara, në një periudhë kohore sa më të shkurtër duhet të bëhet koordinimi i institucioneve relevante (bashkësia lokale, ndërmarrja publike komunale, komuna, ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor, si dhe autoritetet mjekësore), që të analizojnë gjetjet dhe të dhënat e grumbulluara, të paraqesin plan për pastrim të vazhdueshëm, të planifikojnë edukim paralel të popullatës, si dhe të shqyrtohet mundësia e aplikimit të dënimit me punë në dobi të përgjithshme në bashkësi, gjë e cila mund të rezultojë si një mekanizëm për zvogëlimin e numrit të shkelësve dhe ndotësve të ambientit. Në këtë mënyrë do të vihen në lëvizje një numër i madh i institucioneve dhe do të përfshihen një numër i madh i banorëve, me ç'rast do të bëhet sensibilizimi i kësaj problematike, do të diskutohen zgjidhjet e mundshme dhe do të shkohet në drejtim të duhur drejt eliminimit të ndotjes së lumit nga ana e banorëve.

BIBLIOGRAFIA

- Prof. dr. Nevzat Elezi – Mjekësi sociale, Botimi II, Tetovë 2020
- Ligji për Veprimtaritë Komunale, <https://www.khigiena.com.mk/stored/document/LIGJ%20PER%20VEPRIMTARI%20KOMUNALE.pdf>
- Ligji për menaxhim me mbetjet, neni 142a, <https://www.moepp.gov.mk/wp-content/uploads/2014/09/Zakon%20za%20upravuvanje%20so%20otpad%20-%20precisten%20tekst%20za%20informativni%20celi.pdf>
- М-р Тамара Витларова, АЛТЕРНАТИВНАТА МЕРКА-ОПШТОКОРИСНА РАБОТА ВО КАЗНЕНОПРАВНИОТ СИСТЕМ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА, <http://www.makcl.mk/Upload/Documents/Vitlarova%20Tamara.pdf>
- Prison Reform Trust response to the Ministry of Justice consultation, Punishment and reform: effective community sentences <http://www.prisonreformtrust.org.uk/Portals/0/Documents/effective%20community%20sentences.pdf>

KOHË MODERNE, PROBLEME TË VJETRA

INFRASTRUKTURA RRUGORE JOP-
ËRKATËSE KAMENOLOM
BEROVIÇ- fshati PATISHKA REKA

- Sinan Vejselovski



PATISHKA REKA

"Модерни времиња, стари проблеми"

REZYME

Problemi që është subjekt i interesit në këtë dokument të politikave publike është mungesa e infrastrukturës rrugore adekuate në guroren Beroviç-Patishka Reka në komunën e Sopishtës. Edhe pse ka pasur të paktën një iniciativë për rehabilitimin e rrugës më parë, ajo është e pjesshme dhe përfshin gjatësi shumë të shkurtër të rrugës. Gjithashtu, deri më tani nuk është bërë studim gjithëpërfshirës i problemit dhe propozim për një zgjidhje të qëndrueshme. Sipas vlerësimit paraparak të mjeteve të nevojshme financiare, pjesë e studimit, për rindërtimin e rrugës në guroren Beroviç- Patishka Reka në komunën e Sopishtës do të duhen 180.329.075,00 denarë (gati 3 milionë euro). Duke pasur parasysh se mundësitë buxhetore të komunës së Sopishtes nuk janë të mjaftueshme, për rikonstruktimin e përmendur në këtë dokument janë përcaktuar tre mekanizma për financimin e projekteve infrastrukturë nga komunat, të cilat mund të jenë me interes për komunën e Sopishtës: programi shtetëror për mbështetjen financiare të zhvillimit rural, programi IPARD në kuadër të ndihmës së para-aderimit e Bashkimit Evropian dhe projekti Lidhja me rrugët lokale", i mbështetur nga Banka Botërore.

METODOLOGJIA

Për qëllimet e këtij dokumenti të politikave publike, u përdorën mjete të ndryshme të mbledhjes së të dhënave:

- **Është kryer vlerësimi i investimit financiar të kërkuar për rinovimin e rrugës, në kuadër të së cilës është kryer një matje në terren.**
- **Është kryer hartëzimi i instrumenteve financiare të cilat janë në dispozicion të qeverisjes lokale, me qëllim financimin e qëndrueshëm të një projekti të kësaj madhësie (hua, grante, vetëfinancim, etj.). Në kuadër të përcaktimit, janë realizuar takime me përfaqësues të Agjencisë për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural, kabinetit të ministrit për Transport dhe Lidhje dhe përfaqësues të EVN Maqedoni KEC Shkup Aerodrom.**
- **U mbajt një takim me kryetarin e komunës së Sopishtes Z. Stefçe Trkovski ku paraqitet koncepti dhe diskutohen mundësitë për realizimin e kësaj ndërhyrjeje.**
- **Janë kryer intervista/grupe fokusi me banorë nga fshatrat Patishka Reka dhe Drzhilovë, për të hulumtuar nevojën dhe justifikimin e një ndërhyrjeje të tillë, si dhe mënyrat e preferuara të financimit.**

VLERSIMI TEKNIK I NEVOJËS PËR RIKONSTRUKTIM DHE ZGJERIM TË AKSIT RRUGOR GURORJA BEROVIÇ-PATISHKA REKA

Për nevojat e këtij dokumenti, është kryer një "Studim për nevojat e një initiative novatore për rindërtimin dhe zgjerimin e rrugës komunale nga kryqëzimi i rrugës rajonale R1106 (Shkup-Makedonski Brod) në fshatin Patishka Reka, seksioni Gurorja Beroviç-Patishka Reka".¹⁰⁰

¹⁰⁰ INT Global Engineering AV SHPKNJP Manastir, "Studim për nevojat e një initiative novatore për rindërtimin dhe zgjerimin e rrugës komunale nga kryqëzimi i rrugës rajonale R1106 (Shkup-Makedonski Brod) në fshatin Patishka Reka, seksioni Gurorja Beroviç-Patishka Reka" (2021).

Studimi tregon se aksi rrugor është i karakterit lokal dhe gjendet në komunën e Sopishtes, me gjatësi totale prej 16 km. Rruga që është qëllimi i kësaj nisme është 14.7 km e gjatë, nga gurorja e kompanisë Beroviç deri në hyrje të fshatit Patishka Reka. Rruga është përgjatë lumit Suva Reka, deri në bashkimin e lumit Prisojna dhe lumit Patishka, dhe nga këtu përgjatë lumit Patishka deri në hyrje të fshatit.

Sipas llojit të trafikut, rruga është në kategorinë e rrugëve për trafik të përzier. Kjo do të thotë që në këtë rrugë, përveç lëvizjes së automjeteve, është menduar për të gjitha llojet e automjeteve, si dhe për pjesëmarrësit e tjerë në trafik (automjete motorike dhe parzmore, automjete pune, biçikleta, këmbësorë, kafshë shtëpiake, etj.). Rruga që është objekt i kësaj analize lidhet me rrugën komunale për në fshatin Drzhilovë, si dhe me fshatin Jabolce.

Rëndësia e këtij aksi rrugor shihet në mundësinë që me rindërtimin dhe zgjerimin e saj, popullsisë lokale t'i mundësohet komunikim më i mirë ditor.

VLERSIMI I INVESTIMIT TE NEVOJSHËM

Sipas një vlerësimi paraprak të mjeteve financiare të nevojshme, për rindërtimin e rrugës do të nevojiten gati 3 milionë euro. Është bashkangjitur pasqyrë e shpenzimeve kryesore të prishme. Periudha e zbatimit vlerësohet në 18 muaj.

	Количина	Цена по единица	Вкупно
Изработка на студија за потреби на апликацијата	1	80.000,00	80.000,00
Студија за извор на финасиски инструменти, кампања, анкети, јавна презентација и промоција на иновацијата	1	120000	120.000,00
Геодетско снимање и изработка на ажурирана геодетска подлога.	14	14.000,00	196.000,00
Геомеханички испитувања и изработка на геомеханички елаборат	14	45000	630.000,00
Собирање на потребни согласности	1	100.000,00	100.000,00
Изработка на основен градежен проект	14	120000	1.680.000,00
Изработка на основен сообраќаен проект	14	30.000,00	420.000,00
Изработка на елаборат за животна средина	14	12000	168.000,00
Ревизија на сите проекти	14	35.000,00	490.000,00
Мислења и одобрувања од надлежни институции за проектите	1	100000	100.000,00
Изградба на патниот правец Делница 1, цена зголемена за 25% за неопфатени работи 1.25%*6.750.000	1	8.437.500,00	8.437.500,00
Изградба на патниот правец Делница 2, цена зголемена за 25% за неопфатени работи 1.25%*35.740.000	1	44.675.000,00	44.675.000,00
Изградба на патниот правец Делница 3, цена зголемена за 25% за неопфатени работи 1.25%*73.007.000	1	91.258.750,00	91.258.750,00
Доградба на постоечки цеваст пропуст со сите потребни елементи	2	350.000,00	700.000,00
Изградба на нов цеваст пропуст со сите потребни елементи	1	725.000,00	725.000,00
Надзор на изградба на патниот правец	14	210.000,00	2.940.000,00
Прелиминарен технички прием	1	45.000,00	45.000,00
Технички прием и пуштање во употреба	1	60.000,00	60.000,00
Вкупно			152.821.250,00
ДДВ 18%			27.507.825,00
Вкупно со ДДВ			180.329.075,00

HARTA E INSTRUMENTEVE FINANCIARE PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE INFRASTRUKTURE NË KOMUNAT

Zonat rurale përballen me sfida të rëndësishme si migrimi i popullsisë dhe mungesa e mundësive ekonomike. Infrastruktura e mirë (rrugët, furnizimi me ujë, kanalizimet, sistemet e parandalimit të përmytjeve, etj.) ndihmon në forcimin e rritjes ekonomike dhe rritjen e atraktivitetit të zonave rurale.

Megjithatë, zbatimi i projekteve kryesore të infrastrukturës, përfshirë mirëmbajtjen dhe funksionimin e tyre të duhur është dhe do të mbetet një sfidë e madhe për shtetin, dhe veçanërisht për komunat. Në bashkëngjitje është dhënë një pasqyrë konceptuale e mekanizmave të ndryshëm në dispozicion për të financuar këtë lloj ndërhyrjeje.

KATEGORIJA	МЕХАНИЗАМ ЗА ФИНАНСИРАЊЕ	КАРАКТЕРИСТИКИ
Даноци за сите намени	Општи даноци	Се наплатуваат плати, набавка на стоки и услуги, приходи на компаниите итн. Генерално наменети за да го хранат Генералниот буџет на Владата, но во некои земји наменети за одредени фондови за патишта.
Даноци и казни за корисници на патишта од специјална намена	Даноци на возила	Плаќања по возило на еднократно и на годишно ниво. Варијабилно плаќање во зависност од karakteristikите на возилото. Овие даноци може да се наплатат при набавка и / или при периодично испитување на возилото или лиценцирање на возилото за употреба на пат.
	Даноци на гориво	Плаќања применети на нафтените производи и дизел производи што ги троши возилото.
	Зелени даноци	Наплатата зависи од оддалеченоста на возилото и/или karakteristikите на емисиите на загадувачи.
Наплата на трошоците за развој (фаќање вредност)	Придонес за пристап до комерцијалните области	Плаќања наметнати на нови комерцијални области каде што е развиена инфраструктурата.
	Придонес за урбан развој	Плаќања наметнати на општини или нови жители каде што е развиена инфраструктурата.
Финансирање на грант		Средства што не се враќаат исплатени од една страна. Има за цел зајакнување на економската и социјалната кохезија со коригирање на нерамнотежата помеѓу различните земји или нејзините региони.
Приватни донации		Поединци, организации или деловни активности можат да помогнат во одржување на патиштата, имајќи можност да учествуваат како волонтери или да ангажираат давател на услуги за одржување да ја извршува работата во нивно име.
Хибридни механизми за финансирање		На пример, субвенционирани патишта, делумно доделено финансирање, итн.

Mekanizmat specifikë për financimin e projekteve të infrastrukturës nga komunat janë tre në vijim: programi shtetëror për mbështetjen financiare të zhvillimit rural, programi IPARD në kuadër të ndihmës së para-aderimit në Bashkimin Evropian dhe projekti "Lidhja e rrugëve lokale" i mbështetur nga Banka Botërore.

PROGRAMI VJETOR SHTETËROR PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË ZHVILLIMIT RURAL 2021

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, Qeveria miraton program kombëtar trevjeçar për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, për një periudhë prej 3 deri në pesë vjet. Në nivel vjetor miratohet program për mbështetjen financiare të zhvillimit rural për zbatimin e programit kombëtar.

Në programin e këtij viti për mbështetjen financiare të zhvillimit rural parashikohen 3 masa, të cilat lejojnë projekte infrastrukturore:

- Masa 321 Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale (250.000.000 denarë)

Komunat në zonat rurale mund të aplikojnë për investime në infrastrukturën rrugore lokale (përfshirë urat) për të lidhur fshatrat me një rrugë rajonale ose me një vendbanim-çytet deri në gjatësi prej 7 km.

- Masa 322 Rindërtimi dhe zhvillimi i fshatrave (90.000.000 denarë)

Komunat në zonat rurale mund të aplikojnë për mbështetje të pakthyeshme sipas kësaj mase, e cila i referohet investimeve në ndërtimin dhe/ose rindërtimin e rrugëve rurale (përfshirë kanalizimet atmosferike dhe elementët e këmbësorëve) në gjatësinë prej 1 km.

- Masa 323 Ruajtja dhe promovimi i vlerave tradicionale (140.000.000 denarë)

Dhe në kuadër të kësaj mase, komunat nga zonat rurale mund të aplikojnë për infrastrukturën rrugore lokale (përfshirë urat) për të lidhur vendbanimet-fshatra me lokalitete me rëndësi për mënyrën e jetesës dhe punës së popullsisë rurale në gjatësinë prej 2 km.

Thirrjet publike për pagesën e fondeve në mbështetje të këtyre 3 masave për vitin 2021 ende nuk janë shpallur.¹⁰¹ Kjo lë hapësirë për shpalljen e thirrjeve adekuate gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, komuna e Sopishtes për të aplikuar për mbështetje.

PROGRAMI IPARD NË KUADËR TË NDIHMËS PARA-ADERUESE E BASHKIMIT EVROPIAN

Maqedonia e Veriut, si vend kandidat për aderim në Bashkimin Evropian, ka të drejtë të përdorë ndihmën e para-aderimit të BE-së, përmes Instrumentit për Ndhmën e Para-aderimit (IPA). Në kuadër IPA-s, ekziston një Instrument specifik për ndihmën e para-aderimit për zhvillimin rural (IPARD), i cili ka dy objektiva, domethënë të ndihmojë sektorin rural të vendit kandidat të bëhet më i qëndrueshëm dhe ta përafrojë atë me politikën e përbashkët të BE-së për Bujqësinë. Përfituesit aktualë të mbështetjes IPARD janë Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia. Për periudhën 2014-2020 IPARD II ka buxhet tregues prej 3.3 miliardë eurosh, nga të cilat 60 milionë euro në përgjithësi sigurohen për shtetin tonë.¹⁰² IPARD III aktualisht është duke u përgatitur për periudhën 2021-2027.¹⁰³

Programi IPARD në secilin vend është planifikuar bazuar në masa specifike. Pra, për periudhën 2014-2020, IPARD në vendin tonë kishte siguruar pesë masa mbështetëse, ndër të cilat njëra është investimi në infrastrukturën publike rurale.¹⁰⁴

101 Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Zhvillimi Rural 2021, Thirrje. Në dispozicion në: <http://www.ipardpa.gov.mk/> [Qasur më 13.8.2021]

102 Komisioni Evropian, Vështrim i përgjithshëm i asistencës së BE-së për para-aderimit për zhvillimin rural (IPARD). Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/info/food-farming-fisheries/farming/international-cooperation/enlargement/pre-accession-assistance/overview_en [Qasur më 13.8.2021]

103 Trupi Drejtues i IPARD, Takimi i Shtatë i Komitetit të Monitorimit të IPARD II: Përgatitja e Programit IPARD 2021-2027. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3m1mxhq>. [Qasur më 13.8.2021]

104 Qeveria, Programi për përdorimin e fondeve nga Instrumenti i BE-së për Asistencën e Para-Aderimit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020-IPARD II, Gazeta Zyrtare nr. 177/2016.

Komunat me jo më shumë se 10.000 banorë kanë të drejtë të aplikojnë për këtë lloj mbështetje. Komuna e Sopishtes është pjesë e shtojcës me zonat rurale që kualifikohen për këtë mbështetje: Barovë, Govrlevo, Sonje e Epërme, Sonje e Poshtme, Drzhilovo, Jabolci, Nova Breznica, Patishka Reka, Rakotinci Sveta Petka, Sopishte dhe Çiflik.

Një lloj investimi i përshtatshëm janë rrugët, përkatësisht, ndërtimi/rehabilitimi i rrugëve dhe urave ekzistuese komunale (për shembull, rrugët që lidhin vendbanimet me rrugët kryesore, lidhjet midis vendbanimeve, rrugët publike të qasjes në biznese, fermat, objekte turistike, ndërtesa ose zonat të jashtme të zonave lokale, të rëndësishme kulturore, tradicionale ose natyrore, toka bujqësore dhe pyjet, përfshirë rrafshimin, peizazhin dhe ndërtimin/rindërtimin e rrjetit rrugor bujqësor dhe pyjor (përfshirë shtigjet për parandalim të zjarrit).

Mënyra për të vendosur se cilat aplikacione do të mbështeten është përmes një sistemi pikësh. Prioriteti më i lartë i jepet rrugëve (50 pikë) në lidhje me llojet e tjera të investimeve (midis 20 dhe 45 pikë për menaxhimin e ujit dhe kanalizimeve, mbeturinat, furnizimin me energji, investimet për rindërtimin rural, etj.). Më së shumtë (30 pikë) mund t'i jepen një komune me 10.000 banorë në regjistrimin e fundit (midis 15 dhe 20 pikë komunave me më shumë banorë). Pika shtesë mund të merren nëse bëhet fjalë për investimet e vendosura në zonat malore (20 pikë) dhe vendet e popullsisë që janë në një distancë prej më shumë se 50 km nga qendra e komunës (10 pikë).

Sa i përket shumës së mbështetjes, vlera më e ulët e kostove të pranueshme është 10.000 euro, dhe vlera më e lartë për projektet komunale është 3.000.000 euro. Për këto projekte, është parashikuar bashkëfinancim, përkatësisht 75% fonde të BE-së kundrejt 25% të bashkëfinancimit kombëtar.

Nga fondet IPARD për Maqedoninë e Veriut për periudhën 2014-2020 (rreth 60 milionë), pritet që për masën investimet në infrastrukturën publike rurale të synojnë rreth 9.000.000 euro.

Megjithatë, duket se ka një ngadalësim të përdorimit të këtyre fondeve dhe ekziston rreziku që fondet e siguruar për masën e infrastrukturës publike rurale sipas programit IPARD II të humbasin. Sipas informacioneve të disponueshme, masa e investimeve në infrastrukturën publike rurale nga viti 2015 është ende në proces akreditimi.¹⁰⁵

Mund të konkludojmë se deri në miratimin e programit IPARD III dhe akreditimin e duhur të masës së infrastrukturës publike rurale, komuna e Sopishtes nuk mund ta shfrytëzonte këtë mundësi.

PROJEKT "LIDHJA ME RRUGËT LOKALE " MBËSHTETUR NGA BANKA BOTËRORE

Vendi merr hua (IBRD Flexible Loan) në vlerë prej 70 milion euro nga Banka Botërore për zbatimin e projektit "Lidhja me rrugët lokale", i cili synon të rehabilitojë, rindërtojë dhe azhurnojë 450 km rrugë lokale në 80 komuna në vend. Marrëveshja u nënshkrua në vitin 2019 dhe zbatimi pritet të zgjasë deri në vitin 2024.¹⁰⁶

¹⁰⁵ Trupi Menaxhues me IPARD , Masa 6: Investimet në Infrastrukturën Publike Rurale (Në procesin e akreditimit). Në dispozicion në: <https://bit.ly/3seG9Qf>. [Qasur më 13.8.2021]

¹⁰⁶ Loan Agreement (local Roads Connectivity Project) between Republic of North Macedonia and the International Bank for Reconstruction and Development (2019). Në dispozicion në: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/162761577811634815/pdf/Official-Documents-Loan-Agreement-for-Loan-9034-MK-Closing-Package.pdf>. [Qasur më 13.8.2021]

Sipas Qeverisë, në kuadër të Thirrjes së dytë publike për rindërtimin e rrugëve dhe rrugëve lokale të shpallur në Mars 2021, gjithsej 35 rrugë lokale në 21 komuna dhe Qytetin e Shkupit u mbuluan me një gjatësi totale prej 35.5 km dhe një vlerë prej rreth 7 milionë euro. Në fazën e parë, u rindërtuan 27 rrugë në 17 komuna në vlerë prej 4.4 milion euro.¹⁰⁷

Komuna e Sopihtes mund të aplikojë për mbështetje në shpalljen e thirrjes tjetër për rindërtimin e rrugëve dhe rrugëve lokale, në kuadër të projektit "Lidhja me rrugët lokale", mbështetur nga Banka Botërore.

MUNDËSITË E SHFRYTËZUARA PËR FINANCIMIN E RRUGËVE NGA KOMUNA E SOPISHTES

Sipas indikacioneve të kryetarit të komunës, në lidhje me seksionin specifik, janë bërë rindërtimet e mëposhtme:

- Në vitin 2013, u bë rindërtim me gjatësi 2 km;
- Në vitin 2015, u bë kalim, dhe në vitin 2018, u bënë tre kalime shtesë për shkak të lumit.

Ndërhyrja në 2013 është bërë me përdorimin e buxhetit komunal, ndërsa ato në 2015 dhe 2018 janë zbatuar me mbështetjen e Agjencisë për Mbështetjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Për momentin, komuna nuk ka një projekt që mbështetet nga Agjencia, por ka 3 aplikime aktive para Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve për rr.6 fsh. Sonje e Poshtme; rr1 Fsh. Sonje e Epërme; dhe rr.20 fsh. Breznica e re.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Sipas gjetjeve, gjendja e rrugës në guroren Beroviç-Patishka Reka në komunën e Sopihtes është përgjithësisht në gjendje të keqe: pjesë të rrugës janë dëmtuar ndjeshëm dhe me cilësi të ndryshme të asfaltit, është evidentuar grumbullimi i ujërave atmosferike, trotuare të lëna pas dore ose jo ekzistuese, rrëshqitje toke, kthesa me rradhë më të vogla se sa është parashikuar, nuk ka sinjalizim rrugor, etj.

Sipas vlerësimit paraprak të mjeteve të nevojshme financiare, pjesë e studimit, për rindërtimin e rrugës në guroren Beroviç-Patishka Reka në komunën e Sopihtes do të duhen 180.329.075,00 denarë (gati 3 milionë euro). Në lidhje me mundësitë e financimit, duhet të merren parasysh përfundimet e mëposhtme:

- 1 Thirrjet publike për pagesën e fondeve për 3 masa të Programit Vjetor për mbështetjen financiare të zhvillimit rural për vitin 2021, të cilat i referohen investimeve në infrastrukturë nuk janë shpallur ende. Kjo lë hapësirë për shpalljen e thirrjeve adekuate gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, komuna e Sopihtes për të aplikuar për mbështetje.
- 2 Deri në miratimin e programit IPARD III dhe akreditimin e duhur të masës së infrastrukturës publike rurale, komuna e Sopihtes nuk mund ta shfrytëzonte këtë mundësi për financim.
- 3 Komuna e Sopihtes mund të aplikojë për mbështetje në shpalljen e thirrjes tjetër për rindërtimin e rrugëve dhe rrugëve lokale, në kuadër të projektit "Lidhja me rrugët lokale", mbështetur nga Banka Botërore.

¹⁰⁷ Qeveria, Boçvarski: është shpallur thirrje e re publike për rindërtimin e 35 rrugëve lokale në 21 komuna me një vlerë prej rreth 7 milion eurosh (2021). Në dispozicion në: <https://vlada.mk/node/24557>. [Qasur më 13.8.2021]

BIBLIOGRAFIA

- Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Zhvillimi Rural 2021, Thirrje. Në dispozicion në: <http://www.ipardpa.gov.mk/> [Qasur në 13.8.2021]
- Qeveria, Programi për përdorimin e fondeve nga Instrumenti i BE-së për Asistencën e Para-Aderimit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020-IPARD II, Gazeta Zyrtare nr.177/2016.
- Qeveria, Boçvarski: është shpallur një thirrje e re publike për rindërtimin e 35 rrugëve lokale në 21 komuna me një vlerë prej rreth 7 milion eurosh (2021). Në dispozicion në: <https://vlada.mk/node/24557>. [Qasur më 13.8.2021]
- INT Global Engineering AV SHPKNJP Manastir, "Studim për nevojat e një iniciative novatore për rindërtimin dhe zgjerimin e rrugës komunale nga kryqëzimi i rrugës rajonale R1106 (Shkup-Makedonski Brod) në fshatin Patishka Reka, seksioni Gurorja Beroviç-Patishka Reka".
- Komisioni Evropian, Vështrim i përgjithshëm i asistencës së BE-së për para-aderimit për zhvillimin rural (IPARD). Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/info/food-farming-fisheries/farming/international-cooperation/enlargement/pre-accession-assistance/overvi_ew_en [Qasur në 13.8.2021]
- Komiteti për monitorimin e IPARD 2014-2020, Draft Procesverbali nga takimi i dytë i Komitetit për monitorimin e IPARD 2014-2020 (2017). Në dispozicion në: <https://bit.ly/37CpY5W>. [Qasur më 13.8.2021]
- Komiteti për monitorimin e IPARD 2014-2020, Draft Procesverbali nga takimi i tretë i Komitetit për monitorimin e IPARD 2014-2020 (2017). Në dispozicion në: <https://bit.ly/37CITNY>. [Qasur më 13.8.2021]
- Komiteti për monitorimin e IPARD 2014-2020, Draft Procesverbali nga takimi i katërt i Komitetit për monitorimin e IPARD 2014-2020 (2018). Në dispozicion në: <https://bit.ly/2UilRrE> [Qasur më 13.8.2021]
- Komiteti për monitorimin e IPARD 2014-2020, Draft Procesverbali nga takimi i pestë i Komitetit për monitorimin e IPARD 2014-2020 (2019). Në dispozicion në: <https://bit.ly/3CJCezY> [Qasur më 13.8.2021]
- Komiteti për monitorimin e IPARD 2014-2020, Draft Procesverbali nga takimi i gjashtë i Komitetit për monitorimin e IPARD 2014-2020 (2019). Në dispozicion në: <https://bit.ly/3shVmjq> [Qasur më 13.8.2021]
- Komiteti për monitorimin e IPARD 2014-2020, Draft Procesverbali nga takimi i shtatë i Komitetit për monitorimin e IPARD 2014-2020 (2020). Në dispozicion në: <https://bit.ly/3fZOv9Q> [Qasur më 13.8.2021]
- Ministria e Financave, Informacion mbi funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit me IPAR. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3xDMtC4>. [Qasur më 13.8.2021]
- Loan Agreement (local Roads Connectivity Project) between Republic of North Macedonia and the International Bank for Reconstruction and Development (2019). Në dispozicion në: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/162761577811634815/pdf/Official-Documents-Loan-Agreement-for-Loan-9034-MK-Closing-Package.pdf>. [Qasur më 13.8.2021]

- Ministria e Financave, Informacion mbi funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit me IPAR. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3xDMtC4>. [Qasur më 13.8.2021]
- Loan Agreement (local Roads Connectivity Project) between Republic of North Macedonia and the International Bank for Reconstruction and Development (2019). Në dispozicion në: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/162761577811634815/pdf/Official-Documents-Loan-Agreement-for-Loan-9034-MK-Closing-Package.pdf>. [Qasur më 13.8.2021]
- Trupi Drejtues i IPARD, Takimi i Shtatë i Komitetit të Monitorimit të IPARD II: Përgatitja e Programit IPARD 2021-2027. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3m1mxhq>. [Qasur më 13.8.2021]
- Trupi Menaxhues me IPARD , Masa 6: Investimet në Infrastrukturën Publike Rurale (Në procesin e akreditimit). Në dispozicion në: <https://bit.ly/3seG9Qf>. [Qasur më 13.8.2021]
- Trupi Menaxhues me IPARD, Informacion në lidhje me ri-akreditimin dhe akreditimin e masave të reja (2016). Në dispozicion në: <https://bit.ly/3xKmngS>. [Qasur më 13.8.2021]

TË RINJTË NGA KRUSHEVA

Dimë, mundemi, duam!

- Sotir Gabeloski





REZYME

Konteksti socio-ekonomik dhe politik në Maqedoninë e Veriut prek popullatën e re në mënyrën më serioze dhe radikale. Ky është përfundimi i nxjerrë nga “Studimi për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë” i përgatitur nga Fondacioni Friedrich Ebert – Zyra në Shkup. Përkatësisht, shkalla e lartë e papunësisë tek të rinjtë e kombinuar me standardin e ulët të jetesës rezulton në migrim të shpejtë dhe masiv të të rinjve në vendet e Evropës Perëndimore. E gjithë kjo është rezultat i qasjes së fragmentuar strategjike në politikat dhe mekanizmat rinorë, veçanërisht në nivel lokal. Pasojat e krizës shëndetësore do të duhet të analizohen më tej në detaje.

Niveli i përfshirjes së të rinjve në komunën e Krushevës është relativisht i ulët. Pjesëmarrja e të rinjve në proceset e zhvilluara në nivel lokal reduktohet në ngjarje kulturore dhe sportive, të cilat, natyrisht, janë pjesë e interesave rinore, por politikat rinore kanë një potencial shumë më të madh.

Nivelet e ulëta të përfshirjes së të rinjve janë një problem më vete. Të rinjtë nuk përfshihen në proceset që janë me interes për ta. Për më tepër, niveli i ulët i përfshirjes së të rinjve shkakton kushte dhe procese të tjera të pafavorshme. Të rinjtë humbasin besimin në institucionet, nuk identifikohen me projektet e realizuara nga vetëqeverisja lokale dhe nuk ndjejnë se zëri i tyre dëgjohej, gjë që i bën të rinjtë të mos ndihen se i përkasin mjedisit në të cilin janë rritur dhe jetojnë.

Për më tepër, përfshirja e të rinjve në proceset e mëdha në parti, reduktohet në aktivitete më të vogla si aksione mjedisore dhe aksione për dhurimin e gjakut, menaxhim i rrjeteve sociale dhe mbështetje në organizimin e eventeve gjatë fushatave. Në përgatitjen e programeve zgjedhore, shumë parti nuk ftojnë as të rinjtë dhe as organizatat rinore të ndajnë propozimet, nevojat dhe idetë e tyre, madje edhe për politikat që i prekin drejtpërdrejt. Programet parazgjedhore të disa partive politike përmbajnë rubrika të veçanta për të rinjtë, por përmbajtja në to, projektet dhe aktivitetet e propozuara nuk burojnë nga anëtarët e rinj të partisë dhe as nuk janë krijuar në bazë të konsultimeve publike me të rinjtë. Një mos përfshirje e tillë në politikë bërje, ul besimin e të rinjve në proceset që zhvillohen brenda partisë.

Për të adresuar këtë çështje, ky dokument për politika publike, propozon një sërë aktivitete dhe projekte që dalin drejtpërdrejt nga të rinjtë, opinionet e të cilëve janë konsultuar përmes pyetësorëve, fokus grupeve dhe debateve të hapura.

Vetë dokumenti i politikave publike, si dhe aktivitetet që i kanë paraprirë, synojnë të iniciojnë diskutim, i cili do të japë propozime për politika publike dhe aktivitete të nevojshme në nivel lokal për përfshirjen më të madhe të të rinjve në proceset vendimmarrëse. Ky dokument është i dedikuar për të gjithë ata që punojnë në zhvillimin e komunitetit lokal, si dhe për të gjithë që punojnë me të rinjtë dhe për të rinjtë, dhe është veçanërisht i destinuar për vendimmarrësit në nivel lokal, këshillin rinor lokal, përfaqësuesit e institucioneve, organizatat e shoqërisë civile, organizatat për të rinj dhe organizatat rinore, si dhe biznes komunitetin lokal.

PROBLEMI - KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Pjesëmarrja e cila është një nga konceptet kyçe të politikës rinore dhe punës rinore lidhet me koncepte si angazhimi, fuqizimi, përfshirja, qytetaria, zëri. Pse pjesëmarrja e të rinjve është bërë e rëndësishme në shoqërinë tonë?

Në janar 2020, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Ligjin për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore¹⁰⁸.

Analiza e mundësive për pjesëmarrje rinore në komunën e Krushevës¹⁰⁹ tregoi se sfidat kryesore në fushën e pjesëmarrjes së të rinjve në nivel lokal lidhen me qëndrimet e të rinjve dhe faktin se ata janë pjesërisht të përfshirë në politikë bërje. Ekziston edhe një mosbesim i fortë ndaj institucioneve, edukim i dobët për mënyrat për përfshirje aktive në proceset vendimmarrëse, por gjithashtu shpesh shmanget përgjegjësia në formën e “askush nuk bën asgjë, pse unë”.

Sipas të dhënave të Regjistrimit të vitit 2002 dhe Planit Veprimi lokal për punësim të Komunës së Krushevës 2009 - 2011, të përpiluar në vitin 2009, mund të gjejmë të dhëna se në Komunën e Krushevës 39,4% janë të rinj deri në 20 vjeç. Nga kjo mund të konstatohet se një përqindje e konsiderueshme e popullsisë së re jeton në komunë.

Pavarësisht partneriteteve në sektorin e rinisë dhe krijimit të dokumenteve, emërimit të nëpunësve rinorë, vendosjes së dialogut ndërmjet Qeverisë, Agjencisë për Rini dhe Sport dhe shoqërisë civile, situata në terren tregon se të rinjtë ende jo mjaftueshëm janë të përfshirë në vendimmarrje në nivel lokal në komunat më të vogla siç është komuna e Krushevës. Për momentin (shtator 2021) janë të pakta komunat ku ekzistojnë këshilla rinore reale dhe aktive. Në hulumtimin e bërë për nevojat e këtij dokumenti mund të konstatohet se më shumë se 50% e bashkëbiseduesve të rinj besojnë se të rinjtë janë “vetëm dekor” në proceset vendimmarrëse në nivel lokal. Niveli i përfshirjes së të rinjve në komunën e Krushevës është relativisht i ulët. Pjesëmarrja e të rinjve në proceset e zhvilluara në nivel lokal reduktohet në ngjarje kulturore dhe sportive, të cilat, natyrisht, janë pjesë e interesave rinore, por politikën rinore kanë një potencial shumë më të madh.

Në kuadër të nismës “Nga të rinjtë për të rinjtë”, e cila është rezultat i këtij dokumenti, kanë realizuar dy fokus grupe, një pyetësor “online” dhe një punëtori me të rinjtë. Aktivitetet kanë përfshirë rreth 70 të rinj nga qyteti i Krushevës, Sazhdevës, Aldançes, Nerovës dhe Buçinit. Gjatë organizimit dhe realizimit të aktiviteteve, të rinjtë iu qasëm përmes rrjeteve sociale dhe komunikimit të drejtpërdrejtë, me telefon dhe sy më sy. Janë bërë dy analiza, njëra prej të cilave njëra analizon nivelin e zbatimit të Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore në Komunën e Krushevës, ndërsa analiza e dytë me titull “Analiza e mundësive për pjesëmarrje rinore në Komunën e Krushevës” rekomandon formimin e menjëhershëm të Këshilli Rinor.

108 Ligji për Pjesëmarrje rinore dhe politika rinore 2020, <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2020/03/Zakon-za-mladinsko-uchestvo-i-mladinski-politiki-16-01-2020.pdf>

109 Analiza e mundësive të pjesëmarrjes së të rinjve në komunën e Krushevës, 2021, Metodija Stojčevski, Krushevë

Nga kjo analizë konkludohet se të rinjtë janë pjesërisht të përfshirë, ndërsa puna vullnetare reduktohet në pjesëmarrje në punën e të rinjve në forumet rinore. “Analiza e mundësive për pjesëmarrje rinore në komunën e Krushevës” rekomandon forcimin e komunikimit me të rinjtë nga ana e komunës, e cila duhet të përmirësojë kanalet e komunikimit në mënyrë që informacionet të arrijë tek të rinjtë.

Në fokus grupin e realizuar, ku morën pjesë 18 të rinj nga Krusheva dhe vendbanimet Nerovë dhe Buçin, u evidentuan disa nevoja të të rinjve, duke përfshirë nevojën për objekte sportive në vendbanimet dhe më shumë vende për kulturë në qytet. Si problem u detektuan transporti i pamjaftueshëm për studentët, rrugët e pa qasshme për në muze dhe mundësitë e pamjaftueshme për arsimim joformal.



Në punëtorinë e zhvilluar me 24 të rinj nga Krusheva, u theksua rëndësia e vendimarrësve për t'u afruar dhe për t'iu qasur të rinjve. Një nga zgjidhjet që u përgjithësua përmes pyetjeve të të rinjve në pyetësonin online është nevoja për debat më të madh me të rinjtë dhe më shumë përfaqësues të rinj në këshillin e komunës. Të rinjtë theksuan nevojën e krijimit të menjëhershëm të një këshilli rinor lokal, i cili në përputhje me Ligjin aktual për pjesëmarrjen rinore dhe politika rinore përcakton se përfaqësimi dhe avokimi më i madh i të rinjve në këshill mund të kontribuojë në tejkalimin e këtyre pengesave dhe rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve. Kur bëhet fjalë për aktivizimin më të madh të të rinjve në zhvillimin e tyre personal dhe edukimin joformal, të rinjtë gjatë seminarit dhanë një sërë propozimesh, si ndërtimi i këndeve të lojërave, qendrës kulturore rinore, kinema, teatër, klube sportive e të ngjashme.

REKOMANDIME DHE AKTIVITETET

Ekzistojnë një sërë masash potenciale që do të kontribuonin në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve nga Krusheva në krijimin e politikave publike, në lidhje me komunikimin, miratimin e dokumenteve strategjike dhe përfaqësimin e të rinjve, por në këtë dokument fokusohemi në masën e mëposhtme:

- 1 Krusheva - qytet i nomadëve digjitalë - vendqëndrim i përkohshëm i programerëve, frilens punëtorëve, sektorit të TI-së, etj.

Në epokën e ekonomisë digjitale, hapet mundësi e re pune që nuk varet nga një zyrë fikse, me orar fleksibël pune dhe liri në mënyrën e punës. Interneti, mjetet e reja të komunikimit dhe bashkëpunimit kanë ndihmuar në krijimin e një mënyre të re pune dhe stili jetese të quajtur nomadizëm digjital.

Nomadët digjitalë janë profesionistë individualë të cilët, me ndihmën e teknologjive të reja, fitojnë dhe jetojnë si nomadë. Ata po ndryshojnë punët tradicionale dhe shpikin mënyra se si mund të funksionojnë virtualisht. Duke përdorur aftësitë e tyre (kryesisht TI), nomadët digjitalë gëzojnë mundësinë për të jetuar në një mjedis dhe kulturë të re.¹¹⁰

Nomadët digjitalë fitojnë para nga çdo punë e cila nuk është e varur nga vendndodhja, duke përfshirë blogimin, ueb dizajn, online kouçing, marketing, planifikim financiar, investim, dizajn grafik, përkthim, trajnim dhe të tjera. Aktualisht disa nga vendet më tërheqëse për nomadët digjitalë janë Estonia, Tajlanda, Qiproja, Norvegjia, Portugalia, Britania.¹¹¹

Sipas shërbimit të internetit NUMBEO¹¹² e cila mat koston e jetesës dhe standardin e jetesës së popullsisë, mund të bëhet një projeksion i ndryshimit të koston së jetesës midis dy vendeve, që është një nga arsytet e migrimit të nomadëve digjitalë dhe zgjedhjes së vendit për jetesë. Konkretisht, sipas faqes, diferenca në koston e qirasë ndërmjet Shkupit dhe një qyteti më të vogël në Maqedoni (për shembull Krushevë) është 63% në favor të qytetit të vogël; shërbimet e restoranteve janë më të lira me 38% dhe sendet ushqimore me 20%. Raporti i koston është edhe më i lartë nëse krahasohet me një qytet të Evropës Qendrore me kosto relativisht të lartë jetese. Megjithatë, kur zgjedhin, nomadët digjitalë marrin parasysh cilësinë e përgjithshme të jetës që ofron vendi, si legjislacioni për qëndrim dhe punësimin, shërbimet shëndetësore, atraktivitetin e mjedisit dhe nivelin e ndotjes.

Përveç kësaj, ajo që disa vende kanë bërë tashmë është lëshimi i të ashtuquajturave "viza digjitale" që lejojnë nomadët të qëndrojnë më gjatë në një vend të caktuar. Një shembull nga Evropa është Estonia ndërsa nga vendet e rajonit, Kroacia është vendi i parë që vendosi viza digjitale që do t'u jepen të huajve që do të punojnë për dikë tjetër për një periudhë njëvjeçare. Në Maqedoninë e Veriut, FITR po bën përpjekje për të promovuar vendin si destinacion për nomadizmin digjital. Tashmë kanë krijuar kontakte me shumë portale që merren me nomadizmin digjital, të cilat nga ana e tyre e kanë vendosur Maqedoninë e Veriut në listën e vendeve që do ta ofrojnë atë shërbim. Promovimi është planifikuar të bëhet përmes ueb faqeve që synojnë nomadët digjitalë dhe përmes rekomandimeve të nomadëve digjitalë që tashmë kanë punuar këtu.¹¹³

Zbatimi: Në mënyrë që të realizohet ky rekomandim, Komuna e Krushevës do të duhet të përgatisë një promovim dhe ofertë të përshtatshme që mund të bëhet me mbështetjen e FITR-it për tërheqjen e nomadëve digjitalë në Krushevë.

110 <https://blog.brainster.co/%D0%B4%D0%B8%D0%B3%D0%B8%D1%82%D0%B0%D0%BB%D0%B5%D0%BD-%D0%BD%D0%BE%D0%BC%D0%B0%D0%B4/>

111 Ibid

112 <https://www.numbeo.com/cost-of-living/>

113 <https://fitr.mk/makedonija-ce-stane-nova-atraktivna-destinacija-za-digitalni-nomadi/>

BIBLIOGRAFIA

- "Youth Friendly City" - RAPORT DHE REKOMANDIME NGA ZBATIMI - HARTIMI PËR KOMUNËN E KRUSHEVËS, 2018 - Unioni rinor- Krushevë 2018;
- STUDIM PËR RINJTË E MAQEDONISË SË VERIUT 2018/2019 - Friedrich Ebert Stiftung Shkup 2019;
- Plan veprimi lokal për punësim i Komunës së Krushevës;
- Plani Strategjik për Zhvillim Ekonomik Lokal i Komunës së Krushevës
- STRATEGJIA PËR TË RINJTË E KOMUNËS SË KRUSHEVËS 2019 - 2023.
- Ligji për Pjesëmarrje rinore dhe politika rinore: <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2020/03/Z-kon-za-mladinsko-uchestvo-i-mladinski-politiki-16-01-2020.pdf>
- <https://fitr.mk/makedonija-ce-stane-nova-atraktivna-destinacija-za-digitalni-nomadi/>

The background of the page features a photograph of a desk. On the right side, there is an orange spiral-bound notebook standing upright. In the foreground, a white spiral-bound notebook is open, with a pen resting on it. The pen has a green and black design. The overall scene is brightly lit, with a clean, professional aesthetic. The text is overlaid on teal-colored rectangular boxes.

AERODROM INKLUZIV PËR TË GJITHË

Politika dhe aktivitete për kujdesin
më të përshtatshëm të personave
me nevoja të veçanta

- Stefaniya Trajçeska



**ИНКЛУЗИВЕН
АЕРОДРОМ ЗА
СИТЕ**



СКОПЈЕ, 2021



**ИНКЛУЗИВЕН
АЕРОДРОМ ЗА
СИТЕ**

REZYME

Diversiteti përshtatet vetëm kur ne dimë ta pranojmë dhe kuptojmë atë. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se nuk ka gjëra të veçanta apo nevoja të veçanta. Ka vetëm gjëra unike dhe specifike, pra nevoja specifike. Ka vetëm fëmijë të veçantë. Ndryshimet nisin nga ne, dhe ne duhet të dimë që në fillim se si t'i kuptojmë dhe t'i ndihmojmë këto kategori të bashkëqytetarëve tanë që të mundësojnë integrimin e tyre më të lehtë në mjedisin ku ata jetojnë, dhe kështu vendi të jetë edhe më demokratik dhe më i avancuar.

Personat me aftësi të kufizuara janë pamjaftueshëm të integruar në shoqëri. Së këndejmi del dhe qëllimi themelor i këtij dokumenti. Përkatësisht, duke propozuar zgjidhje konkrete të bazuara në prova, ky dokument synon të inkurajojë qytetarët që t'i kuptojnë këta persona dhe t'i ndihmojnë ata në integrimin e tyre.

PROBLEMI - KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Nevojat e personave me aftësi të kufizuara janë një temë që duhet trajtuar në mënyrë të barabartë nga shteti, organizatat e shoqërisë civile dhe subjektet private, si dhe nga njësitet e vetëqeverisjes lokale.

Komuna e Aerodromit, si një nga komunat më të mëdha në shtet, vend ku pulsojnë shumica e ngjarjeve, ka mundësinë, por edhe obligimin që me shembullin e saj të përpiqet të ngrejë standardet që kanë të bëjnë me përmirësimin kushteve të jetesës, rritja e inklusivitetit, si dhe ndërgjegjësimi për pranimin e personave me aftësi të kufizuara.

Në Komunën e Aerodromit nuk ka regjistër të personave me aftësi të kufizuara. Duke pasur parasysh sa më sipër, nuk ka një ide të qartë për adresimin e disa nevojave të këtij grupi të bashkëqytetarëve tanë. Përkundrazi, problemet e këtij lloji të fëmijëve bëhen kryesisht kujdesi i prindërve, si në lidhje me ndërveprimin e fëmijëve të shëndetshëm me bashkëmoshatarët e tyre që kanë sfida të tilla, ashtu edhe anasjelltas.

Duke pasur parasysh qëllimin e përgjithshëm të këtij dokumenti të politikave publike, në këtë seksion rëndësia e problemit do të shpjegohet duke u referuar te:

- Korniza ligjore;
- Qëndrimet e prindërve;
- Pikëpamjet e ekspertëve;
- Qëndrimet e qytetarëve.

Korniza ligjore

Korniza ligjore e Maqedonisë së Veriut në këtë fushë, ndër të tjera, është e përcaktuar me Ligjin për arsimin fillor.¹¹⁴

¹¹⁴ Shiko Ligji për arsimin fillor, Gazeta Zyrtare nr.: 161, 5.8.2019.

Sipas nenit 11 të këtij ligji, arsimit inkluziv (gjithëpërfshirës) është një proces që merr parasysh nevojat e ndryshme individuale për zhvillimin e nxënësve, duke ofruar mundësi të barabarta për realizimin e të drejtave themelore të njeriut për zhvillim dhe arsim cilësor, duke marrë parasysh dallimet e secilit individ dhe duke mundësuar socializim më të madh dhe edukim të përshtatshëm.

Ligji për arsimin fillor mbulon të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar.

Sipas paragrafit 2 të nenit 11, Ligji parashikon ndryshime që prekin të gjithë procesin arsimor, përkatësisht ndryshime në përmbajtjen, qasjen, strukturat dhe strategjitë e mësimdhënies. Qëllimi i këtyre ndryshimeve është që fëmijët me nevoja të veçanta të përfshihen në mënyrë të barabartë në procesin arsimor së bashku me bashkëmoshtarët e tyre.

Ky ligj nënkupton krijimin e një plani të veçantë individual për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke marrë parasysh aftësitë e tyre, pra aftësitë funksionale dhe personale. Ky ligj merr masa për qasje të barabartë të personave me aftësi të kufizuara, duke përshtatur infrastrukturën, mjedisin, mjedisin fizik, transportin, si dhe përfshirjen në teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit në shkollat fillore.

Rishikimi i pikëpamjeve të prindërve

Bazuar në fokus grupe me prindërit¹¹⁵ të cilat u organizuan gjatë qershorit 2021, mund të vihen në dukje sfidat e mëposhtme të rëndësishme që u identifikuan gjatë diskutimeve:

- Prindërit janë të njohur me termin përfshirje, por futja e përfshirjes së plotë është një sfidë e madhe për ta;
- Prindërit, fëmijët e të cilëve mësojnë së bashku me një fëmijë ose fëmijë me aftësi të kufizuara, e shohin një sfidë të madhe dhe se fëmijët e tyre do të përballen me probleme sepse janë mësuar me një qasje krejtësisht të ndryshme;
- Prindërit që kanë një fëmijë me aftësi të kufizuara theksojnë si një sfidë të madhe punësimin e asistentëve personalë, për sa i përket mos dijes dhe skepticizmit nëse fëmijët e tyre do të drejtohen siç duhet gjatë procesit arsimor;
- Të gjithë prindërit e vënë në dukje si problem shtesë mos përgatitjen e shkollave, përkatësisht mungesën e teknologjisë së mjaftueshme ndihmëse, dhomave ndijore, rampave, ashensorëve, tualeteve, stafit të mjaftueshëm profesional, si dhe mungesën e trajnimeve të duhura për mësuesit që duhet të punojnë çdo ditë me personat me aftësi të kufizuara;

115 Në këtë fokus grup morën pjesë 10 persona, të gjithë banorë të Komunës së Aerodromit.

- Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara besojnë se fëmijët e tyre janë të prekshëm ndaj ndryshimit, pra përshtatjes me mjediset e reja, veçanërisht kur bëhet fjalë për personat me çrregullime të spektrit autik. Në këtë aspekt, ekziston një shqetësim objektiv se si këta fëmijë do të funksionojnë në një grup më të madh dhe nëse nevojat e tyre do të plotësohen në mënyrë adekuate, pa inkurajuar sjellje provokuese.

Nisur nga sa më sipër, duke parashikuar nevojat e prindërve të prekur, mund të konkludohet se megjithëse vendi ynë po përgatitet për futjen e një sistemi të përfshirjes së plotë, ka ende skepticizëm të fortë se si do të funksionojë një sistem i tillë. Në këtë drejtim, ekziston frika objektive nëse shteti është ekonomikisht i gatshëm për një sistem të tillë funksional.

Rishikimi i pikëpamjeve të ekspertëve

Bazuar në fokus grupe me ekspertë të fushës¹¹⁶, i zbatuar në qershor 2021, mund të theksohen sfidat e mëposhtme të rëndësishme:

- Ekspertët theksojnë se gjatë krijimit të kuadrit ligjor nuk janë konsultuar për ndryshimet e parashikuara nga shtatori 2021;
- Një sfidë e veçantë në të ardhmen do të jetë trajnimi i pamjaftueshëm që duhet të kalojnë asistentët personalë dhe mësuesit në mënyrë që të mund të ofrojnë qasjen e duhur për punën gjatë orëve të mësimi;
- Ata theksojnë se takojnë njerëz që punojnë si asistentë personalë pa marrë parasysh nëse arsimimi i tyre korrespondon me punën e tyre;
- Të ardhurat mujore që mbulon shteti për asistentët personalë janë shumë të ulëta;
- Personat me aftësi të kufizuara përshtaten më vështirë dhe shumë prej tyre nuk mund të ulen për 45 minuta në orë. Në këtë aspekt, sipas tyre, synohet të vlerësohen aftësitë funksionale të çdo fëmije dhe përmes asaj që sa mundet fëmija të jetë në gjendje të përfshihet në aktivitetet e jetës së përditshme;
- Edhe pse ekspertët theksojnë faktin se të gjithë fëmijët janë të veçantë dhe se ne të gjithë jemi specifik në veçantinë tonë dhe se nuk duhet të ketë ndarje mes njerëzve, megjithatë për shumë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore nuk rekomandohet të qëndrojnë ulur për 45 minuta dhe të dëgjojnë mësim për gjëra që nuk mund t'u shërbejnë atyre në funksionimin e përditshëm;
- Sipas ekspertëve, inklusiviteti duhet të zbatohet nga mosha e hershme, e jo nga arsimi fillor. Përkatësisht, psikologët theksojnë faktin se shumë prindër janë të hutuar dhe nuk dinë të veprojnë kur në klasën e fëmijës së tyre ka një fëmijë me nevoja specifike arsimore.

Bazuar në sfidat e spikatura të profesionistëve, mund të konstatohet se nëse do të flitej më shumë në publik, nëse do të organizoheshin më shumë trajnime për prindërit, mësuesit dhe profilet e tjera profesionale dhe nëse shkollat do të ishin plotësisht të përgatitura, vendimi për futjen e inkuzivitetit të plotë do të ishte shumë larg iluzionit që është sot.

Shqyrtimi i qëndrimeve të qytetarëve

Pos prindërve dhe profesionistëve, qëndrimin e tyre për këtë temë e kanë edhe qytetarët

116 Në këtë fokus grup morën pjesë 8 persona.

Sipas rezultateve të sondazhit të opinionit publik të kryer online gjatë qershorit 2021, në një shembull prej 100 të anketuarish, mund të theksohen sfidat e mëposhtme të rëndësishme:

- Shumica e të anketuarve janë pro integritit më të mirë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, duke theksuar se shteti duhet të fokusohet në përmirësimin e kushteve në shoqëri dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në ngjarjet sociale;
- Shumica e të anketuarve janë të njohur me termin inkluzion, si dhe me termin inkluzion i plotë. Në këtë kuptim, sipas tyre, termi inkluzion nënkupton përfshirjen në shoqëri dhe në funksionimin e përditshëm të të gjithë personave pavarësisht nga veçoritë dhe karakteristikat e tyre specifike personale;
- Kur bëhet fjalë për zbatimin e përfshirjes së plotë, shumica e të anketuarve nuk pajtohen me këtë zgjidhje;
Shumica e të anketuarve mendojnë se ne nuk jemi gati për një sistem të inkluzionit të plotë dhe se fëmijët me aftësi të kufizuara meritojnë një qasje të veçantë dhe se çdo fëmijë me aftësi të kufizuara duhet të ketë një asistent personal, duke marrë parasysh edukimin e asistentëve personal që sipas shumicës së të anketuarve është i rëndësishëm për të punuar me fëmijë të tillë, sepse jo të gjithë mund të punojnë me ta;
- Kur bëhet fjalë për të ardhurat mujore të asistentëve personalë, shumica e të anketuarve mendojnë se burimet financiare që shteti ndan për asistentët personalë nuk janë të mjaftueshme;
- Edhe pse shumica e të anketuarve deklarojnë se nuk dinë për një vend ku ka një sistem të inkluzionit të plotë, megjithatë, disa prej tyre tregojnë si shembuj të mirë Anglinë, Kroacinë, Danimarkën dhe Suedinë.

Duke pasur parasysh sa më sipër, mund të konstatohet se publiku me njëfarë skepticismi i shikon ndryshimet e paralajmëruara në sistemin arsimor fillor, veçanërisht në pjesën e prezantimit të konceptit të përfshirjes së plotë me të cilën shteti nuk do t'i diferencojë fëmijët me paaftësi nga fëmijët e tjerët në vend për sa i përket mënyrës se si do të zhvillohet arsimiti i tyre fillor.

KONCEPTE TË LIDHURA ME INKLUZIONIN

Kuadri ligjor që e përcakton përfshirjen në vendin tonë si përfshirje e kombinuar është më shumë se 20 vjeç. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të sqarohen katër termat e mëposhtëm për një të kuptuar më të plotë të kontekstit dhe rekomandimeve të këtij dokumenti:

- **Inkluzion i kombinuar.** Ky term nënkupton mësimdhënien në shkolla të rregullta në krahasim me mësimdhënien: a) në klasa të veçanta në shkolla të rregullta dhe b) mësimdhënie ekskluzivisht në shkolla speciale për fëmijë me nevoja të veçanta;
- **Inkluzioni i plotë.** Ky term nënkupton gjendjen e integritit të plotë të nxënësve në sistemin e rregullt arsimor, pavarësisht nga nevojat dhe specifikat e tyre personale;

- **Nxënësit me aftësi të kufizuara.** Ky term u referohet personave me dëmtime afatgjatë fizike, mendore, intelektuale dhe/ose shqisore, pjesëmarrja e plotë dhe efektive e të cilëve në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët mund të pengohet nga barriera të ndryshme në mjedis;
- **Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.** Ky term u referohet personave me aftësi të kufizuara dhe vështirësive specifike të të nxënësve që përfshijnë, por nuk kufizohen në, disleksinë, disgrafinë dhe diskalkulinë. Në këtë aspekt, ndryshimet e reja në Ligjin për arsimin fillor do të hyjnë në fuqi në shtator të vitit 2021. Me to, ndryshe nga e kaluara, parashikohet futja e të ashtuquajturve "Inkluzion i plotë".

Nisur nga sqarimet e mësipërme, është e rëndësishme të theksohet se sistemi i inkluzionit synon të pengojë prindërit të zgjedhin nëse fëmija i tyre duhet të ndjekë një shkollë të rregullt apo speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara, përpara se këto ndryshime të ishin e drejta dhe vendimi i prindërve ose kujdestarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Bazuar në të gjitha të lartpërmendurat, me këtë dokument, përpjekjet po shkojnë në drejtim të:

- Zhvillimi të mëtejshëm të kulturës gjithëpërfshirëse të të gjithëve në Komunën e Aerodromit;
- Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit për mundësitë dhe rregulloret ligjore në lidhje me fushën e treguar;
- Mundësimi i zërave të vetë palëve të prekura që të dëgjohen dhe sugjerimet e tyre të merren parasysh gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave në nivel lokal.

REKOMANDIME DHE AKTIVITETE

Çfarë nevojitet për të zbatuar një sistem të inkluzivitetit të plotë?

- 1 Numër i mjaftueshëm i profesionistëve të trajnuar.** Në këtë aspekt duhen pasur parasysh përvojat krahasuese të vendeve të zhvilluara evropiane dhe për rrjedhojë duhet hartuar një plan me dinamikë për punësimin e profesionistëve në mënyrë që të mund të ringjallet në praktikë ky koncept i inkluzivitetit të plotë;
- 2 Shkolla të përshtatura për personat me nevoja të veçanta: ashensorë, rampa, tualete, teknologji ndihmëse...** Në këtë kuptim, institucionet duhet të rimendojnë prioritetet sa i përket investimeve buxhetore në arsim. Domethënë, asnjë reformë, pavarësisht nga natyra e dispozitave ligjore, nuk do të mund të mbijetojë nëse nuk monitorohet me mjetet e duhura që do të mundësojnë realizimin e plotë të aktiviteteve të planifikuara;
- 3 Asistent profesionist për çdo fëmijë, si dhe punësimin e kujdestarëve dhe një sërë edukatorësh dhe rehabilituesish dhe logopedësh.** Kjo është ndoshta sfida më e madhe për institucionet e pushtetit lokal dhe qendror. Ngjashëm si në lidhje me përfundimin e dytë, kjo pjesë e reformës nuk do të ketë sukses nëse institucionet nuk rishikojnë politikën buxhetore në këtë pjesë përmes sigurimit të fondeve për arritjen e këtij qëllimi;

- 4 Organizimi i një numri të madh trajnimesh për prindër, mësues dhe profesionistë të tjerë.** Për kundër investimeve buxhetore, ky segment është po aq i rëndësishëm. Përkatësisht, klima e përgjithshme që ekziston në shoqëri mund të kontribuojë më lehtë ose më vështirë në arritjen e një qëllimi të caktuar. Prandaj, është veçanërisht e rëndësishme që qeveritë lokale të aplikojnë një qasje gjithëpërfshirëse moderne, sipas së cilës palët e interesuara dhe shoqëria në tërësi do të zhvillojnë më tej kulturën e tyre të pranimit, tolerimit dhe bashkëpunimit me të gjithë njerëzit, pavarësisht nga karakteristikat e tyre specifike.

Vetëm kur plotësohen të gjitha këto nevoja, flasim për inkluzion, dhe jo për iluzion.

BIBLIOGRAFIA

- Abbring, I., and C. J. W. Meijer. 1994. "Italy." In *New Perspectives in Special Education*, edited by C. J. W. Meijer, S. J. Pijl, and S. Hegarty, 9–24. London: Routledge;
- Ainscow, M., and A. Sandill. 2010. "Developing Inclusive Education Systems: The Role of Organisational Cultures and Leadership." *International Journal of Inclusive Education* 14: 401–416;
- Dettori, F. 2009. "La fuga degli insegnanti di sostegno verso il posto comune: una ricerca sulle storie professionali [The Flight of Support Teachers Towards Mainstream Classes: A Study of Professional Lives]." *L'integrazione scolastica e sociale [Social and Educational Integration]* 8: 247–258;
- Fornari, U., and S. Ferracuti. 1995. "Special Judicial Psychiatric Hospitals in Italy and the Shortcomings of the Mental Health Law." *The Journal of Forensic Psychiatry* 6: 381–392;
- Fuchs, D., and L. S. Fuchs. 1994. "Inclusive Schools Movement and the Radicalization of Special Education Reform." *Exceptional Children* 60: 294–309;
- Lipsky, D. K., and A. Gartner. 1996. "Inclusion, School Restructuring, and the Remaking of American Society." *Harvard Educational Review* 66: 762–797;
- Low, C. 2006. "Some Ideologies of Disability." *Journal of Research in Special Educational Needs* 6: 108–111;
- MacMillan, D. L., F. M. Gresham, and S. R. Forness. 1996. "Full Inclusion: An Empirical Perspective." *Behavioral Disorders* 21: 145–159;
- Ligji për arsimin fillor;
- www.mon.gov.mk;
- www.aerodrom.gov.mk.




KUSH ÇFARË FRENON?

ZBATIMI I DISPOZITAVE NGA LIGJI
PËR PARANDALIM DHE MBROJTJE
NGA DHUNA NDAJ GRAVE DHE
DHUNA NË FAMILJE NË KOMUNËN
E KUMANOVËS

- Teodora Dimitriovska





REZYME

Dhuna në familje është një nga problemet kryesore me të cilat përballen komunitetet lokale në vendin tonë. Sipas të dhënave për vitin 2019, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka regjistruar 1555 raste të reja të dhunës në familje, ku në vitin 2020 kanë shënuar rritje prej 30% në kulmin e pandemisë KOVID-19. Komuna e Kumanovës është ndër komunat me shkallën më të lartë të dhunës në familje. Gjithashtu sipas Indeksit të Barazisë Gjinore në nivel vendor¹¹⁷ që i referohet vitit 2019 Komuna e Kumanovës renditet në vendin e 55-të me 22 pikë të përgjithshme, përkundër faktit se në llogaritjet e indeksit nuk është përfshirë dhuna në familje, në përgjithësi mund të thuhet se mjedisi në komunë është mbështetës sa i përket barazisë gjinore dhe për luftën kundër dhunës në familje.

Mbjellja e dhunës dhe dhuna ndaj grave krijon një sërë pasojash negative, por edhe sfida gjatë përballimit. Pasojat e dhunës në familje janë të gjera dhe shkaktojnë vuajtje psikologjike për viktimat, por edhe për ata që kanë qenë dëshmitarë të drejtpërdrejtë të një ngjarje të tillë fatkeqe. Pasoja të tilla psikologjike mund të kontribuojnë gjithashtu në zhvillimin e pashëndetshëm të personalitetit, sëmundjet mendore, ndryshime në sistemin e vlerave, madje edhe përpjekjet për vetëvrasje. Gjithashtu, dhuna në familje në mënyrë negative prek drejtpërdrejt një nga shtyllat dhe institucionet kryesore në shoqëri, e ajo është familja.

Sfidat nga ana tjetër janë disa. Një nga sfidat kryesore në këtë çështje është mosveprimi i institucioneve në lidhje me dhunën në familje. Për më tepër, një sfidë tjetër është mungesa e monitorimit dhe koordinimit të mekanizmave ekzistues ligjorë ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe lokale. Ekziston edhe prioriteti i ulët që ka dhuna në familje te autoriteteve lokale si dhe mungesa e transparencës në dhënien e informacionit në lidhje me mundësitë e barabarta dhe dhunën në familje nga pushteti lokal.

Ka disa alternativa të mundshme, por mbi të gjitha prioriteti më i lartë është krijimi i një mekanizmi për ofrimin e shërbimeve në formën e One-stop shop. Është në fakt një model shërbimi ku në një vend viktimat e dhunës në familje mund të denoncojnë vetë dhunën, të marrin ndihmë juridike, të marrin ndihmë në formë edukimi, si dhe ndihmë për punësim. Zgjidhja për vendosjen e One-stop shop, është angazhim afatgjatë, realizimi i të cilit kërkon kohë dhe burime. Sfida në këtë model është se kërkon bashkëpunim dhe koordinim ndërinstytucional, si dhe përfshirjen e aktorëve lokalë në ofrimin e shërbimeve për viktimat, për shembull organizatat e shoqërisë civile. Kjo nënkupton krijimin e zinxhirëve për ndërhyrje, protokolle dhe procese, si dhe trajnimin e stafit të duhur.

Avantazhi i këtij modeli është se shmang kurthin e një "labirinti institucional" ku viktimat mund të dorëzohen, duke pasur parasysh se duhet të kalojnë më shumë institucione dhe kohë të çmuar për ndihmë dhe mbështetje për dhunën në familje.

¹¹⁷ <http://www.rodovindeks.mk/>

KONTEKSTI DHE RËNDËSIA E PROBLEMIT

Dhuna në familje konsiderohet sjellja e një anëtari të familjes që përdor forcën, kërcënimin ose frikësimin për të shkaktuar dëmtim trupor, keqpërdorim emocional ose seksual dhe shfrytëzim material, seksual ose të punës mbi një anëtar tjetër të familjes. Si i tillë, ai ka ndikime negative afatgjata drejtpërdrejt në zhvillimin personal dhe social të viktimave, por edhe në shoqëri.

Kur është fjala për dhunën në familje në Komunën e Kumanovës, ajo është objekt i analizës së këtij dokumenti dhe do të zhvillohet përmes prizmit të kompetencave ligjore që ka Komuna në fushën e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje. Për më tepër, ky dokument ofron zgjidhje të propozuara që mund të zbatohen nga Komuna, me një qëllim përfundimtar, mbrojtjen e atyre për të cilët frika është mendimi fillestar i ditës, ndërsa pasiguria dhe mos pasja e mbrojtjes janë të përditshme.

SFIDAT, SHKAQET DHE PASOJAT

Hulumtimet e mëparshme mbi këtë temë tregojnë se çështja e dhunës në familje është e rregulluar në mënyrë të pamjaftueshme përkundër seriozitetit dhe frekuencës së saj në Komunën e Kumanovës. Gjegjësisht, sipas Indeksit të Barazisë Gjinore¹¹⁸ në nivel lokal, që i referohet vitit 2019, Komuna e Kumanovës renditet e 55-ta me 22 pikë të përgjithshme. Kjo renditje nënkupton se nga gjithsej 81 komuna, Komuna e Kumanovës është komunë që pjesërisht i plotëson kriteret për të mundësuar promovimin e barazisë gjinore. Të dhënat e Qendrës për Punë Sociale nga Kumanova tregojnë për shkallën e lartë të dhunës në familje që ekziston në Kumanovë. Gjegjësisht, sipas tyre, në vitin 2019 në Kumanovë janë raportuar 229 raste të dhunës në familje, prej të cilave 59 vepra penale dhe 170 parashtrës, ndërsa në vitin 2020 ka pasur 205 raporte të dhunës në familje, prej tyre 57 vepra penale dhe 148 ankesa. Sipas tyre, viktimat më të mëdha të dhunës në familje janë gratë dhe të moshuarit, ku fëmijët janë të dytët që përfshihen.

Edhe pse nuk ka ndonjë hulumtim të detajuar, arsyet për shfaqjen e dhunës në familje në Komunën e Kumanovës, supozohet se mund të jenë si në vijim: (1) punë me ndërprerje ose punë emigruese që është e përkohshme. Dihet se Kumanova është një nga qytetet me më së shumti punëtorë emigrues në zonat e luftës në Lindjen e Mesme, gjë që lë pasojë traumatike të njerëzve që më vonë kanë ndikim në marrëdhëniet familjare; (2) patriarkalizmi ende i pranishëm që ekziston në familje, më saktë në disa prej tyre, ku edhe feja kontribuon shumë në trajtimin e pabarabartë të anëtarëve të familjes; (3) niveli i pamjaftueshëm arsimor i fëmijëve dhe nxënësve të shkollave të mesme të cilët nga njëra anë nuk janë mjaftueshëm të njohur me çështjen e dhunës në familje, ndërsa nga ana tjetër nuk kanë edukatë seksuale që në një farë mase do t'u japë atyre njohuri për temat të cilat në një komunitet kaq më konservator ende janë "tema tabu"; (4) komuniteti në të cilin rritet fëmija, përkatësisht vlerat, njohuritë dhe shembujt që prindërit ua përcjellin fëmijëve, të cilat më pas si persona të pjekur, i manifestojnë. Përkatësisht, një familje në të cilën dhuna është e përditshme do të ndërtojë njerëz që më tej mund të jenë autorë të dhunës në familje.

118 Indeksi i Barazisë Gjinore, <http://www.rodovindeks.mk/>

Një nga sfidat kryesore në këtë çështje është mosveprimi i institucioneve në lidhje me dhunën në familje. Në vitin 2019, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale regjistroi 1 555 raste të reja të dhunës në familje, ndërsa Analiza e të dhënave nga rastet e monitoruara gjyqësore për rastet e dhunës në familje dhe me bazë gjinore të Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë”, në periudhën nga prilli deri në korrik 2019, tregon disa fenomene negative. Nga 35 raste të dhunës në familje të analizuara në vend, 22 ishin në Shkup, 3 në Gostivar, 8 në Manastir, 1 në Prilep, 1 në Shtip, 1 në Strugë dhe 11 në Kumanovë. Kjo do të thotë se dhuna në familje përfundon në gjykata vetëm në qytetet më të mëdha, madje edhe atje rastet e procedurave gjyqësore të dhunës në familje janë jashtëzakonisht të rralla.¹¹⁹

Intensiteti dhe interesimi i dhunës në familje është shtuar edhe gjatë krizës së KOV-ID-19, ku sipas Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) në maj dhe qershor 2020, numri i raportimeve të dhunës në familje është rritur për 30% krahasuar me vitin 2019.

Për më tepër, një sfidë tjetër është mungesa e monitorimit dhe koordinimit të mekanizmave ekzistues ligjorë ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe lokale.

Ka disa ligje dhe dokumente shtetërore që rregullojnë këtë çështje, si; Ligji për vetëqeverisjen lokale i cili në nenin 22 përcakton kompetencat e komunave në fushën e mbrojtjes sociale; Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, i cili përcakton kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale (në tekstin e mëtejshëm NJVL) në fushën e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, i cili ofron edhe implikime financiare, por gjithashtu edhe disa shërbime për të ndihmuar viktimat nga autoritetet lokale; Ligji për mbrojtje sociale parasheh që NJVL-të, të sigurojnë zbatimin e mbrojtjes sociale në përputhje me ligjin, si dhe të miratojnë programe për nevojat e qytetarëve në fushën e mbrojtjes sociale, në kuadër të Programit Nacional për Mbrojtje Sociale.

Ekzistojnë gjithashtu disa plane veprimi dhe programe. Plani i veprimit për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2018-2023¹²⁰ parashikon aktivitete për ngritjen e vetëdijes për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e stereotipeve për rolet gjinore në zonat urbane dhe rurale në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale, si dhe vendosjen e një qëllimi strategjik për parandalimin dhe mbrojtjen e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në dokumentet strategjike aktuale dhe të ardhshme të njësive të vetëqeverisjes lokale; Programi i Qeverisë për 2017-2020¹²¹ parashikoi hapjen e qendrave të reja rajonale për përkujdesjen e viktimave të dhunës në familje, të cilat nuk janë hapur deri më sot dhe as projekti nuk është zbatuar në praktikë.

Serioziteti i çështjes kërkon koordinim më të mirë të burimeve që i nevojiten komunitetit lokal për të ofruar shërbim, siguri, standarde evropiane dhe siguri më të mirë për viktimat e dhunës në familje.

119 Dhuna me bazë gjinore: vepër penale që mbetet e toleruar, Gala Naseva, 2021, f. 3

120 Plani i plotë gjendet në linkun e mëposhtëm - https://mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-nacionalni-ot-plan-za-sproveduvanje-na-konvencijata-za-sprecuvanje-i-borba-protiv-nasilstvoto-vrz-zen.nspix

121 Programi për punën e Qeverisë së RMV-së 2017-2020, në dispozicion në - https://issuu.com/vladamk/docs/programa_vlada_2017-2020_mkd

Edhe pse legjislacioni dhe aktet nënligjore janë të gjera dhe parashikojnë një sërë detyrimesh të NJVL-ve, si dhe mbrojtje gjithëpërfshirëse të viktimave, situata në komuna është ende shumë në nivelin e demokracive moderne, ku për shembull në Britaninë e Madhe në fund të vitit 2020 është miratuar ligji i ri i cili parashikon mbështetje të detyrueshme për viktimat e dhunës në familje në nivel lokal.¹²²

Sfida tjetër është prioriteti i ulët që dhuna në familje ka tek autoritetet lokale. Gjegjësisht, në Komunën e Kumanovës, edhe pse në administratën komunale ekziston Sektori për mbrojtje sociale i cili ka juridiksion për çështjen e dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore, kjo çështje ende nuk është proceduar dhe shqyrtuar për disa vite. Administrata komunale joefikase, e burokratizuar dhe shumë e madhe nga njëra anë dhe jo aq profesionale nga ana tjetër, tregon se në Komunën e Kumanovës tema e dhunës në familje nuk paraqitet si prioritet, por gjithmonë ka avantazhin e ndihmës financiare të njëanshme, shërbimet komunale, infrastrukturë dhe çështje të tjera Sipas hulumtimit¹²³ të cilin e kemi zbatuar në Komunën e Kumanovës, Komuna punon sipas një plani vjetor të vjetërsuar¹²⁴ (që sigurisht është një nga pasojat e krizës Covid-19¹²⁵), por në planet e mëparshme vjetore fondet e parashikuara për përmirësimin e mekanizmit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje nuk është përmirësuar nga autoritetet komunale. Prioriteti i ulët i parandalimit të dhunës në familje vërehet nga Programi Vjetor për Mbrojtjen Sociale dhe programi për vitin 2021 në të cilin si kategori e veçantë nuk renditen personat që janë viktimat të dhunës në familje/gjinore, që do të thotë se Komuna për ata nuk do të ndajë mjete financiare për mbështetje. Nga ana tjetër, ka një shkallë të caktuar të interesimit në mesin e të punësuarve në administratën komunale për të ndërmarrë aktivitete në këtë fushë dhe për të filluar praktikë pozitive për të rritur interesimin e autoriteteve lokale për këtë çështje, por nuk siguron asnjë burim financiar që nuk mund të ketë asnjë aktivitet nga administrata komunale për këtë çështje.

Një sfidë tjetër është mungesa e transparencës në publikimin e informacionit në lidhje me dhunën në familje. Sipas Ligjit për mundësi të barabarta ndërmjet burrave dhe grave, neni 14 përmenden obligimet e NJVL-së në fushën e ofrimit të mundësive të barabarta ndërmjet burrave dhe grave. Pra, ligji parashikon se "Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, me rastin e miratimit të planeve zhvillimore dhe akteve e vendimeve të tjera, janë të detyruara të shqyrtojnë dhe marrin parasysh masat dhe aktivitetet e propozuara nga komisioni për mundësi të barabarta midis burrave dhe grave dhe koordinatorit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave."¹²⁶ Në faqen zyrtare të Komunës së Kumanovës¹²⁷ nuk ka asnjë informacion për Koordinatorin për Mundësi të Barabarta apo anëtarët e Komisionit për Mundësi të Barabarta. Sipas ligjit, Komuna ka obligim ligjor që të caktojë një Koordinator për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave dhe anëtarët e Komisionit.

122 <https://www.gov.uk/government/news/local-government-secretary-confirms-new-support-for-survivors-of-domestic-abuse> - Përdorur për herë të fundit më 26 korrik 2021

123 Desk hulumtim i realizuar nga ekspertja Tatjana Stoimenovska nga 05.06.2021 deri më 15.07.2021.

124 Të dhënat për planin vjetor merren nga administrata komunale. Duke pasur parasysh se Komuna punon sipas një plani vjetor të vjetërsuar dhe nuk ka votuar dhe miratuar një plan të ri vjetor, plani i vjetër vjetor nuk më është dorëzuar në asnjë formë sipas kërkesës sime.

125 Fragment nga Hulumtimi i kryer nga ekspertja Tatjana Stoimenovska nga data 05.06.2021 deri më 15.07.2021 nga pjesa e ndikimeve të jashtme në rritjen e numrit të rasteve të dhunës në familje.

126 Neni 14, paragrafi 3, Ligji për mundësi të barabarta ndërmjet burrave dhe grave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/2021 dhe 166/2014

127 <https://kumanovo.gov.mk/>

Mos-efikasiteti në punën e Komisionit për Mundësi të Barabarta vërehet në faktin se në punën e tyre tre vjeçare e gjysmë nuk kanë kryer asnjë aktivitet dhe nuk kanë buxhet operativ. Po ashtu, në faqen zyrtare të Komunës së Kumanovës nuk ka të dhëna për Komisionin, kështu që qytetarët nuk mund të njoftohen me punën e tyre dhe as të shfrytëzojnë të drejtat që kanë në përputhje me ligjin e lartpërmendur.¹²⁸ Pas një bisede telefonike me zyrtarët administrativë nga Komuna e Kumanovës, megjithatë erdhëm në përfundim se është caktuar një koordinator për mundësi të barabarta, i cili është edhe udhëheqës i Sektorit për mbrojtje sociale. Sa i përket komisionit për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave, komisioni përbëhet nga katër anëtarë, të gjitha gra. Si obligim ligjor imponohet nevoja për ndarjen e mjeteve buxhetore për Komisionin dhe koordinatorin komunal, me qëllim të realizimit të obligimeve të tyre ligjore nga njëra anë dhe ushtrimit dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve të Kumanovës, në anën tjetër. Në bazë të ligjit të mësipërm, Koordinatori për Mundësi të Barabarta është i detyruar që jo më vonë se data 31 mars t'i paraqesë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale raport për të gjitha masat dhe aktivitetet e zbatuara për vitin e kaluar, të cilat janë në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi gjinore. Masat dhe aktivitetet për të cilat është përgjegjëse administrata komunale dhe që lidhen ngushtë me dhunën me bazë gjinore dhe në familje, janë pikërisht në kompetencë të koordinatorit dhe Komisionit për mundësi të barabarta. Si pikënisje duhet të jetë interesimi i anëtarëve të Komisionit të cilët disa herë kanë iniciuar tu sigurohen mjete minimale (nën 30.000 denarë në vit) për realizimin e aktiviteteve dhe masave të parapara me ligj si të detyrueshme.

Pasojat që paraqiten nga gjendjet e tilla janë të mëdha. Para së gjithash këtu është mjedis institucional joefikas për trajtimin e dhunës në familje, gjë që rezulton në probleme të pazgjdhura dhe dorëzim të viktimave për zgjidhjen e problemeve. Për më tepër, dhuna në familje ndikon fuqishëm tek fëmijët dhe zhvillimin dhe vetëvlerësimin e tyre në të ardhmen, ndërsa megjithëse nuk kemi kërtime adekuate, ka raste të sjelljeve devijuese të fëmijëve që kanë qenë dëshmitarë dhe/ose viktime të dhunës në familje.

ALTERNATIVA TË MUNDSHME

Pavarësisht shtrirjes dhe kompleksitetit të kësaj çështjeje, ka ende një hapësirë të madhe për përparim përmes zbatimit të zgjidhjeve dhe politikave të duhura.

Së pari, nevojitet përfaqësim nga autoritetet lokale për ndryshim të legjisllacionit dhe për ndërhyrje në politikën penale për autorët e dhunës në familje. Kështu, zgjidhja është krijimi i qendrave moderne të trajtimit (zëvendësimit të burgut) që do të ndërtojnë një sistem real vlerash, shprehi të mira dhe risocializim të dhunuesit. Kjo kërkon burime të mëdha nga shteti, komuniteti lokal, por edhe plan të mirë dhe praktikave të mira nga jashtë. Gjithashtu, ndryshimi i politikës penale mund të kontribuojë drejtpërdrejt në uljen e dhunës në familje në nivel lokal, ku dhunuesit marrin masa shtesë për edukim të mëtejshëm. Ky model praktikohet tashmë në Holandë.

128 (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 6/2021, nr.166/2014)

Për më tepër, nevojitet një interesim më i madh nga ana e pushtetit lokal, gjegjësisht vendosja e prioritetit më të madh mbi mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, në mënyrë që: të vendosen aktivitetet e duhura në planet vjetore dhe të alokohen mjete për Komisionin për Mundësi të Barabarta.

Alternativa tjetër e mundshme është Rritja e ndërgjegjësimit përmes zbatimit të fushatave edukative dhe informuese që synojnë parandalimin e dhunës në familje, në radhë të parë në institucionet arsimore dhe në përgjithësi për të gjithë popullatën. Kjo do të rriste ndërgjegjësimin e më të rinjve që në moshë të re.

Megjithatë, zgjidhja alternative më ideale në nivel lokal është krijimi i një lloji të one-stop shop. Është në fakt një model shërbimi ku në një vend viktimat e dhunës në familje mund të denoncojnë dhunën, të marrin ndihmë juridike, të marrin ndihmë në formë edukimi, si dhe ndihmë për punësim. Modele të tilla nuk janë të reja, ato tashmë zbatohen për shembull në Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Ky model kërkon bashkëpunim dhe koordinim ndërinstitutional dhe avantazhi i tij është se ndihmon në shmangien e kurthit të "labirintit institucional" ku viktimat mund të dorëzohen, duke pasur parasysh se më shumë institucione dhe kohë të çmuar duhet të shpenzohen gjatë dhënies së ndihmës për të mbështetur dhunën në familje. Ky sistem do ta vinte viktimën në vend të parë dhe ajo do të merrte shkallën më të lartë të mbrojtjes së përgjithshme, jo vetëm kujdesin e përkohshëm në strehimore.

REKOMANDIME

Ndryshimet e propozuara që duhet të bëhen në Komunën e Kumanovës duhet të iniciohen kryesisht nga vetëqeverisja lokale, por me përfshirje të barabartë të autoriteteve qendrore, si dhe organizatave të shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara.

Lidhur me zgjidhjen primare të propozuar – krijimin e one-stop shop, propozohen rekomandimet e mëposhtme:

- 1 Fillimi i një procesi konsultativ për krijimin e One-stop shop-it, në nivel lokal i cili do të përfshijë të gjithë aktorët vendorë si: policia, qendrat e punës sociale, qendrat e shëndetit publik, organizatat e shoqërisë civile dhe të tjera. Ky proces duhet të iniciohet dhe të udhëhiqet nga shërbimet komunale.
Ky proces do të synojë të përcaktojë kornizën në të cilën do të krijohet mekanizmi One-stop shop si dhe kohëzgjatja e të gjithë procesit.
- 2 Zhvillimi i protokollit ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve për të vendosur procedurat e duhura të mbështetjes për viktimat dhe për t'u mundësuar atyre qasje të lehtë drejt shërbimeve të ndryshme.
- 3 Identifikoni hapësirën e duhur që do t'i shërbejë këtij qëllimi.
- 4 Thirrje dhe përzgjedhje për ofruesit e shërbimeve në kuadër të mekanizmit One-stop shop.
- 5 Trajnim i plotë për të gjithë punonjësit si ofrues të shërbimeve për të punuar me viktimat e dhunës në familje.
- 6 Planifikimi i aktiviteteve për informimin dhe përfshirjen e komunitetit për punën e mekanizmit si dhe shërbimet që ofron.
- 7 Angazhimi afatgjatë i autoriteteve vendore për ruajtjen e mekanizmit.
- 8 Përgatitja e planit strategjik dhe qëllimeve sipas të cilave do të punojë mekanizmi.

Zgjidhja për vendosjen e një "One-stop shop" është angazhim afatgjatë që kërkon kohë dhe burime për realizimin e tij. Ka shumë mundësi që në vitet e para të zbatimit të tij të nevojitet një ndihmë e madhe nga autoritetet qendrore, por edhe nga fondacionet dhe organizatat ndërkombëtare, në radhë të parë nga pikëpamja financiare. Korniza reale për zbatimin e një procesi të tillë nga fillimi në fund është ndërmjet 18 dhe 24 muaj.

Në lidhje me implikimet financiare, është e vështirë të përcaktohen në këtë fazë, pasi ato varen nga numri i shërbimeve dhe intensiteti me të cilin do të ofrohen. Megjithatë, futja e një mekanizmi të tillë në nivel lokal në Komunën e Kumanovës do të kushtonte nga 80000 deri në 100000 euro.

Rekomandime të tjera në lidhje me sfidat dhe alternativat:

- 1 Emërimi i një profesionist (eksperti) në pozicionin e Koordinatorit për Mundësi të Barabarta.
Është e nevojshme të veçohet funksioni i udhëheqësit të sektorit dhe koordinatorit për mundësi të barabarta sepse këto janë detyra dhe funksione të ndryshme që kërkojnë energji të ndryshme, përkushtim, por më e rëndësishmja njohuri.

- 2** Sigurimi i mbështetjes financiare për Komisionin për Mundësi të Barabarta Komisionit për Mundësi të Barabarta duhet t'i sigurohen burime financiare nga buxheti i Komunës, që do të kontribuojnë në realizimin real të aktiviteteve të Komisionit dhe zbatimin e iniciativave të tyre në praktikë.
- 3** Përgatitja e Programit të ri Vjetor të Komunës së Kumanovës, në të cilin si zë i veçantë do të vendoset ndihma që duhet të marrin viktimat e dhunës në familje.
- 4** Koordinim më i mirë ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal për dhunën në familje
Është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi i Komunës me organet qendrore që merren me këtë çështje në mënyrë që ato të veprojnë së bashku dhe të ndajnë përvojat dhe të krijojnë mekanizma të përbashkët për mbrojtjen e qytetarëve.
- 5** Plotësim i Ligjit për mundësi të barabarta ndërmjet burrave dhe grave
Një nga aspektet pozitive që mund të bëjë Komuna është që të iniciojë ndryshime në disa zgjidhje ligjore që do të kontribuojnë në efikasitetin e funksionimit të Komunës. Si i tillë, mund të parashikohet dhe iniciohet një ndryshim në Ligjin për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave, më saktësisht në nenin 40 që parashikon gjoba për mos caktimin e koordinatorit për mundësi të barabarta dhe Komision për mundësi të barabarta midis burrave dhe grave. Gjegjësisht, nga aktivitetet që i kanë paraprirë shkrimit të këtij dokumenti të politikave publike, është vërejtur një mungesë e madhe e interesimit të disa punonjësve administrativë për këtë çështje. Prandaj, është e nevojshme të zhvillohen debate dhe diskutime publike lokale që do të ngrenë çështjen për ndryshimin e nenit 40 të këtij ligji, përkatësisht shtimi i një paragrafi të ri me të cilin do të parashikohet matshmëria e punës së Komisionit dhe koordinatorit për mundësi të barabarta dhe dënimi i tyre me gjobë nëse nuk zbatohen aktivitete për këtë çështje.¹²⁹
- 6** Vendosja e një mekanizmi koordinues për të gjithë aktorët lokalë për çështjen e dhunës në familje
Për të rregulluar këtë situatë të padëshirueshme që ekziston në Komunën e Kumanovës, e cila krijon një lloj pasigurie dhe mosbesimi në institucionet vendore, është e nevojshme bashkimi i të gjitha palëve të interesuara në komunitetin lokal. Ndjeshmëria e temës nga njëra anë, por edhe nevoja për mbrojtje më të mirë dhe më efektive është ajo që duhet të kapërcejë të gjitha barrierat që ekzistojnë në pushtetin lokal dhe organet lokale dhe të sigurojë konsensus politik për këtë çështje, pavarësisht prejardhjes politike të krijuesit të politikave lokale në Komunën e Kumanovës.

129 Ligji për mundësi të barabarta ndërmjet burrave dhe grave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/2021 dhe 166/2014)

BIBLIOGRAFIA

Ligje

- Ligji për mundësi të barabarta ndërmjet burrave dhe grave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/2021 dhe 166/2014)
- Ligji për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.5 nga 29 janar 2002)
- Ligji për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje (Gazeta Zyrtare e RSM, nr. 24 nga 29.1.2021)

Publikime dhe kërkime

- Indeksi i Barazisë Gjinore, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, 2019, i disponueshëm në linkun e mëposhtëm - https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/2019/Gender%20Index_MK_01.pdf• Dhuna me bazë gjinore: vepër penale që mbetet e toleruar, Gala Naseva, 2021
- Plani i veprimtimit për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2018-2023 - mund të gjeni në linkun e mëposhtëm - https://mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-nacionalniot-plan-za-sproveduvanje-na-konvencijata-za-sprecvanje-i-borba-protiv-nasilstvoto-vrz-zen.nsp
- Programi për punën e Qeverisë së RMV-së 2017-2020, në dispozicion në - https://isu.com/vladamk/docs/programa_vlada_2017-2020_mkd

Desk hulumtim i realizuar nga ekspertja Tatjana Stoimenovska nga 05.06.2021 deri më 15.07.2021.

- A dënohet dhuna në familje? Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave-ESE, 2018, f.8

Ueb faqe dhe linqe

- Faqja e Komunës së Kumanovës, <https://kumanovo.gov.mk/>

NGA TË RINJTË PËR TË RINJTË E OHRIT

Masat dhe politikat e propozuara

- Tijana Tesalonika Shishkoska

Од млади за млади



ОХРИД

REZYME

Të rinjtë në vendin tonë shpesh nuk marrin pjesë në krijimin e politikave rinore, për arsye të ndryshme – objektive dhe subjektive. Prandaj, shpesh atyre u imponohen politika - pa u konsultuar për nevojën e zbatimit të tyre. Për një kohë të gjatë nuk ka pasur procese dhe procedura sistematike dhe të rregulluara ligjërisht për përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse, deri në miratimin e Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore në janar 2020.

Subjekt i interesimit të këtij dokumenti për politikat publike është gjendja me të rinjtë në Komunën e Ohrit. Fatkeqësisht në vitet e fundit Ohri është bërë rekorder në shpërnguljen e të rinjve. Sipas gjetjeve të anketave kombëtare dhe analizave lokale, të rinjtë nuk ndihen të përfshirë në krijimin e politikave në nivel lokal.¹³⁰Në ciklet e kaluara zgjedhore, të rinjtë janë përballur me premtime për zhvillimin e një strategjie lokale për rininë, zyrë rinore, kuvend lokal të të rinjve të Komunës së Ohrit, projekte infrastrukturore për të rinjtë. Shumë nga këto premtime nuk janë realizuar. Të rinjtë duan arsim cilësor, pjesëmarrje të të rinjve në politikë bërje, më shumë mundësi punësimi, kulturë, sport, pra cilësi më të mirë të jetës në Komunë.

Ky dokument politik synon të ofrojë udhëzime dhe rekomandime për miratimin e strategjisë gjithëpërfshirëse lokale, postulatet e së cilës do të bëhen nga të rinjtë për të rinjtë.

Qëllimi në këtë mënyrë, është përmes inkurajimit të palëve të interesuara lokale të mendojnë për miratimin e Strategjisë për të rinjtë në Komunën e Ohrit, të inkurajohet mendimi për projekte dhe politika që do të sjellin rezultate reale për të rinjtë.

METODOLOGJIA

Përgatitja e këtij dokumenti përfshiu qasje në faza që me anketë gjithëpërfshirëse për të shqyrtuar mendimet dhe qëndrimet e qytetarëve të rinj të Komunës së Ohrit, intervista me të rinjtë dhe punëtorët rinorë (përfaqësues të organizatave rinore dhe të rinjve përfaqësues të forumeve rinore aktivë në Komunën e Ohrit, sportistë të rinj, të rinj nga fusha e kulturës dhe këshilltarë deri në 29 vjet nga Komuna e Ohrit), punëtori me të rinjtë për të përcaktuar konturat e zonave prioritare për të rinjtë. Ky dokument për politika kërkon zhvillimin e një strategjie lokale për të rinjtë 2021 - 2025, duke hartuar procesin e miratimit të vetë strategjisë, fushat që duhet të mbulojë, palët e interesuara të përfshira dhe zgjidhjet e mundshme që strategjia duhet të përfshijë.

Dokumenti, në bazën e tij, iu përgjigj disa pyetjeve kyçe, si në vijim: 1) nevoja për miratimin e Strategjisë Rinore të Komunës së Ohrit; 2) përfshirja e palëve dhe bartësve të procesit për miratimin e Strategjisë Rinore; 3) procedura për miratimin e Strategjisë rinore; 4) fushat kryesore në kuadër të Strategjisë; 5) Nevoja për Plan Veprimi; 6) Përfshirja e të rinjve në zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

130 PUNËSIMI I TË RINJVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË, Studim bazë dhe rekomandime, https://e-pi.org.mk/wp-content/uploads/2019/06/FINAL_BASELINE_Mladiinfo_final.pdf, qasur më 04.08.2021

Gjatë përgatitjes së dokumentit, janë marrë parasysh analizat krahasuese të strategjive të përafërta për të rinjtë në nivel komunal (aty ku ato ekzistojnë), si dhe hulumtimi i opinionit publik i kryer në një kampion përfaqësues prej 600 të anketuar nga Ohri dhe intervistat me përfaqësues të një rrethi më të gjerë aktorësh aktivë në Komunë.

Në kuadër të analizës së njësive funksionale është marrë parasysh Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, si dhe literatura botërore lidhur me pjesëmarrjen rinore dhe strategjitë rinore.

KONTEKSTI DHE RËNDËSIA E PROBLEMIT

Një strategji cilësore për të rinjtë duhet të bazohet në nevojat e tyre reale në shoqëri, jashtë politikës. Për shkak të politizimit të thellë, të rinjtë nuk kanë një strategji jashtë partive.

- Profesor Stefan Kanevce në një shkollë të mesme në Ohër

Politika rinore e bazuar në dëshmi, pjesëmarrëse dhe e orientuar drejt rezultateve duhet t'i shohë të rinjtë si një burim njerëzor dhe jo një problem për t'u zgjidhur. Politikat rinore janë "politika të integruara që synojnë të rinjtë, me të rinjtë dhe që lindin nga nevojat e të rinjve në shoqëri".¹³¹

E thënë thjesht, të rinjtë duhet të konsiderohen si një aktor kryesor në një komunë të caktuar. Sipas ekspertëve botërorë, "korniza ligjore e cila është miqësore ndaj të rinjve është vendimtare për të mundësuar pjesëmarrjen politike të të rinjve".¹³² Përballë problemit kryesor të shpërnguljes së të rinjve, Komuna e Ohrit duhet të përballet me popullsinë e saj më të re. Sipas sondazhit të kryer për nevojat e këtij dokumenti, pothuajse gjysma e të anketuarve (49%) kanë menduar të transferoheshin në një vend tjetër, dhe një pjesë e madhe e të anketuarve ose 63% njohin njerëz që janë shpërngulur në vende të tjera në pesë vitet e fundit.

Miratimi i Strategjisë rinore në secilën komunë kohët e fundit ka qenë një çështje e rregulluar ligjërisht. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, i miratuar në janar të vitit 2020, rregullon që komunat kanë kompetencë të miratojnë strategjinë lokale për rininë dhe ajo miratohet nga Këshilli i Komunës ose Këshilli i Qytetit të Shkupit për një periudhë pesëvjeçare. Strategjia lokale, sipas ligjit, është një "dokument strategjik i cili në përputhje me Strategjinë nacionale për të rinjtë, përcakton synimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe promovimin e interesave rinore në nivel vendor dhe përcakton masat organizative, financiare dhe masat administrative për realizimin e tyre".¹³³ Megjithatë, evidentohet mungesa e ndërgjegjësimit të të rinjve për ekzistencën dhe rolin e një dokumenti të tillë strategjik në kuadër të Komunës. Sipas anketës, 44% e të rinjve besojnë se Komuna ka Strategji për të rinjtë— edhe pse Komuna e Ohrit nuk ka miratuar një dokument të tillë, gjë që tregon qartë se të rinjtë nuk janë të informuar në mënyrë përkatëse. Ajo që është befasuese është edhe qëndrimi se të rinjtë nuk janë të interesuar për një dokument të tillë.

131 PUNËSIMI I TË RINJVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË, Studim bazë dhe rekomandime, https://e-pi.org.mk/wp-content/uploads/2019/06/FINAL_BASELINE_Mladiinfo_final.pdf, qasur më 04.08.2021

132 Enhancing Youth Political Participation throughout the Electoral Cycle, United Nations Development Programme, достапна на <https://www.undp.org/publications/enhancing-youth-political-participation-throughout-electoral-cycle>

133 Neni 20, paragrafi 1, Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore

Nga të anketuarit që mendojnë se komuna nuk ka përgatitur një dokument të tillë, apo ata që nuk e dinë nëse ekziston një dokument i tillë, vetëm 30% do të ishin të interesuar ta lexonin dokumentin nëse ai është i disponueshëm online. Kombinuar me përgjigjet e të rinjve ndaj përfshirjes sociale - ku vetëm një e katërta ose 25% e të anketuarve janë anëtarë të një shoqate me qëllime shoqërore, është e qartë se të rinjtë nuk kanë shumë interes për angazhim më të gjerë shoqëror.

SUPOZIME NË LIDHJE ME PROCESIN E MIRATIMIT TË STRATEGJISË PËR TË RINJTË NË KOMUNËN E OHRIT

Strategjia lokale për të rinjtë miratohet nga Këshilli i komunës, por ajo zhvillohet në bashkëpunim me këshillin rinor lokal. Kjo bazë ligjore, në çdo rast, është vetëm një pikënisje për palët e interesuara në procesin e zhvillimit të strategjisë. Parë në mënyrë krahasuese, Strategjia Kombëtare për të rinjtë e vitit 2016 përfshinte disa palë të interesuara, konkretisht: konferencë kombëtare, thirrjen e hapur për pjesëmarrje në grupet tematike të punës për çdo shoqatë qytetare, grup joformal apo individ. Përveç konferencës kombëtare dhe thirrjes së hapur për pjesëmarrje, Agjencia për Rini dhe Sport (ARS) organizoi takime publike të grupeve të punës në kuadër të fushave prioritare të strategjisë, si dhe 12 debate publike në të gjithë vendin, duke përfshirë edhe debatin publik final në Shkup, ku morën pjesë mbi 130 përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqatave të qytetarëve, këshillave rinore lokale, grupeve joformale dhe individëve.¹³⁴


Të rinjtë dhe punëtorët rinorë të intervistuar, si palë të interesuara në procesin e përgatitjes së strategjisë rinore, posaçërisht i theksojnë: Kryetarin e komunës së Ohrit, Këshillin e komunës, Këshillin rinor, organizatat rinore që veprojnë në Komunën e Ohrit dhe organizatat rinore. Më tej përmenden të rinjtë e partive politike, përfaqësues të shkollave të mesme dhe fakulteteve që funksionojnë në qytetin e Ohrit.

Baza për fillimin e një procesi të hartimit të strategjisë duhet të jetë gjithmonë e bazuar në dëshmi. Në këtë kuptim, para se të fillohet me hartimin e një strategjie rinore, është e nevojshme të kryhen hulumtime për trendet rinore, por edhe analiza të tjera gjithëpërfshirëse në terren/profesionale të opinionit publik të të rinjve për situatën në shoqëri, analizë për qëndrimet dhe opinionet e psikologëve dhe pedagogëve profesionistë të cilët punojnë me të rinjtë në komunë, të përcaktohen kërkesat dhe nevojat e aktivistëve rinorë nga të gjitha llojet e shoqatave dhe fushave.

Në këtë kuptim, Komuna e Ohrit duhet të fillojë një proces proaktiv, gjithëpërfshirës dhe thelbësor për hartimin e Strategjisë për të rinjtë, udhëheqës i së cilës duhet të jetë kryetari i komunës dhe këshilltarët e rinj nga Këshilli i komunës. Propozohet që komuna të përfshijë Këshillin rinor të komunës në të gjitha fazat e procesit të miratimit të strategjisë. Më tej, përmes një thirrjeje të hapur për pjesëmarrje duhet të përfshihen të gjithë të interesuarit, të rinjtë e partive që veprojnë në Komunën e Ohrit, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, ekspertë të fushës së arsimit rinor, ekspertë shkencorë, si dhe lëvizje rinore të interesuar dhe grupet informale të të rinjve.

¹³⁴ Strategjia Kombëtare për të rinjtë e Republikës së Maqedonisë (2016-2025), e disponueshme në <https://www.sega.org.mk/images/E-Library/Strategies/NSMK.pdf>

Gjatë përgatitjes së Strategjisë rinore, Komuna e Ohrit duhet të përcaktojë një proces me faza për miratimin e draft tekstit të Strategjisë, i cili do të garantojë përfshirjen e disa palëve të interesuara të përfaqësuara në skemën e mëposhtme:



FUSHA KYÇE ME INTERES PËR TË RINJTË

Për të përcaktuar fushat kryesore që do të adresohen nga Strategjia për të rinjtë, nevojitet një proces profesional për të hedhur themelet për veprim përmes Strategjisë. Strategjia Kombëtare për të rinjtë e Republikës së Maqedonisë njih disa prioritete strategjike, përkatësisht: sigurimin e një standardi më të mirë të jetesës dhe mundësive të barabarta për jetë cilësore; krijimin e kushteve për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, si dhe integrimin dhe ndërveprimin sistematik të kategorive të ndryshme të të rinjve; krijimi i mundësive për përfshirjen e të rinjve në monitorimin dhe zbatimin e politikave dhe vendimeve që janë në interes të tyre; qasje të barabartë në arsim cilësor dhe forma të tjera të zhvillimit personal dhe profesional.¹³⁵ Strategjia Kombëtare trajton gjithashtu disa fusha tematike: pjesëmarrjen efektive të të rinjve, informimin e të rinjve, punën lokale të të rinjve, edukimin e të rinjve, punësimin dhe mbështetjen e punësimit, kulturën, sportin, shëndetin dhe cilësinë e jetës së të rinjve.

¹³⁵ Strategjia Kombëtare për të rinjtë e Republikës së Maqedonisë (2016-2025), në dispozicion në <https://www.sega.org.mk/images/E-Library/Strategjies/NSMK.pdf>

Nëse shikojmë më konkretisht Komunën e Ohrit, me rëndësi të veçantë është të shikojmë përgjigjet e hulumtimit, të cilat mund të na tregojnë problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen të rinjtë, të cilat janë nën juridiksionin e Komunës. Sipas hulumtimit, problemi më i rëndësishëm lokal me të cilin ballafaqohen 12% e të rinjve në Komunën e Ohrit është lidhja e dobët me komunat tjera. Rreth 11% mendojnë se problemi më i rëndësishëm është mungesa e sipërfaqeve të gjelbra, ndërsa 10% mendojnë se mirëmbajtja e pakënaqshme e rrugëve është problemi më i madh në komunë. Nga ana tjetër, të anketuarit besojnë se më së paku ka bërë vetëqeverisja lokale, gjegjësisht se në 4 vitet e fundit ka regres më të madh në pjesën e kujdesit për liqenin dhe bregun e liqenit (21%), në kushtet për zhvillim ekonomik të Komunës (17%), ndërsa 15% besojnë se më së pakti është bërë për planifikimin urbanistik. Siç shihet nga pyetjet tjera, të rinjtë nga Komuna e Ohrit besojnë se problemet më të mëdha kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, shëndetësinë dhe arsimin.

Të pyetur për problemin më të madh me të cilin ballafaqohet vendi ynë, të rinjtë nga Ohri më së shumti theksojnë mosfunksionimin e sistemit juridik/korrupsionin dhe krimin (17%), sistemin jofunksional shëndetësor, sistemin e dobët arsimor dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut (me 11% secili).

Të njëjtat probleme u identifikuan edhe gjatë punëtorive, duke shtuar aspektet e ofrimit të kushteve për biznes dhe sipërmarrje për të rinjtë, vende pune të reja dhe me pagesë të lartë dhe mundësi për zhvillim personal dhe profesional. Prandaj, Strategjia duhet të mbulojë disa fusha kryesore prioritare:

- Përfaqësimi, informimi dhe përfshirja e të rinjve në vendimmarrje në nivel lokal;
- Arsimi cilësor i të rinjve që i përgatit ata për sukses personal;
- Mundësi punësimi, hapjen e biznesit personal dhe zhvillim profesional;
- Sport, kulturë dhe jetë sociale;
- Mbrojtja e mjedisit jetësor, liqeni i Ohrit dhe turizmi i qëndrueshëm.

Studimi jep një shpjegim gjithëpërfshirës për secilën prej fushave tematike, e cila për mendimin tonë është e rëndësishme për planifikimin e projektit të procesit të miratimit të Strategjisë rinore. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se një ekip ekspertësh i formuar nga autoritetet komunale, në diskutim dhe koordinim me rrethin më të gjerë të mundshëm të të rinjve dhe organizatave, duhet të përcaktojë fushat kryesore që do të jenë prioritet i Strategjisë për të rinjtë. Kjo nuk do të thotë se do të përjashtohen fusha të tjera, por se Strategjia do të ketë një fokus të veçantë në fushat që janë dëshmuar të jenë urgjente/shumë të rëndësishme në atë periudhë programore. Fushat e mësipërme si pjesëmarrja dhe informimi i të rinjve, punësimi i të rinjve, arsimi, kultura, zhvillimi sportiv e social dhe mbrojtja e mjedisit janë, sipas autorëve, fushat kryesore prioritare. Natyrisht, kjo nuk do të thotë se ato shterojnë të gjitha prioritetet, por për këtë duhet hulumtim më gjithëpërfshirës.

ZBATIMI I STRATEGJISË

Përkundrazi, komuna, duke hartuar masat e duhura për arritjen e objektivave të përcaktuara në fushat prioritare, duhet të ofrojë mbështetjen e saj për një "ringjallje" reale të Strategjisë.

Miratimi i Strategjisë për të rinjtë nuk e përfundon procesin e ndërtimit të besimit dhe bashkëpunimit mes të rinjve dhe komunës ku ata jetojnë. Miratimi i Strategjisë për të rinjtë nuk duhet të jetë qëllim në vetvete. Siç është përmendur tashmë, Strategjia duhet të përmbajë Plan Veprimi, i cili do të përcaktojë masat dhe aktivitetet specifike të cilat Komuna do të obligohet t'i realizojë në drejtim të realizimit të qëllimeve të përcaktuara në Strategji.

Në të kundërt, si shumë dokumente strategjike dhe programore, një Strategji e tillë për të rinjtë në Ohër do të mbetet vetëm një tekst i shkruar në letër. Siç rregullohet me ligj, planet e veprimit për strategjinë lokale për rininë përgatiten nga komunat, në bashkëpunim me këshillin rinor lokal dhe miratohen nga këshilli komunal, në një periudhë prej një deri në tre vjet dhe për to dorëzohet buxheti për realizim. Praktikisht ky plan shërben edhe si mjet për programimin e aktiviteteve të komunës në vitet buxhetore (dhe lidhur me rininë), për përgatitjen e programit politik të partive, por edhe për analizimin e transparencës dhe llogaridhënies në punën e administrata komunale.

Është veçanërisht e rëndësishme që strategjia të krijojë një mekanizëm për monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të saj, i cili krijon sistem paralajmërimi të hershëm në rast të vonësës në zbatimin e aktiviteteve. Prandaj, Komuna duhet të jetë e obliguar të përgatisë raporte vjetore për progresin në zbatim, të cilat do të shqyrtohen nga Këshilli dhe në kuadër të organit bashkë menaxhues. Punëtorja me të rinjtë rezultoi me propozimin që Komuna të themelojë organ bashkë menaxhues qytetar me përfaqësues të shoqërisë civile, rinisë, si dhe organeve dhe trupave komunale që do të monitorojnë zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit dhe do të sugjerojnë mënyra për përmirësimin në qasje dhe zbatim.

Në lidhje me fushat individuale të përmendura në Studim, për sa i përket pjesëmarrjes në punë dhe përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve, komuna duhet të ofrojë aktivitete që do të inkurajojnë shoqatat, të inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të të rinjve në organet e tyre ligjore dhe statutore, por edhe do të fokusohen në veçanti për organizatat që trajnojnë lehtësuesit dhe drejtuesit e klubeve dhe organizatave rinore, si dhe punëtorët rinorë.

Për sa i përket prezantimit, komuna duhet të inkurajojë funksionimin e mirë të Këshillit rinor, të hapë Zyrën e saj Rinore, si dhe të mundësojë hapjen e një Qendre Rinore. Digjitalizimi i shërbimeve dhe informacionit nëpërmjet mjeteve moderne "smart" të cilat janë të njohura për të rinjtë është gjithashtu një aspekt shumë i rëndësishëm që jep fryte në të gjitha vendet e Evropës Perëndimore.

Për sa i përket punësimit, ndërkaq në bashkëpunim me Agjencinë për Punësim, komuna duhet të bëjë përpjekje që qendrat lokale për punësim që ofrojnë asistencë¹³⁵ specialistike të jenë realisht funksionale. Për më tepër, masat për mbështetjen e krijimit të bizneseve duhet të dimensionohen, përkatësisht të inkurajohet sipërmarrja sociale, të punohet më shumë në tërheqjen e investimeve që kanë në fokus punësimin e të rinjve, si dhe të ofrojë ambiente biznesi, pajisje, trajnime dhe këshilla profesionale për personat që duan të fillojnë biznesin e tyre. Duke parë zhvillimin e vazhdueshëm, në planin e saj të veprimit komuna duhet t'i kushtojë vëmendje të madhe industrisë së TI-së, që formon bizneset e saj me rritje të shpejtë (të ashtuquajturat Start up biznese dhe gazelat).

Sa i përket arsimit, Komuna duhet të parashikojë pjesëmarrjen e saj aktive në fushën e infrastrukturës, mbështetje financiare dhe mbështetje tjetër, që do të rrisë cilësinë, qasjen dhe zhvillimin në arsimin fillor dhe të mesëm. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet lëvizshmërisë së të rinjve, me çka do të inkurajohen të rinjtë, organizatat dhe shkollat e tyre që të marrin pjesë aktive në aktivitetet ndërkombëtare të binjakëzimit. Për sa i përket zhvillimit të barabartë rajonal, detyra e komunës është të ofrojë politika arsimore, punësimi, strehimi, transporti dhe politika të tjera sektoriale që do të reflektojnë dhe adresojnë nevojat e veçanta të të rinjve që jetojnë në zonat rurale. Gjithashtu, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet edukimit joformal dhe përvetësimit të aftësive jetësore që të rinjtë nuk kanë mundësi t'i përvetësojnë diku tjetër (aftësitë e TI-së dhe edukim digjital, aftësitë e buta për fjalim në publik, menaxhimin e projekteve dhe zhvillimin e inteligjencës emocionale).

PIKËPAMJET PËRFUNDIMTARE, MASA DHE REKOMANDIME

Zgjidhjet për problemet me të cilat përballen të rinjtë duhet të gjenden përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me të rinjtë. Preambula e Kartës për pjesëmarrje rinore në jetën lokale dhe rajonale ka si aspekt kyç pjesëmarrjen aktive të të rinjve në jetën praktike në mjedisin e tyre të afërt. Sipas Kartës, "pjesëmarrja aktive e të rinjve në vendimmarrje dhe aktivitete në nivel lokal dhe rajonal është e nevojshme nëse duam të ndërtojmë shoqëri më demokratike, gjithëpërfshirëse dhe premtuese"¹³⁶. Të rinjtë duhet të pyeten për situatat me të cilat përballen, për problemet në shoqërinë e përditshme dhe më pas t'i lidhin me zgjidhjet e mundshme, si dhe me vendimmarrësit e drejtpërdrejtë në nivel lokal.

Prandaj, ky dokument politik, por edhe në literaturën dominuese për këtë temë, kërkon përfshirjen e të rinjve përmes organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe të gjitha modeleve të tjera të shoqërimit rinor, por edhe të të rinjve të pa organizuar, si dhe në hartimin dhe miratimin, por edhe në zbatimin e Strategjisë së ardhshme për të rinjtë e Komunës së Ohrit. Vetëm në atë mënyrë mund të garantohet mbyllja e suksesshme e rrethit dhe realizimi i suksesshëm i qëllimeve që do të parashikohen me të.

136 Preambula, Karta Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale

BIBLIOGRAFIA

- KARTA EVROPIANE E RISHIKUAR PËR Pjesëmarrje Rinore në Jetën Lokale dhe Rajonale, Miratuar në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës (Sesioni I 10-të - 21 Maj 2003 - Shtojcë e Rekomandimit 128)
- KODI I PRAKTIKAVE TË MIRA NË Pjesëmarrjen e Shoqërisë Civile në Procesin e Politike Bërjes, GAZ. ZYRTARE E RM NR. 99 NGA 22.07.2011
- LIGJI PËR Pjesëmarrje Rinore dhe Politika Rinore, GAZ. ZYRTARE E RM NR. 10/2020 E DATËS 16.01.2020
- KRIJIMI I POLITIKAVE RINORE PËRMES KËSHILLAVE RINORE LOKALE, DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE, <http://progres.org.mk/files/publications/Mladinski%20sovet.pdf>, QASUR MË 22.07.2021
- MATJA E PERCEPTIMIT DHE QËNDRIMIT TË BANORËVE TË RINJ TË KOMUNËS SË OHRIT, REALIZUAR NGA AGJENCIA MARKET VISION
- MINISTRIA E FINANCAVE, "PROGRAMI I REFORMËS EKONOMIKE 2018-2020", JANAR 2018, https://www.finance.gov.mk/files/Makedonija_ERP_2018.pdf QASUR MË 22.07.2021
- PUNËSIMI I TË RINJVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË, STUDIM BAZË DHE REKOMANDIME, https://epi.org.mk/wp-content/uploads/2019/06/FINAL_BASELINE_Mladiinfo_final.pdf, QASUR MË 04.08.2021
- STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TË RINJTË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË (2016-2025)
- NGA TË RINJTË PËR TË RINJTË: PERSPEKTIVA MBI SFIDAT SOCIALE, INSTITUTI PËR POLITIKA EVROPIANE, <https://epi.org.mk/docs/Od%20mladite%20za%20mladite%20-%20perspektivi%20za%20opstestvenite%20predizvici.pdf>, QASUR MË 02.08.2021
- STRATEGJIA PËR TË RINJTË E KOMUNËS SË MANASTIRIT (2014-2019)
- STRATEGJIA PËR TË RINJTË E KOMUNËS SË KAVADARIT
- ENHANCING YOUTH POLITICAL PARTICIPATION THROUGHOUT THE ELECTORAL CYCLE, UNITED NATIONS DEVELOPMENT PROGRAMME



<http://www.electoralreforms.mk/>



<https://www.facebook.com/Support-to-Electoral-Reforms>

